




# STUDIM RINOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT 2018/2019



## THE FRIEDRICH-EBERT-STIFTUNG

Friedrich-Ebert-Stiftung (FES) është fondacioni më i vjetër politik në Gjermani, me një traditë të pasur në demokracinë sociale që daton prej vitit 1925. Puna e fondacionit tonë politik zhvillohet rreth ideve kryesore dhe vlerave të demokracisë sociale – lirisë, drejtësisë dhe solidaritetit. Kjo është ajo që na lidh me parimet e demokracisë sociale dhe sindikatave të lira.

Me rrjetin ndërkombëtar të zyrave në më shumë se 100 vende, ne mbështesim një politikë për bashkëpunim paqësor dhe të drejtave të njeriut, promovojmë ngritjen dhe konsolidimin e strukturave demokratike, sociale dhe kushtetuese dhe punojmë si pionierë për sindikatat e lira dhe një shoqëri civile të fortë. Jemi aktivisht të përfshirë në promovimin e një Evrope sociale, demokratike dhe konkurruese në procesin e integritimit evropian.

### STUDIMET PËR TË RINJTË NË EVROPËN JUGLINDORE 2018/2019:


“Studimet për të Rinjtë në Evropën Juglindore të FES 2018/2019” është një projekt ndërkombëtar hulumtues për të rinjtë i kryer në të njëjtën kohë në dhjetë vende në Evropën Juglindore: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Rumania, Serbia dhe Sllovenia. Qëllimi kryesor i anketave ka qenë identifikimi, përshkrimi dhe analiza e qëndrimeve të të rinjve dhe modeli i sjelljeve në shoqërinë bashkëkohore.

Të dhënat u grumbulluan në fillim të vitit 2018 nga më shumë se 10,000 të anketuar të moshës 14-29 vjeç në vendet e sipërpërmendura të cilat morën pjesë në studim. Një numër i madh çështjesh u trajtuan, duke përfshirë përvojat dhe aspiratat e të rinjve në fusha të ndryshme të jetës, si arsimi, punësimi, pjesëmarrja politike, marrëdhëniet familjare, koha e lirë dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, por edhe vlerat, qëndrimet e tyre dhe besimet.

Gjetjet janë paraqitur në dhjetë studime kombëtare dhe një rajonale dhe dokumentet e shoqëruese të politikave, të cilat janë botuar në gjuhën angleze dhe në gjuhët përkatëse kombëtare.

# STUDIM RINOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT 2018/2019

Marija Topuzovska Latkovikj, Mirjana Borota Popovska, Eleonora Serafimovska,  
Aneta Cekikj, Nita Starova



<b>1</b>	<b>Hyrje</b> .....	<b>3</b>
<b>2</b>	<b>Rezyme ekzekutive</b> .....	<b>5</b>
<b>3</b>	<b>Qasja metodologjike</b> .....	<b>9</b>
<b>4</b>	<b>Stili i jetës dhe koha e lirë</b> .....	<b>15</b>
<b>5</b>	<b>Mobiliteti</b> .....	<b>27</b>
<b>6</b>	<b>Individi, relacionet me të tjerë, martesë dhe</b> .....	<b>39</b>
<b>7</b>	<b>Arsimi dhe punësimi</b> .....	<b>53</b>
<b>8</b>	<b>Politika dhe demokracia</b> .....	<b>67</b>
	Literatura e përdorur .....	84
	Fusnotat .....	86
	Tabela e figurave .....	87
	Tabela e tabelave .....	89



## 1

## HYRJJE

Fondacioni Fridrih Ebert në vitin 2013 e realizoi studimin e parë nacional për të rinjtë në Republikën e Maqedonisë, me qëllim që t'i masë, përshkruaj dhe sqaroj qëndrimet kryesore të popullatës së re maqedonase, në lidhje me shoqërinë, politikën, arsimin, punësimin, familjen, religjionin dhe integrimin në Bashkimin Evropian. Studimi u realizua me metodologjinë e njëjtë në të gjitha vendet e rajonit, e që mundësoi dhe rezultoi me analiza krahasuese shtesë. Rezultatet e këtij studimi zgjuan interesim të madh në Maqedoni dhe u shfrytëzuan si bazë për krijimin e propozim politikave të caktuara dhe projekteve në vitet e kaluara.

Së këtejmi, pas pesë vitesh, Fondacioni Fridrih Ebert sërish e ngriti iniciativën për realizimin e njëkohshëm të studimit për të rinjtë në të gjitha 10 vendet e rajonit të Evropës Juglindore, në vitin 2018, me qëllim që të fitohen të dhëna analitike lidhur me perceptimet e gjeneratës së re, pritshmëritë e tyre, qëndrimet dhe qasjet mbi realitetin dhe përditshmërinë, por njëkohësisht edhe t'i matë ndryshimet eventuale, tendencat dhe gjendjet gjatë pesë viteve të kaluara.

Meqë bëhet fjalë për të rinj, si kategori specifike, duhet të merret parasysh se tri periudha kohore janë kryesore nga pikëpamja e rrjedhës së jetës: koha individuale, koha e gjeneratës dhe koha historike. Koha individuale ka të bëjë me kohën biologjike. Supozohet se periudhat e jetës, siç është fëmijëria, adoleshenca, koha e pjekurisë, pozitat e ndikimit, roli dhe të drejtat në shoqëri, mbështeten mbi përkufizime kulturologjike për moshën. Koha e gjeneratës ka të bëjë me grupmoshat ose me grupet e bashkëmoshatarëve në të cilat janë grupuar njerëz, sipas moshës së tyre ose sipas periudhës së lindjes. Ndërkaq, koha historike ka të bëjë me kontekstin shoqëror, me ngjarjet dhe ndryshimet (politike, ekonomike, teknologjike etj.) në të cilat jetojnë njerëzit.

Popullata e re e përfshirë në këtë Studim është në moshë prej 14 deri 29 vjeç, ndërsa aktualisht përbëhet nga dy grupe të gjeneratave, të njohura në botë si gjenerata Y (të lindur midis vitit 1981 dhe 2000) dhe gjenerata Z (të lindur pas vitit 2000). Këta të rinj, përveç asaj që janë dëshmitarë të ndryshimeve dhe ngjarjeve dinamike në nivel global (zhvillimi rapid i teknologjisë dhe përho-

rimi i gjerë i internetit, ndryshimet klimatike dhe fatkeqësitë natyrore, sulmet terroriste dhe luftërat, kriza ekonomike), në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë ishin pjesë edhe të ngjarjeve turbulente në planin politik dhe shoqëror në Maqedoni, veçanërisht në periudhën e kaluar, siç është: kriza politike, aferat dhe skandalet e shumta, protestat e studentëve, Revolucioni i laramantë, i cili rezultoi me ndërrimin e pushtetit në Maqedoni. Ngjarjet e këtilla, përveç që i vunë në pikëpyetje proceset demokratike në vend, është më se evidente se në masë të ndryshme kishin ndikim edhe mbi qëndrime të caktuara të të rinjve.

Sipas rezultateve të hulumtimit, të rinjtë e Republikës së Maqedonisë padyshim i ndajnë karakteristikat e përgjithshme, vlerat, dëshirat dhe frikën e gjeneratave Y dhe Z, ngjashëm si edhe bashkëmoshatarët e tyre të rajonit dhe në përgjithësi në botë, megjithatë, për aspekte të caktuara vërehet ndikimi i kontekstit nacional.

Për fat të keq, tek të rinjtë në Maqedoni akoma ekziston dëshira për migrim dhe për t'u larguar nga vendi, në kërkim të një standardi më të mirë jetësor, mosbesimi ndaj institucioneve dhe partive politike është akoma në nivel të lartë dhe paragjykimet ndaj diversitetit edhe më tej janë rrënjësor thellë në qëndrimet; rezultate shqetësuese të cilat vënë në dukje një sërë të sfidave ekzistuese me të cilat duhet të ballafaqohen krijuesit e politikave dhe vendimmarrësit, por edhe të rinjtë, me qëllim që të ndikohet mbi këto tendenca negative.

Studimi i vë në pah sfidat dhe masat emergjente që duhet të ndërmerren për përmirësimin e gjendjes së të rinjve në shoqërinë maqedonase, meqë jemi të vetëdijshëm se ata janë liderët, politikanët, edukatorët, novatorët, punëdhënësit, qytetarët e ardhshëm të BE dhe botës. Ardhmëria është në duart e tyre dhe ata duhet të posedojnë potencial për ndryshime dhe përmirësimin e demokracisë dhe ekonomisë në vend.

Eva Ellereit, Drejtore, Fondacioni "Fridrih Ebert"-Zyra në Shkup  
Nita Starova, Koordinatorë e Projektit, Fondacioni "Fridrih Ebert"-Zyra në Shkup



## 2

# REZYME

# EKZEKUTIVE

Studimi analizon dhe përshkruan fenomene, tema dhe tendenca lidhur me të rinjtë në Republikën e Maqedonisë dhe njëherësh jep rekomandime për përmirësimin e gjendjeve. Hulumtimi në Republikën e Maqedonisë është pjesë e një projekti të madh i cili njëkohësisht zhvillohet në vendet e Evropës Juglindore, me mbështetje të Fondacionit Fridrih Ebert. Studimi mbështetet mbi kombinimin e procedurave hulumtuese kuantitative dhe kualitative, me analizën e të dhënave primare, por edhe të atyre sekondare. Për nevojat e hulumtimit anketues është dizajnuar modeli i stratifikuar në kuota nga gjithsej N=1038 të anketuar. Hulumtimi në terren u realizua me CAPI (Computer-assisted personal interviewing), në periudhën kohore nga 12 shkurti deri më 12 mars të vitit 2018.

Nga ana tjetër, për intervistën, modeli përbëhet nga 10 të anketuar, njerëz të rinj nga Republika e Maqedonisë, heterogjen sipas karakteristikave demografike (siç është, gjinia, mosha, etniteti, shkalla e arsimit dhe vendi i banimit).

Të dhënat kuantitative të fituara nga hulumtimi anketues janë analizuar në nivelin univariantë, bivariantë dhe multivariantë, përmes zbatimit të procedurave përkatëse statistikore SPSS (Statistical Package for the Social Sciences), të cilat janë interpretuar tekstualisht dhe në mënyrë vizuale janë pasqyruar në fotografi dhe tabela.

Të dhënat kuantitative nga intervistat e realizuara janë anonimizuar, janë analizuar në mënyrë narrative dhe janë prezantuar në formë të anekdotave dhe citateve.

Raporti është ndarë në pesë pjesë.

## STILI I JETËS DHE KOHA E LIRË

Të rinjtë më së shpeshti dëgjojnë muzikë, e kalojnë kohën me familjen dhe dalin me miq, ndërsa në raste të rralla meditohet/praktikojnë jogë, vullnetarizëm në projekte sociale dhe qëndrojnë

jashtë vendit. Koha e kaluar në Internet është rritur për plotë 2 orë, në krahasim me vitin 2013 (brenda ditës kalojnë përafërsisht 3 orë duke shikuar TV dhe 6 orë në Internet). Të rinjtë më së shpeshti e përdorin Internetin për interaksion social dhe për komunikim, edukim, informim, si dhe për argëtim/zbavitje.

Përafërsisht një e treta e të rinjve janë përdorues të rregullt të duhanit, ndërsa 24% konsumojnë alkool gjatë fundjavave. Pjesa më e madhe ose 89% e të rinjve janë përgjigjur se nuk përdorin droga të lehta, siç është marihuana. Rinia maqedonase, marrë në përgjithësi, manifeston vlera të ulëta në shkallën e devijimeve;

Të rinjtë e gjinisë femërore përvojën e parë seksuale e përjetojnë në moshën 18 vjeçare, ndërsa të gjinisë mashkullore në moshën 17 vjeçare. Trajektoret e rrjedhës jetësore tek të rinjtë, edhe të gjinisë femërore edhe të asaj mashkullore, varen nga shkalla e arsimit, me ç'rast ashtu siç rritet shkalla e arsimit ashtu rritet edhe mosha kur ndodhin ngjarjet më të rëndësishme jetësore, ndërsa vëllimi i kohës së kaluar për të gjitha ngjarjet kyç të trajektores reduktohet me rritjen e shkallës së arsimit.

## MOBILITETI

Të rinjtë udhëtojnë rrallëherë jashtë vendit, ndërkaq madje 91% nuk kanë qëndruar jashtë vendit më shumë se 6 muaj, që nënkupton se pritshmëritë e tyre për jetën jashtë vendit nuk bazohen mbi përvojën personale.

Sa i përket dëshirës për të migruar jashtë vendit, të rinjtë mund të ndahen në tre grupe: një e treta e të rinjve kanë dëshirë të madhe të largohen nga atdheu i tyre, një e treta kanë manifestuar dëshirë mesatare për të migruar dhe një e treta nuk kanë fare dëshirë të këfillë. Përqindja e njëjtë prej 33,80, si edhe në Studimin e vitit 2013 (33%), janë përgjigjur se planifikojnë që përgjithmonë

të jetojnë në vendin e dëshiruar. Tendencë më të madhe për migrim ka tek profili i ardhshëm i të rinjve: kryesisht maqedonas, në moshë prej 14 deri në 19 vjeç, me arsim fillor dhe të mesëm, kryesisht nga vendbanimet urbane;

Për thuaja se gjysmën e të rinjve shkaku kryesor për migrim është përmirësimi i standardit jetësor.

Si destinacion më i dëshiruar – numër një për emigrim në mesin e të rinjve është Gjermania.

Të rinjtë, përveç asaj që nuk ndërmarrin aksion konkret për të emigruar (proaktivitet i ulët), kanë edhe nivel të ulët të njohurive/informacioneve për mundësitë e imigrantëve në vendin e dëshiruar.

Ajo që në masë më të madhe i mban të rinjtë që të mos emigrojnë, padyshim se është familja.

## **INDIVIDU, RELACIONET ME TË TJERË, MARTESA DHE FAMILJA**

Vlerat më të rëndësishme për të rinjtë janë: të jesh besnik/lojal ndaj partnerit/partneres/miqve/punëdhënësve; të jesh i pavarur; të kesh karrierë të suksesshme dhe të ndërmerret përgjegjësi. Çështje më pak të rëndësishme në jetën e të rinjve janë: të jesh politikisht aktiv dhe të marrësh pjesë në aktivitete/iniciativa qytetare. Të anketuarit janë shumë më optimistë kur bëhet fjalë për ardhmërinë e tyre sesa kur bëhet fjalë për ardhmërinë e shoqërisë maqedonase. Të rinjtë në Maqedoni thuaja se kanë frikë për çdo gjë dhe veçanërisht për ndotjen, ndryshimet klimatike dhe varfërinë. Sot, të rinjtë janë më religjioz sesa para 5 vitesh. Pjesa më e madhe e tyre i praktikojnë ritet fetare vetëm në festat e rëndësishme fetare.

Të rinjtë, si para pesë vitesh ashtu edhe tani, besim më të madh kanë tek anëtarët e familjes së tyre më të ngushtë dhe më të gjerë dhe tek miqtë, ndërsa më së paku u besojnë liderëve politikë. Maqedonasit dhe shqiptarët në vitin 2018 i besojnë më pak njëri-tjetrit në krahasim me vitin 2013. Qëndrimi i të rinjve është se orientimi seksual dhe gjuhën që e përdorin më së shpeshti është shkak për diskriminim, ndërsa bindjet politike dhe origjina etnike janë shkak më i shpeshtë për diskriminim.

Profili i një familjeje në Republikën e Maqedonisë është si vijon: familja mesatarisht përbëhet nga 4 anëtarë tek maqedonasit dhe 5 anëtarë tek shqiptarët – dy prindër dhe fëmijët. Familja më së shpeshti jeton në shtëpinë e prindërve meqë është më praktike dhe më e thjeshtë. Anëtarët e familjes kanë marrëdhënie të mira midis tyre. Mbi vendimet e të rinjve ndikojnë edhe dy prindërit. Të rinjtë, në të ardhmen, veten e tyre e shohin si të martuar, me dy fëmijë, të edukuar që t'i respektojnë prindërit dhe kështu dëshirojnë t'i edukojnë edhe fëmijët e tyre.

## **ARSIMI DHE PUNËSIMI**

Të rinjtë kanë aspirata të mëdha (më shumë se 80% kanë dëshirë të kryejnë arsim universitar), mësojnë pak (veçanërisht është ulur përqindja e atyre të cilët mësojnë më shumë se 3 orë, nga 44% në vitin 2013 në 22,55% në vitin 2018), mendojnë se notat mund të blihen, ndërsa dy të tretat e të anketuarve një ditë të zakonshme në shkollë e perceptojnë si të vështirë dhe me stres.

Thuaja se gjysma e të anketuarve janë të pakënaqur me cilësinë e procesit arsimor në Republikën e Maqedonisë. Një pjesë të shkaqeve të pakënaqësisë mund t'i detektojmë në perceptimin e praktikimit dhe përdorimit të njohurisë së fituar. Së këtejmi, analiza e regresionit vë në dukje se perceptimi subjektiv i të rinjve, sa i përket kënaqësisë nga cilësia e arsimit në vend, do të rritej nëse harmonizohen me plan programet mësimore të huaja për punë dhe nëse të rinjtë më shpejtë gjejnë punë pas kryerjes së arsimit.

Të rinjtë më së shumti kanë dëshirë të punojnë në sektorin publik (45%), ndërsa "vendi i sigurt i punës pa frikë nga përjashtimi" është në vend të parë sipas rëndësisë së zgjedhjes së punës.

Fati është në mesin e tre faktorëve për gjetjen e punës (në vend të parë janë "lidhjet dhe miqtë", në vend të dytë "lidhjet me njerëz të pushtetshëm").

Serioze është e dhena se më pak se një e treta e nxënësve dhe studentëve të rregullt gjatë arsimit të tyre kanë bërë ndonjë praktikë, ndërsa vetëm 20% e të rinjve kanë bërë punë vullnetare në 12 muajt e fundit.

## **POLITIKA DHE DEMOKRACIA**

Interesimi për politikë në mesin e të rinjve dhe bisedat në tema politike ka shënuar rënie, përkatësisht është dyfish më i vogël në krahasim me studimin paraprak të vitit 2013. Sa i përket interesimit të reduktuar, mes tjerash, ndikim të vet ka edhe kriza politike e cila zhvillohej në Maqedoni në periudhën nga viti 2015-2017, e që shkaktoi pakënaqësi të madhe tek popullata, problemet shumëvjeçare ndërkombëtare me "çështjen e emrit" dhe mospunësi për fillimin e negociatave me BE.

Për atë se politikanët nuk kujdesen për opinionet e tyre janë të mendimit 61% e të rinjve, ndërsa 73% janë të mendimit se duhet të kenë më shumë mundësi që ta ngrenë zërin e tyre në politikë. Më shumë se 80% e të rinjve votojnë në zgjedhje. Rreth 40% e të rinjve kanë qëndrim pozitiv ndaj participimit politik kur bëhet fjalë për nënshkrimin e peticioneve, pjesëmarrjes në protesta dhe pjesëmarrje në aktiviteteve të organizatave vullnetare dhe qytetare.

Besimi tek institucionet është i vogël. Besimi më i ulët është tek institucionet politike vendore dhe tek partitë politike.

Të rinjtë manifestojnë qëndrime majtiste, në të vërtetë, në masë të madhe pranojnë një rol më të madh të shtetit në ekonomi. Nga ana tjetër, kur bëhet fjalë për dimensionin liberalizëm – konservatizëm, ata rreshtohen tek e djathta.



Për atë se “duhet të kemi lider i cili do ta udhëheq Maqedoninë me dorë të fortë në interes të të mirës publike” mendojnë 71,3% e të rinjve, si dhe se “partia e fuqishme e cila do ta përfaqësoj popullin e thjeshtë, në përgjithësi, është ajo që për momentin na nevojitet në Maqedoni” (68,5%), e që janë indikatorë tipikë të autoritarizmit dhe kohëve të fundit praktikimin e populizmit.

Të rinjtë janë të mendimit se shoqëria e tyre është e ngarkuar me probleme të shumta dhe manifestojnë optimizëm të matur kur bëhet fjalë për pritshmëritë e tyre për zhvillimin e gjendjes ekonomike në 10 vitet e ardhshëm.

Anëtarësimin në Bashkimin Evropian e mbështesin 81% e të rinjve.



## 3

# QASJA METODOLOGJIKE

## TEKNIKAT HULUMTUESE

Studimi mbështetet mbi kombinimin e procedurave hulumtuese kuantitative dhe kualitative, me analizën e të dhënave primare dhe sekondare. Më konkretisht, janë përdorur teknikat hulumtuese për grumbullimin e të dhënave, si vijon:

- Pasqyra e literaturës;
- Sy-më-sy anketë me model reprezentativ nacional, me pyetësor të standardizuar kryesor, identik për të gjitha vendet e EJL të përfshira në projektin e Fondacionit Fridrih Ebert;
- Intervista gjysmë të strukturuar.

Pyetësi anketues përbëhet nga tërësitë tematike, si vijon:

- Koha e lirë dhe stili i jetës;
- Vlera, religjioni dhe besimi;
- Familja dhe miqtë;
- Mobiliteti;
- Arsimi;
- Punësimi;
- Politika;
- Të dhëna demografike;
- Aneksi: Pyetje konfidenciale;
- Moduli specifik për vendin (me ajtema të detyrueshme).

Intervista përbëhet nga 10 pyetje transparente (me nën-pyetje) për të gjitha temat e Pyetësit, plus një pjesë kushtuar të dhënave demografike.

## DIZAJNI I MODELIT HULUMTUES DHE GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE

Për nevojat e hulumtimit anketues është dizajnuar modeli i stratifikuar në kuota.

Për këtë qëllim, janë përdorur të dhënat zyrtare për përqindjet<sup>1</sup> e popullsisë, të publikuara në ueb-faqen e Entit Shtetëror të Statistikave të Republikës së Maqedonisë.

Popullata e re maqedonase, në moshë prej 14 deri në 29 vjeç (e ndarë në tri kategori të grupmoshave nga Enti Shtetëror të Statistikave), fillimisht u segmentua në subgrupe ekskluzive, sipas tetë rajoneve statistikore të vendit dhe sipas komunave. Pastaj, në çdo segment/stratum rastet u kalkuluan dhe selektuan në bazë të raportit specifik të kuotave sipas: gjinisë, etnitetit dhe vendbanimit (urban/rural).

Madhësia e modelit është përlogaritur sipas formulës (me ç'rast gabimi margjinal është 3%, ndërsa niveli i besimit 95%). Madhësia e hulumtimit të popullatës së synuar – numri i përgjithshëm i njerëzve të rinj në moshë prej 14 deri 29 vjeç në Republikën e Maqedonisë është 454.979, kështu që sipas kërkesave të dokumentacionit të projektit, madhësia e modelit të parashikuar hulumtues ishte  $N=1065+200$ .

Ndërkaq, sa i përket intervistës, modeli përbëhet nga 10 të anketuar, njerëz të rinj nga Republika e Maqedonisë, heterogjen sipas karakteristikave demografike (siç është: gjinia, mosha, etniteti, shkalla e arsimit, vendbanimi).

Në kuadër të hulumtimit anketues në terren janë grumbulluar pyetësorët e plotësuar tërësisht nga gjithsej  $N=1038$  të anketuar. Hulumtimi u realizua me CAPI (Computer-assisted personal interviewing), në periudhën kohore nga 12. Shkurti deri më 12. Mars të vitit 2018. Për këtë qëllim u krijua versioni dygjuhësor (në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe) i Pyetësit, në Aplikimin

oflajn Android. Një numër i përgjithshëm prej 20 anketuesve e realizuan anketën sy-më-sy, me përdorimin e 20 njësisve Lenovo Tab 3 7 tabletë, në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë. Kohëzgjatja mesatare e një ankete është 45 minuta.

U realizuan me sukses 10 intervista të thella gjysmë strukturore, për të cilat u përpilua transkripti i spastruar.

## POST-TEST I RELIABILITETIT

Post-testi i reliabilitetit u realizua përmes CATI (Computer-assisted telephone interviewing) mbi 69 subjekte (6,6% nga modeli). Për këtë qëllim, Pyetësi anketues përmbante 14 pyetje<sup>2</sup> të nxjerra nga pyetësi kryesor të selektuara me qëllim që t'i mbulojnë llojet e ndryshme të variablave (nominale, ordinale dhe shkallore). Në SPSS (Statistical Package for the Social Sciences) u realizua Analiza Kapa, e cila konfirmoi reliabilitet.

## ANALIZA E TË DHËNAVE

Të dhënat u analizuan në nivel kuantitativ dhe kualitativ, me ç'rast janë përdorur metodat hulumtuese, si vijon:



- Metoda eksplorative;
- Metoda deskriptive;
- Metoda komparative;
- Metoda eksplanatore.

Të dhënat kuantitative të fituara nga hulumtimi anketues u analizuan në nivel univariant, bivariant dhe multivariant, përmes aplikimit të procedurave përkatëse statistikore në SPSS, të cilat janë interpretuar tekstualisht dhe janë prezantuar në mënyrë vizuale përmes fotografive, tabelave, grafikëve dhe diagrameve.



Të dhënat kualitative nga intervistat e realizuara u anonimizuan, u analizuan në mënyrë narrative dhe u prezantuan në formë të anekdotave dhe citateve.

## PËRSHKRIMI I MODELIT

Modeli hulumtues (N=1038), sipas të dhënave demografike përbëhet nga 50% të anketuar të gjinisë mashkullore dhe 50% të anketuar të gjinisë femërore. Sa i përket moshës, të anketuarit janë përfaqësuar sipas grupmoshave sipas këtij raporti: 14-19 vjeç (36%), 20-24 vjeç (33%) dhe 20-29 vjeç (31%).




Sipas vendbanimit, në total 66% e të anketuarve kanë deklaruar se jetojnë në mjedis urban, ndërsa 34% në mjedis rural.



Në lidhje me përkatësinë nacionale, 67% e të anketuarve janë maqedonas, 21% janë shqiptarë, ndërsa të tjerët janë romë, serbë, boshnjakë, vllah, turq, bullgarë, kroatë, malazezë, etj. thuaja se të gjithë, ose më saktësisht 98,7% kanë pasaportë maqedonase.

Përqindja më e madhe e të rinjve ose 48,20% u përgjigjën se mund t’ia lejojnë vetvetes disa gjëra më të kushtueshme, por jo edhe automobil ose banesë; 25,70% u përgjigjën se kanë mjaftueshëm para për ushqim, rroba dhe këpucë, por jo edhe për frigorifer, TV dhe ngjashëm; 7,70% u përgjigjën se kanë mjaftueshëm para vetëm për t’i paguar faturat elementare dhe për ushqim, 3% nuk kanë mjaftueshëm para as për faturat elementare, ndërsaq vetëm 15,40% mund t’ia lejojnë vetvetes çdo gjë që u nevojitet për standard më të mirë.



Madje 88,8% e të rinjve kanë dhomë të tyre në apartamentin ku jetojnë, ndërsa në apartamentin/shtëpinë e prindërve të tyre në të shumtën e rasteve ka dy dhoma. Në shtëpinë ku janë rritur të rinjtë, në të shumtën e rasteve ka pasur prej 10 deri 20 libra. Të

rinjtë me prindërit e tyre më së shpeshti posedojnë nga një apartament/shtëpi, 3 dhe më shumë telefona celularë, një kompjuter ose laptop, një koneksion-interneti në shtëpi, një biçikletë, një lavastovilje, një lavatriçe dhe një automobil.

TABELA NR. 1: **Pronësia materiale**

	0	1	2	3 e më shumë
Shtëpi ose apartament	1,5%	72,3%	19,8%	6,5%
Telefon Celular	,1%	13,9%	17,5%	68,5%
Kompjuter ose laptop	2,5%	50,6%	32,0%	14,9%
Koneksion-interneti në shtëpi	1,0%	73,0%	14,1%	11,9%
Biçikletë	25,1%	43,4%	21,9%	9,7%
Motoçikletë	68,4%	21,9%	6,9%	2,8%
Kondicionerë	44,4%	39,1%	11,8%	4,8%
Lavastovilje	39,9%	48,5%	7,6%	4,0%
Lavatriçe	1,6%	80,7%	13,7%	3,9%
Automobil	17,3%	53,8%	18,9%	10,0%







## 4

# STILI I JETËS DHE KOHA E LIRË

Stili i jetës i të rinjve e pasqyron mënyrën me të cilën të rinjtë (individualisht ose në mënyrë kolektive si grup) dëshirojnë ta kalojnë kohën e lirë dhe t'i shpenzojnë paratë, ose më konkretisht, i referohet shprehive, aktiviteteve, vlerave, interesave dhe modeleve të sjelljes së tyre.

## SHFRYTËZIMI I KOHËS SË LIRË

Analiza e të dhënave nga Anketa për shfrytëzimin e kohës nga Enti Shtetëror i Statistikave (2015: 28), e pasqyruar përmes numrit të orëve dhe minutave, tregon se të rinjtë e moshës prej 15 deri 24 vjeç mesatarisht kohën e shfrytëzojnë në këtë mënyrë: gjumë – 8,59, aktivitete të lira – 5,35, aktivitete shtëpiake – 0,53, punësim – 0,49, konsumim të ushqim dhe pijeve – 2,18, kujdes tjetër personal – 1,05, udhëtim – 1,13, shkollim – 2,46, punë vullnetare dhe ndihmë – 0,07.

Sipas të dhënave nga ky hulumtim, të rinjtë më së shpeshti dëgjojnë muzikë, e kalojnë kohën me familjen dhe dalin me miqtë, ndërsa rrallëherë meditojnë/praktikojnë joga, bëjnë punë vullnetare në projektet sociale dhe qëndrojnë jashtë vendit. Edhe në Studimin paraprak për të rinjtë të Fondacionit Fridrih Ebert (Topuzovska Latkovic, Borota Popovska, Serafimovska & Cekic, 2013) të rinjtë u përgjigjën se në kohën e lirë më së shpeshti dëgjojnë muzikë ose dalin me miq, me dallim se në studimin paraprak nuk ishte përfshirë opsioni – kalimi i kohës me familjen.

Edhe në këtë studim, si edhe në studimet paraprake për të rinjtë, konfirmohet se sporti nuk është diçka që të rinjtë në Republikën e Maqedonisë e praktikojnë shpesh, pavarësisht nëse bëhet fjalë për sport kreativ, amatorë ose profesional. Sipas studimit për Tendencat rinore në RM (Topuzovska Latkovic, 2014), madje gjysma e të rinjve (50%) nga moshë 15 deri në moshën 29-vjeça-


re nuk merren me sport dhe nuk praktikojnë ndonjë aktivitet fizik. Vetëm 1% e të rinjve profesionalisht merren me sport, 7% merren me sport amator, përkatësisht janë anëtarë në klube, marrin pjesë në trajnime të rregullta dhe/ose marrin pjesë në gara/ndeshje, ndërsa 42% merren me sport rekreativ ose praktikojnë aktivitete fizike në formë të hобit.

Kontrolli me testin jo-parametrik për krahasimin e të dhënave sipas gjinisë, me domethënie statistikore prej  $p < 0.05$  tregoi se të rinjtë e gjinisë mashkullore në krahasim me të rejtat e gjinisë femërore më shpesh: dalin me miq, merren me sport, luajnë video-lojëra, e kalojnë kohën nëpër bare, kafeteri dhe klube, bëjnë punë vullnetare në projekte sociale/aktivitete/iniciativa, kalojnë kohë në qendra rinore; ndërsa të rejtat e gjinisë femërore në krahasim me të rinjtë e gjinisë mashkullore më shpesh: dëgjojnë muzikë, lexojnë libra, e kalojnë kohën me familjen, i luten Zotit dhe bëjnë/bëjnë shopping.

Rezultatet e këtilla, në njëfarë mënyre, e sqarojnë ekzistimin e stereotipave të caktuara gjinore për “punë tipike femërore dhe mashkullore” dhe anasjelltas, por njëherësh edhe vënë në dukje dy karakteristika pozitive (punë vullnetare dhe vizitë të qendrave rinore) më shumë të përfaqësuara tek të rinjtë e gjinisë mashkullore, e që bashkërisht kanë të bëjnë me qytetarinë aktive.

Me korrelacionin bivariant u konfirmua se ekziston lidhje pozitive midis numrit të librave në shtëpi në të cilën janë rritur të rinjtë dhe praktikimi gjithnjë e më i madh i aktiviteteve siç është leximi i librave ( $r = .307$ ,  $p < 0.01$ ) dhe aktiviteti kreativ ( $r = .355$ ,  $p < 0.01$ ), e që e vë në dukje se këto shprehje pozitive tek të rinjtë prapëseprapë stimulohen nga mjedisi, përkatësisht në fazat e hershme të zhvillimit të personit.

FOTO NR. 6: **Aktivitetet e të rinjve në kohën e lirë**  
(vlerat mesatare të shkallës, prej 1 asnjëherë, deri në 5 – shumë shpesh)



### Si dhe për çka më së shpeshti e "shpenzoni" kohën e lirë dhe paratë në jetën e përditshme?

"Kohën e lirë e shpenzoj për sport, telenovela, shoqërim me miq, ndërsa paratë i shpenzoj për blerjen e telefonave të shtrenjtë, për rroba dhe ushqim, si dhe për gjëra të nevojshme për shtëpi." (Mina, 25 vjeç)

"Paratë më së shpeshti i shpenzoj për elektronikë dhe për rroba." (Filip 27 vjeç)

"Paratë që i fitoj i shpenzoj për udhëtime, libra, rroba dhe për të dalë me miq dhe me të dashurin." (Ana, 23 vjeç)

"Paratë i shpenzoj për të vizituar ndonjë vend në Maqedoni, për blerje të rrobave, ushqim dhe pije." (Elena 24 vjeç)

"Kohën e lirë e shfrytëzoj për sport dhe relaksim (lexim të librave, televizion). (Kate, 24 vjeç)

"Paratë i shpenzoj për kafe dhe cigare." (Petar 21 vjeç)

"Në kohën e lirë shoqërohem me shokë ose me të dashurën, dalim në kafe ose organizoj aktivitete jashtë shtëpisë." (Teon, 18 vjeç)


## PËRDORIMI I INTERNETIT

Gjithsej 95% e të rinjve kanë akses të rregullt në Internet, përkatësisht 76,9% – vazhdimisht, dhe 18,1% – çdo ditë ose thujta se çdo ditë, përqindja është e njëjtë si edhe para pesë vitesh.

Të rinjtë, brenda ditës, mesatarisht kalojnë rreth 3 orë duke shikuar TV dhe 6 orë në Internet. Është interesante e dhëna se në krahasim me Studimin për të rinj të vitit 2013, koha e kaluar në

Internet është rritur për plot 2 orë, ndërsa tek koha e kaluar para televizorit nuk ka ndryshime.

FOTO NR. 7: **TV Novela periodike për kohën e kaluar para TV dhe në internet**



Në lidhje me numrin e miqve në rrjetin social të cilin më së shumti e frekuentonin, kemi përgjigje të ndryshme, kështu që 42% kanë më shumë se 501 miq, 23% kanë prej 201 deri në 500, 15% prej 51 deri në 200 dhe 15% deri në 50 miq. Ndërkaq, në lidhje me pyetjen “Sa prej miqve/kontakteve në rrjetin social do t’i llogarisni në rrethin e ngushtë të miqve në jetën reale të përditshme?”, këto numra kanë rënie drastike, kështu që përgjigjet kryesisht kanë të bëjnë me numrin 5 dhe me pesë numrat e parë decimal.

TABELA NR. 2: Numri i miqve në jetën reale

Numri i miqve në jetën reale	%
5	15,5
10	21,9
15	5,9
20	16,1
30	10,3
40	3,8
50	5,4


FOTO NR. 8: Numri i “miqve” virtual



■ Më shumë se 501: 42%    ■ Deri në 50: 20%  
 ■ 201-500: 23%    ■ 51-200: 15%

Përveç kësaj, të rinjve iu parashtrua pyetja sa shpesh e përdorin Internetin për qëllime të caktuara (në shkallën prej 1 – asnjëherë, deri në shkallën 3 – shpeshherë), me ç’rast nga analiza përmes përlllogaritjes së vlerave mesatare u fitua e dhëna se të rinjtë e përdorin më së shpeshti Internetin në rrjetet sociale dhe për komunikim me familjarët dhe miqtë – e që bashkërisht nënkuptojnë aktivitete sociale, pastaj për shkollë/arsim dhe/ose punë dhe në vend të tretë për leximin e lajmeve/informacioneve onlajn dhe për shkarkimin dhe dëgjimin e muzikës. Të rinjtë Internetin më së paku e shfrytëzojnë për punë bankare onlajn dhe vlerësimin e produkteve dhe/ose shërbimeve.

FOTO NR. 9: Sa shpesh përdoret interneti për qëllimet si vijojnë



U fitua vlera mesatare  $m=2,50$  për pyetjen: Sa u besoni rrjeteve sociale për përdorimin e përgjegjshëm të të dhënave tuaja personale? (në shkallën prej 1 deri në 5, me ç'rast 1 është aspak, ndërsa 5 plotësisht). Ky është edhe një konfirmim se të rinjtë në Republikën e Maqedonisë padyshim se u takojnë gjeneratave Y dhe Z. Edhe pse nuk kanë besim në rrjetet sociale atyre aspak nuk ju pengon që të jenë pjesë e rrjeteve sociale, të pranojnë persona të cilët i njohin pjesërisht ose persona të cilët fare nuk i njohin për "miq" dhe onlajn të shkëmbejnë të dhëna personale.

Nga ky bllok i pyetjeve dhe përgjigjeve të pranuar, mund të vërejmë se të rinjtë, si pjesëtarë të dy gjeneratave më të ekspozuara teknologjike gjatë historisë, njëkohësisht jetojnë në dy bota, në botën reale dhe në botën virtuale. Përfitimet nga interneti të rinjtë më së shumti i shohin në mundësitë për integrim social dhe për komunikim, edukim, informim dhe për argëtim/zbavitje.

Në kontekstin e pohimeve të caktuara se krahas anëve pozitive, Interneti ka edhe ndikim negativ mbi të rinjtë dhe mbi suksesin e tyre në shkollë/fakultet, kontrolli i lidhshmërisë midis kohës së kaluar në Internet dhe suksesit shkollor/akademik, vë në dukje korrelacion pozitiv ( $r=107$ ,  $p<0.05$ ), përkatësisht një raport të drejtë proporcional midis numrit të orëve dhe notave, me ç'rast supozimi i këtyllë mund të hidhet poshtë.

## PËRDORIMI I SUBSTANCAVE TË DËMISHME PËR SHËNDETIN

Shprehitë dhe sjelljet e rrezikshme të cilat e dëmtojnë shëndetin dhe jetën e njeriut, siç është përdorimi i duhanit, konsumimi i alkoolit dhe substancave psikotropike, si dhe fillimi i hershëm i marrëdhënieve të pambrojtura seksuale, janë të pranishme në mesin e të rinjve në Republikën e Maqedonisë.

Sipas rezultateve të këtij hulumtimi, 26% e të rinjve rregullisht pinë duhan, 18% periodikisht dhe 56% nuk pinë duhan, ndërsa përqindjet janë identike sikurse edhe në Studimin për të rinj nga viti 2013. Kjo e dhënë konfirmohet tre herë për popullatën e synuar të njëjtë, nëse merret në konsideratë se edhe sipas studimit Tendencë rinore (Markoviq, 2014), 25,8% e të rinjve në moshë prej 15 deri në 29 vjeç janë duhanpirës.

Sa i përket konsumimit të alkoolit, vërehet rritje e vogël tek përqindjet e atyre të cilët janë përgjigjur se rregullisht konsumojnë alkool – 2% (0.6% në vitin 2013), disa herë në javë – 12% (8% në vitin 2013), vetëm gjatë fundjavave – 24% (19% në vitin 2013). Rrallë ose asnjëherë nuk konsumojnë alkool në total 62% (73% në vitin 2013).

FOTO NR. 10: **A jeni duhanpirës?**







FOTO NR. 11: **A pini alkool?**




Analiza e nivelit bivariat, me krostabulimin e të dhënave sipas gjinisë, dhe përmes kontrollit të Kuadratit X ( $\chi^2=20.403$ ,  $p<0.01$ ), vë në dukje se të rinjtë e gjinisë mashkullore janë duhanpirës në numër më të madh, në krahasim me gjininë femërore.

FOTO NR. 12: **A jeni duhanpirës?** Krostabulimi sipas gjinisë

Nga ana tjerë, Analiza e nivelit bivarial, përmes krostabulimit të të dhënave sipas gjinisë, dhe përmes kontrollit të Kuadratis X ( $\chi^2=34.330$ ,  $p<0.01$ ) vë në dukje se të rinjtë e gjinisë mashkullore në masë më të madhe konsumojnë alkool, në krahasim me të rinjtë e gjinisë femërore.

FOTO NR. 13: **A pini alkool?** Krostabulim sipas gjinisë

Pjesa më e madhe ose 89% e të rinjve u përgjigjën se nuk përdorin droga të lehta, siç është marihuana, megjithatë, 11% e tyre janë përdorues, prej të cilëve 3,3% disa herë në javë dhe 2,6% gjatë fundjavave.

FOTO NR. 14: **A përdorni droga të lehta si marihuana?**

Edhe në këtë rast, asociacioni i rëndësishëm statistikor është evidentuar me përqindje më të larta tek popullata mashkullore ( $\chi^2=13.906$ ,  $p<0.01$ ).



Meqë për këto çështje janë regjistruar dallime të konsiderueshme statistikore, sa u përket të gjitha karakteristikave sociale, si dhe me qëllim që të bëhet profili i njerëzve të rinj në lidhje me prirjen për konsumimin e substancave të dëmshme, siç është: alkooli dhe drogat e lehta/marihuana, e që njëkohësisht janë të rrezikshme për shëndetin e përgjithshëm dhe për shëndetin psiko-social, është bërë analiza klaster.

Kjo qasje ndërlidhet me teorinë e grupeve të bashkëmoshatarëve (Oetting & Beauvais, 1987). Sipas kësaj teorie, anëtarët në kuadër të këtyre grupeve janë të lidhur emocionalisht njëllor sikurse edhe në familje. Në kuadër të këtyre grupeve zhvillohen aktivitete të cilat më së shpeshti kanë të bëjnë me kohën e lirë, argëtimin dhe ngjashëm. Megjithatë, në një pjesë të caktuar të rasteve, në grupet e bashkëmoshatarëve zhvillohen norma dhe vlera të ndryshme prej atyre që ekzistojnë në familje ose në shkollë.

Rezultatet e analizës i konfirmojnë supozimet e këtilla, veçanërisht për grupmoshën prej 14 deri në 19 vjeçare, që korrespondon me periudhën e adoleshencës dhe të shkollimit të mesëm, kur të rinjtë janë më pak rezistentë ndaj ndikimeve negative ose janë më të predispozuar të provojnë gjëra të reja. Megjithatë, njëkohësisht kemi të dhëna për ekzistimin e dallimeve sa u përket modeleve të sjelljes sipas vlerave kulturore, nëse e marrim parasysh faktin se shoqëria maqedonase përbëhet nga grupe me përkatësi të ndryshme etnike dhe fetare.


Për analizën-klaster<sup>3</sup> janë përdorur variabla për karakteristikat demografike të të rinjve, siç janë: gjinia, nacionaliteti/etniteti, shkalla e arsimit, vendbanimi dhe moshë, në lidhje me pyetjet: a konsumoni alkool dhe a konsumoni droga të lehta siç është marihuana?

Tendencë më e madhe për konsumin e alkoolit dhe drogave të lehta siç është marihuana ka tek ky profil i njerëzve të rinj (klaster nr. 3): kryesisht të gjinisë mashkullore, por edhe të gjinisë femërore, kryesisht maqedonas dhe në përqindje të vogla të tjerë, me arsim fillor dhe të mesëm, kryesisht nga vendbanimet urbane, por në përqindje shumë më të vogël edhe nga vendbanimet rurale, në moshë prej 14 deri në 19 vjeç.



## AKTIVITETI SEKSUAL DHE PARANDALIMI

Sa i përket aktivitetit seksual kemi të dhëna interesante se madje 27% e të rinjve u përgjigjën se nuk ndihen komod të përgjigjen në këtë pyetje, dhe 15% fare nuk janë përgjigjur, e që vetvetiu flet se seksi është tabu-temë në mesin e të rinjve.



Thuaja se një e katërta u përgjigjën se akoma nuk kanë pasur marrëdhënie seksuale, një pjesë po aq e madhe prej 22% kanë pasur marrëdhënie seksuale me një partner/partnere, dhe 29% kanë pasur marrëdhënie seksuale me më shumë partnerë.

Rezultatet e studimit Tendencë rinore (Markoviq, 2014) vë në dukje se për herë të parë marrëdhënia seksuale më së shpeshti bëhet në periudhën e adoleshencës dhe më së shpeshti si mjet për parandalimin e shtatzënisë së padëshiruar theksohet përdorimi i kondomit.

TABELA NR. 3: **Cili prej këtyre pohimeve më së miri e përshkruan përvojën tuaj seksuale? Krostabulimi sipas grupmoshave**

Grupmoshat	Cili prej këtyre pohimeve më së miri e përshkruan përvojën tuaj seksuale? Krostabulimi sipas grupmoshave			
	Akoma nuk kam pasur marrëdhënie seksuale	Kam pasur marrëdhënie seksuale me një partner/partnere	Kam pasur marrëdhënie seksuale me më shumë partnerë	Nuk ndihem komod të përgjigjem në këtë pyetje
14–19	46,6%	15,9%	16,2%	21,2%
20–24	15,3%	20,1%	32,5%	32,1%
25–29	2,1%	31,7%	39,0%	27,2%

Sa i përket krostabulimit sipas grupmoshave, mund të vërehet se seksualisht më aktive është grupmosha prej 25 deri në 29 vjeç, ndërsa më pak aktive grupmosha prej 14 deri në 19 vjeç. Është

evidentuar asociacioni i rëndësishëm statistikor ( $\chi^2=1,963$ ,  $p<0.01$ ) për ekzistimin e dallimit midis tre grupeve në nivel të popullatës së synuar të përgjithshme.

TABELA NR. 4: **Cili prej pohimeve në vijim më së miri e përshkruan përvojën tuaj seksuale? Krostabulimi sipas gjinisë**

Gjinia	Cili prej pohimeve në vijim më së miri e përshkruan përvojën tuaj seksuale? Krostabulimi sipas gjinisë			
	Akoma nuk kam pasur marrëdhënie seksuale	Kam pasur marrëdhënie seksuale me një partner/partnere	Kam pasur marrëdhënie seksuale me më shumë partnerë	Nuk ndihem komod të përgjigjem në këtë pyetje
Femërore	30,2%	26,6%	15,0%	28,2%
Mashkullore	14,5%	18,1%	42,4%	24,9%

Sa i përket krostabulimit sipas gjinisë, mund të vërehet se seksualisht janë më aktivë dhe më shpesh i ndërrojnë partnerët seksual të rinjtë e gjinisë mashkullore në krahasim me të rinjtë e gjinisë femërore, me ç'rast është evidentuar asociacioni i rëndësishëm statistikor ( $\chi^2=89,823$ ,  $p<0.01$ ).

Megjithatë, sa i përket seksit si tabu – temë, përqindja është e ngjashme tek të gjitha grupmoshat të të dyja gjinive.

Sipas përlogaritjes së mesatares, të rinjtë e gjinisë femërore përvojën e parë seksuale e përjetojnë në moshën 18 vjeçare (min=15, max=27), ndërsa të gjinisë mashkullore në moshën 17 vjeçare (min=14, max=24).

Thuaja se gjysma e të rinjve (48%) ndonjëherë përdorin mbrojtje gjatë marrëdhënies seksuale, 21% përdorin çdoherë, një e katërta nuk përdor asnjëherë (25%), dhe 6% nuk e dinë se çka do të thotë ky termin/nuk janë të informuar.

Në lidhje me abstenimin seksual para martesës, të rinjtë nga Republika e Maqedonisë kanë mendime të ndara, kështu që 36% janë të mendimit se bëhet fjalë për koncept anakronik dhe 29% se është barrë e panevojshme psikologjike për të rinjtë, ndërsa për 19% është vlerë/virtyt për të dyja gjinitë dhe për 16% vlerë/virtyt për vajzat.

FOTO NR. 18: **A përdorni mjete kontraceptive ose metoda për kontrollin e lindjes?**





FOTO NR. 19: **Qëndrimi për abstenimin seksual para martesës**

## ASPEKTI DEVIJANT TEK TË RINJTË

Për ajtemat të cilat janë version i shkurtuar i shkallës së devijimit – Normative Deviance Scale (NDS), me shtrirje teorike prej 7 deri 35, është përlogaritur rezultati përfundimtar i 905 të anketuarve të cilët në mënyrë autentike iu përgjigjën pyetjes, me ç’rast vlera mesatare është  $M=12$  (min.=7, max.=29, std.dev.=4.03). Sipas kësaj, mund të themi se popullata e re maqedonase, në përgjithësi, manifeston vlera të ulëta në shkallën e devijimit (vjedhje, sjellje joadekuate në shkollë, përdorimi i drogave të rënda, vandalizëm, sulm mbi ndonjë person). Testi për kontrollin e reliabilitetit tregon konsistencë të lartë interne ( $\alpha=.725$ ) në këtë shkallë.

Më shumë hulumtime aludojnë në faktin se grupet bashkëmoshatare janë burimi kryesor për sjelljen devijante dhe delikuen-te tek të rinjtë, edhe pse domosdoshmërisht kjo nuk duhet të jetë çdoherë kështu. Sipas analizës<sup>4</sup>, nuk ekzistojnë dallime sa i përket moshës në lidhje me vlerat devijante tek popullata e re maqedonase, kështu që hidhet poshtë presupozimi për presionin e grupit të moshatarëve.

## TRAJEKTORJA E RRJEDHËS SË JETËS DHE TRANZICIONI NGA ADOLESHEN-CA NË MOSHËN MADHORE

Tri periudha kohore janë kryesore nga perspektiva e rrjedhës së jetës: koha individuale, koha e gjeneratës dhe koha historike (Price, McKenry, and Murphy, 2000). Koha individuale ka të bëjë me kohën kronologjike. Supozohet se periudha e jetës, siç është fëmijëria, adoleshenca, koha e maturimit, pozitativ me ndikim,

shërbimet dhe të drejtat në shoqëri, mbështeten në bazë të përkufizimeve të përpiluara kulturologjike për moshën. (Hagestad and Neugarten, 1985). Koha e gjeneratës ka të bëjë me grupmoshat ose me grupet moshatare në të cilat njerëzit janë grupuar sipas moshës së tyre ose sipas periudhës së lindjes. Ndërsa, koha historike ka të bëjë me kontekstin shoqëror dhe me ngjarjet dhe ndryshimet (politike, ekonomike, teknologjike etj.) në të cilat jetojnë njerëzit.

Sipas Elder (1985), koha mund të pasqyrohet edhe përmes sekuencave të tranzicioneve. Tranzicioni është ndryshim ose ngjarje e rëndësishme jetësore në trajektoren e jetës, me ç’rast trajektorja është sekuencë e gjendjeve të lidhura, e gjendjeve të shtrirjes së përcaktuar konceptuale të sjelljes ose përvojës gjatë rrjedhës së jetës. Tranzicionet më së shpeshti shoqërohen me rituale dhe ceremoni të caktuara, siç është diplomimi, dasma dhe ngjashëm, dhe rezultojnë me ndryshimin e statusit, identitetit social dhe rolit. Trajektoreset janë modele afatgjata të stabilitetit dhe ndryshimit kështu që mund të përfshijnë më shumë tranzicione. Avancimi i trajektores ndërlidhet me rritjen e viteve/me moshën, në mënyrë që disa tranzicione mund të konsiderohen si më adekuate në kuptimin e moshës dhe ngjarjes, ndërsa disa i çrregullojnë kornizat e përcaktuara sociale kohore, përkatësisht ndodhin shumë herët ose shumë vonë (Hagestad and Neugarten, 1985). Si pesë ngjarje kryesore në trajektoren e rrjedhës së jetës, të kalimit nga adoleshenca në moshën madhore, konsiderohen: kryerja e arsimit, punësimi i parë stabil, largimi nga shtëpia familjare/pavarësia në aspektin e banimit, lidhja e martesës dhe lindja e fëmijës së parë. Edhe pse këto ngjarje kryesore kanë efekte afatgjata mbi ardhmërinë dhe rrjedhën e jetës, megjithatë, duhet të merret në konsideratë se disa prej tyre mund të kthehen në gjendjen e mëparshme, si për shembull, mbetja pa punë dhe kthimi në shtëpinë e prindërve, apo të mos nënkuptoj pavarësi të plotë, për shembull, në rastin kur të rinjtë kanë mbështetje financiare dhe ndihmë nga prindërit në aspektin e banimit. Zakonisht mendohet se periudha e adoleshencës është moshë jetësore prej 13 deri 18 vjet, ndërsa moshë madhore e re nga 19 dhe në 29 vjeç.

Me analizën e të dhënave sipas mediana, mund të vërejmë se të rinjtë e gjinisë femërore, varësisht nga niveli i arsimit, kanë trajektore të ndryshme të rrjedhës jetësore, me ç’rast ashtu siç rritet niveli i arsimit ashtu rritet edhe moshë në të cilën ndodhin ngjarjet kryesore jetësore, ndërsa vëllimi i kohës së kaluar për të gjitha ngjarjet kryesore të trajektores reduktohet me rritjen e nivelit të arsimit, (arsimi fillor – 8 vjet, i mesëm – 5 vjet, i lartë – 2 vjet). Së këtejmi, trajektorja e rrjedhës së jetës tek të anketuarit me arsim të kryer fillor, nga aspekti kohor, fillon më herët se të tjerët, me kryerjen e shkollimit fillor në moshën 14 vjeçare, punësimi i parë ndodhë në moshën 18,5 vjeçare, shpërngulja nga shtëpia e prindërve ndodhë në moshën 16 vjeçare – para punësimit dhe para lidhjes së martesës në moshën 21 vjeçare (e që nënkupton një itinerar ndryshe të trajektores të rrjedhës jetësore nga trajektorja e zakonshme), një vit pas lidhjes së martesës ndodhë lindja e fëmijës së parë – në moshën 22 vjeçare. Tek të anketuarat e gjinisë femërore me arsim të kryer të mesëm, në



FOTO NR. 20: **Trajektorja e tranzicionit të ngjarjeve kryesore jetësore tek të rinjtë e gjinisë femërore**





FOTO NR. 21: **Trajektorja e tranzicionit të ngjarjeve kryesore jetësore tek të rinjtë e gjinisë mashkullore**



moshën 18 vjeçare ekziston një model ndryshe. Punësimi i qëndrueshëm ndodhë 2 vjet pas kryerjes së arsimit – në moshën 20 vjeçare, në periudhën e njëjtë – në moshën 20 vjeçare ndodhë edhe shpërngulja nga shtëpia e prindërve, ndërsa vitin e njëjtë bëhet edhe lidhja e martesës, gjashtë muaj më vonë – në moshën 20,5 vjeçare, ndërsa lindja e fëmijës së parë ndodhë dy vjet pas lidhjes së martesës – në moshën 23 vjeçare. Tek kjo grupmoshë, mosha prej 20 vjeç është kryesore për tri ngjarje jetësore që kanë të bëjnë me pavarësinë (punësimi, shpërngulja nga shtëpia familjare dhe lidhja e martesës). Tek kategoria e tretë e të anketuarave të gjinisë femërore me arsim të kryer të lartë, kemi një model të tretë të trajektorës së rrjedhës së jetës, i ngjashëm me atë paraprak – të atyre me arsim të mesëm, por me dallim prej 4 vitesh, me ç’rast mund të vërehet një prolongim i pavarësisë, e që mesa duket ka të bëjë me vazhdimin e arsimit (i cili zakonisht zgjatë 4 vjet). Ky grup, arsimin e vet e kompletton në moshën 23 vjeçare, ndërsa mosha prej 24 vjet është kyç për tri ngjarje jetësore që kanë të bëjnë me pavarësinë (punësimi, shpërngulja nga shtëpia familjare dhe lidhja e martesës), në moshën 25 vjeçare ndodhë lindja e fëmijës së parë.

Sidoqoftë, për interpretimin korrekt të kësaj analize duhet të merret parasysh se shumicës së të anketuarve akoma nuk iu ka ndodhur pjesa më e madhe e këtyre ngjarjeve jetësore, përkatësisht rastet e analizuarja janë në numër të vogël edhe sa i përket shpejtësisë, kështu që konkluzionet nuk mund të përgjithësohen. Më konkretisht, me arsim të kryer – 67,9% e rasteve; me punësim të qëndrueshëm – 22,8%; pavarësi në aspektin e banimit – 13,1%; martesë – 13,2%; fëmija e parë – 9,8%.

Sipas rezultateve të analizës mediana, edhe tek të anketuarit e gjinisë mashkullore janë evidentuar 3 modele të ndryshme të trajektoreve, me ç’rast me rritjen e shkallës së arsimit rritet edhe mosha kur ndodhin ngjarjet kryesore jetësore ndërkaq, nga ana tjetër, vëllimi i kohës së kaluar për të gjitha ngjarjet kryesore të trajektorës reduktohet me rritjen e shkallës së arsimit, për 4 vjet (fillore – 11 vjet, i mesëm – 7 vjet, i lartë – 3 vjet). Tek ata me arsim fillor i cili kryhet në moshën 14 vjeçare punësimi stabil ndodhë në moshën 16 vjeçare, por sa i përket pavarësisë së banimit ka ndërprerje të trajektorës, përkatësisht fare nuk iu ka ndodhur kjo ngjarje (që devijon nga trajektorja e zakonshme), lidhja e martesës ndodhë në moshën 22 vjeçare, ndërsa lindja e fëmijës së parë 3 vjet më vonë, përkatësisht në moshën 25 vjeçare. Tek meshkujt me arsim të mesëm, të cilin e kryejnë në moshën 18 vjeçare, punësimi stabil ndodhë një vit më vonë, në moshën 19 vjeçare, pavarësia sa i përket banimit në moshën 22 vjeçare, lidhja e martesës në moshën 24 vjeçare dhe lindja e fëmijës së parë në moshën 25 vjeçare. Tek ata me arsim të lartë ekziston një model krejtësisht ndryshe, përkatësisht mosha prej 23 vjeç është kryesore për tri ngjarje jetësore (për kryerjen e arsimit, punësim dhe pavarësi në banim), ndërsa tre vjet më vonë, në moshë të njëjtë – prej 26 vjeç, ndodhë lidhja e martesës dhe lindja e fëmijës së parë.


Edhe në këtë rast, të dhënat e analizuarja vlejnë vetëm për një pjesë të të anketuarve dhe jo për të gjithë, ose më konkretisht: me arsim të kryer – 67,5% të rasteve; punësim stabil – 22,6%; pavarësi në banim – 4,6%; martesë – 7,4%; fëmija e parë – 4,4%.

Përqindjet e këtyra janë tregues për gjendjet në lidhje me procesin e tranzicionit nga adoleshenca deri në moshën madhore, tek të rinjtë e gjinisë mashkullore dhe femërore në Republikën e Maqedonisë, e që e vë në dukje se pavarësia tek të rinjtë është një proces i gjatë dhe i prolonguar.

## FINANCA PËR NEVOJA PERSONALE

Të pyetur sa para kanë për nevoja personale në krahasim me moshatarët, gjysma e të rinjve – 55 %, u përgjigjën se kanë financa mesatare, gjithsej 25 % se kanë financa mbi mesataren dhe gjithsej 20 % më pak se mesatarja.

FOTO NR. 22: **Në krahasim me njerëzit e moshës tuaj në Maqedoni: sa para keni për nevojat e juaja personale?**



## KONKLUZIONE

- Të rinjtë më së shpeshti dëgjojnë muzikë, kohën e kalojnë me familjen dhe dalin me miqtë, ndërsa shumë rrallë meditojnë/ praktikojnë jogë, bëjnë punë vullnetare në projekte sociale dhe qëndrojnë jashtë vendit. Të rinjtë e gjinisë mashkullore në krahasim me të rinjtë e gjinisë femërore më shpesh: dalin me miq, merren me sport, luajnë video-lojëra, e kalojnë kohën në bare, kateferi dhe klube, bëjnë punë vullnetare në projektet sociale, aktivitete/iniciativa, e kalojnë kohën në qendra rinore, ndërsa të rinjtë e gjinisë femërore në krahasim me të rinjtë e gjinisë mashkullore më shpesh: dëgjojnë muzikë, lexojnë libra, e kalojnë kohën me familjen, i luten Zotit dhe blejnë/bëjnë shopping;
- Të rinjtë, mesatarisht, brenda ditës përafërsisht kalojnë 3 orë duke shikuar televizor dhe 6 orë në Internet. Është interesante dhe dhëna se në krahasim me studimin për të rinjtë nga viti 2013, koha e kaluar në Internet është rritur për plot 2 orë;
- Të rinjtë Internetin më së shpeshti e përdorin për interaksion dhe komunikim social, për edukim, informim, si dhe për argëtim/zbavitje;
- 26% e të rinjve janë duhanpirës të rregullt, 18% të përkohshëm dhe 56% nuk janë duhanpirës, përqindjet janë identike si edhe në Studimin për të rinjtë nga viti 2013. Sa i përket konsumimit të alkoolit, vërehet rritje e vogël tek përqindjet e atyre të cilët janë përgjigjur se rregullisht konsumojnë alkool – 2 % (0,6% në vitin 2013), disa herë në javë – 12 % (8% në vitin 2013), vetëm gjatë fundjavave – 24 % (19% në vitin 2013). Rrallëherë ose asnjëherë nuk konsumojnë alkool në total 62 % (73 % në vitin 2013). Pjesa më e madhe ose 89% e të rinjve u përgjigjën se nuk përdorin droga të lehta siç është marihuana;
- Tendencë më të madhe për konsumin e alkoolit dhe drogave të lehta ka tek profili në vijim i njerëzve të rinj: të gjinisë mashkullore, maqedonas, me arsim fillor dhe të mesëm, nga vendbanimet urbane, në moshë prej 14 deri 19 vjeç;
- Të rinjtë e gjinisë femërore përvojën e parë seksuale e përjetojnë në moshën 18 vjeçare, ndërsa të gjinisë mashkullore në moshën 17 vjeçare. Të rinjtë e gjinisë mashkullore seksualisht janë më aktivë dhe më shpesh i ndërrojnë partnerët seksual, në krahasim me të rinjtë e gjinisë femërore, por në lidhje me seksin si tabu-temë, përqindja është e ngjashme tek të gjitha grupmoshat të të dyja gjinive;
- Popullata e re maqedonase, marrë në përgjithësi, manifeston vlera të ulëta në shkallën e devijimit;
- Të rinjtë e gjinisë femërore, varësisht nga shkalla e arsimit, kanë trajektore të ndryshme të rrjedhës jetësore, me ç'rast ashtu siç rritet shkalla e arsimit, rritet edhe mosha kur ndodhin ngjarjet kryesore jetësore, ndërsa sasia e kohës së kaluar për të gjitha ngjarjet kryesore të trajektores ndryshon me rritjen e shkallës së arsimit;

- Edhe tek të anketuarit e gjinisë mashkullore u evidentuan tre modele të ndryshme të trajektores së rrjedhës jetësore, me ç'rast me rritjen e shkallës së arsimit rritet edhe moshë në të cilën ndodhin ngjarjet kryesore jetësore, ndërsa sasia e kohës së kaluar për të gjitha ngjarjet kryesore të trajektores reduktohet me rritjen e shkallës së arsimit;
- Të pyetur sa para kanë për nevojat personale, në krahasim me moshatarët e tyre, gjysma e të rinjve – 55 %, u përgjigjën se kanë financa mesatare, gjithsej 25 % mbi mesataren dhe gjithsej 20 % më pak se mesatarja.

## REKOMANDIME

- Me qëllim që kohën e lirë të rinjtë ta kalojnë në mënyrë më të organizuar dhe më të strukturuar, por edhe si preventiv për t'u përfshirë në botën virtuale të Internetit, rekomandohet të themelohen qendra rinore të cilat do të ofrojnë programe dhe aktivitete joshëse për të rinjtë, si dhe promovim më aktiv të aktiviteteve sportive tek të rinjtë përmes garave/ndeshjeve, çmimeve dhe manifestimeve.
- Rekomandohet që përmes programeve për punë vullnetare të inkorporohet punë me dobi shoqërore për të rinjtë, në nivel lokal në kuadër të komunave në të cilat jetojnë, me qëllim të ndërgjegjësimit për qytetari aktive, veçanërisht për projektet sociale, me theks të veçantë mbi përfitimet personale dhe shoqërore nga sjellja proaktive.
- Nevojitet të stimulohet të menduarit kreativ dhe inovativ tek të rinjtë, përmes përdorimit të llojeve të ndryshme të mekanizmave dhe platformave.
- Më adekuate është të zbatohen ligjërata dhe punëtori për ndërgjegjësim në lidhje me pasojat e dëmshme nga cigaret, alkooli dhe droga mbi shëndetin, veçanërisht tek të rinjtë në moshë prej 14 deri në 19 vjeç kur ekziston predispozicion më i madh për ndikime negative.
- Duhet të inkorporohet lënda shëndeti seksual dhe reprodaktiv në kuadër të procesit të rregullt mësimor në klasën e fundit të arsimit fillor ose në fillimin e arsimit të mesëm, në mënyrë që të prevenohet në pjesën e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, por edhe të tejkalohet problemi i seksit si tabu-temë.
- Për shkak të tranzicionit të prolonguar nga adoleshenca në moshën madhore tek të rinjtë dhe varësia financiare nga prindërit, të krijohen dhe të zbatohen masa për ndihmë për banim, për vetëpunësim ose programe për bursa, të cilat do ta lehtësojnë procesin e pavarësimit të të rinjve dhe formimin e familjes, veçanërisht tek të rinjtë e ekspozuar në rrezik nga varfëria.
- Të krijohen programe mentorimi në arsimin fillor dhe të mesëm, si dhe nëpër komuna, me qëllim që të prevenohet delikuenca e shpeshtuar e të miturve, si dhe të stimulohet niveli i përfshirjes së të rinjve në punë vullnetare.



## 5

# MOBILITETI

Migrimi konsiderohet si njëra nga çështjet më të rëndësishme politike për një vend dhe është sfidë e madhe në domenin e krijimit të politikave dhe strategjive, ndërkaq përfshin më shumë fusha, nga qëndrueshmëria ekonomike deri te siguria nacionale. Akoma më i rëndësishëm është migrimi rinor.

## KONTEKSTI NACIONAL

Shkalla e papunësisë të të rinjve (rreth 50% në kontinuitet) është dyfish më e madhe nga shkalla e përgjithshme e papunësisë në vend (e cila gjithashtu është e lartë), një pjesë e madhe e popullsisë jeton në varfëri – 21,9%, kemi përqindje të lartë të familjeve të cilat rrisin fëmijë, ndërkaq janë të ekspozuara në rrezik nga varfëria (dy persona të moshë madhore me dy fëmijë që i rrisin – 20,2%, dy persona të moshës madhore me tre e më shumë fëmijë që i rrisin – 51,2%, prindër të vetëm me fëmijë të cilët i rrisin – 37,5%), paga mesatare në vend është 400 euro, ndërsa shpërndarja e pabarabartë e të ardhurave, e shprehur përmes koeficientit Gini është 33,6 (Enti Shtetëror i Statistikave, 2017; 2018).

## TENDENCA TË PËRGJITHSHME PËR MIGRIMIN RINOR

Zakonisht hulumtimet presupozojnë se të rinjtë ose janë migrantë të varur të cilët i shoqërojnë prindërit ose të rriturit, ata vetë janë migrantë ekonomik (Tienda, Taylor, and Moghan, 2007). Gjithnjë e më shpesh edhe mundësitë arsimore janë motiv për migrimin dhe mobilitetin rinor. Procesi i Bolonjës dhe programet e BE-së, të cilat ofrojnë mbështetje për realizimin e mobilitetit akademik, siç është Erasmus, Tempus, Erasmus Mundus ( Erasmus Mundus) dhe Maria Kiri (Marie Currie), kontribuan në drejtim të rritjes së konsiderueshme të mobilitetit akademik në Evropë. Këto përpjekje u intensifikuan viteve të fundit, me vendosjen e prioritetit “deri në vitin 2020, më së paku 20% të stu-

dentëve të cilët diplomojnë në hapësirën evropiane të arsimit të lartë të kenë realizuar periudhë të studimit jashtë vendit”, si dhe me themelimin e programit Erasmus+, i cili parashikon buxhet të rritur të dedikuar për realizimin e mobilitetit individual (Bozhinoska, Jakasanovski dhe Mirçevska, 2015).

Investimi tek fëmijët, përmes migrimit më të shpeshtë arsimor ose për punë, është pjesë e Strategjisë gjithëpërfshirëse të familjes për diversifikimin e rrezikut dhe sigurimin e stabilitetit afatgjatë financiar dhe për mirëqenien e familjes (Lauby and Stark, 1988; Stark and Bloom, 1985). Dallimi konsiston në atë se në rastin kur mundësitë për punë janë motiv për migrim, familjet kanë pritshmëri reale për kthimin e shpejtë të investimeve të tyre (Massey et al., 1993; Stark and Bloom, 1985; Todaro, 1969), ndërkaq nga ana tjetër, prindërit e migrantëve për arsimin e tyre i pret një periudhë investimi shumëvjeçar dhe i kushtueshëm.

Modelin kryesor të migrimit të brendshëm në vendet në zhvillim është të rinjtë e mjediseve rurale të migrojnë në mjediset urbane, ndërsa, modeli i migrimit të jashtëm është të rinjtë nga vendet më pak të zhvilluara të migrojnë në vendet me zhvillim më të lartë. Edhe në të dyja këto raste, shpërndarja e pabarabartë e resurseve dhe mundësive ndikon mbi fluksin e migrantëve (Piore, 1979; Todaro, 1969). Më shumë faktorë i stimulojnë të rinjtë që të migrojnë, prej të cilëve disa janë motive direkte – dëshira për tu punësuar dhe për arsim por, nga ana tjetër, këto motive gjenezën e tyre mund ta kenë në komponentat ideologjike, si për shembull, faktorët kulturorë dhe psiko-social (Massey et al., 1993; Punch, 2007).

## TË DHËNAT E DERITANISHME NË LIDHJE ME DUKURINË NË NIVEL NACIONAL

Viteve të fundit, në publikë më zëshëm se kurdoherë, u aktualizua çështja e shpërnguljes së njerëzve të rinj nga Republika e Maqedonisë. Pikërisht rezultatet e hulumtimit nga Studimi paraprak për të rinjtë nga viti 2013 i Fondacionit Fridrih Ebert

shërbyen si shkas që të përkushtohet vëmendje më e madhe ndaj kësaj dukurie. Sipas të dhënave nga hulumtimi i studimit (Topuzovska Latkovic, Borota Popovska, Serafimovska & Cekic, 2013: 56), çdo i ri i dytë në vitin 2013 ka planifikuar ose ka menduar të largohet nga vendi. Në studimin për papunësinë e njerëzve të rinj në Republikën e Maqedonisë (Topuzovska Latkovic, Borota Popovska dhe Starova, 2016), po ashtu të Fondacionit Fridrih Ebert, të realizuar mbi popullatën e të rinjve të papunësuar, kjo shkallë është akoma më e lartë, përkatësisht sipas rezultateve madje 80% e njerëzve të papunësuar të rinj në vitin 2016 kanë menduar ose planifikuar të largohen nga vendi. Në të dy studimet, si motive më të rëndësishme për këtë tendencë, apostrofohen financat dhe standardi i jetës, përkatësisht papunësia dhe varfëria në vend, përkundrajt kushteve më të mira për arsim, punë dhe jetë jashtë vendit.

Sipas rezultateve të Studimit kualitativ për të rinjtë (Topuzovska Latkovic et al, 2016), të rinjtë mund ta imagjinojnë ardhmërinë në vendin e tyre, por nëse ai iu mundëson të fitojnë mjaftueshëm që të mund t'i përmbushin shpenzimet elementare për jetë, të mund të udhëtojnë nëpër botë dhe të bëjnë pushime verore/dimërore, të jetojnë në një shoqëri të sigurt, të lirë, të pa ndotur dhe moderne.

Si implikim nga hulumtimet e realizuara për të rinjtë fitohet përshtypja se të rinjtë shpërnguljen e perceptojnë si mundësi që të kenë pavarësi financiare nga prindërit dhe të kenë autonomi banimi, duke mos mundur ta realizojnë të njëjtën përmes punësimit në vendin e tyre. Sipas hulumtimeve, 80% e të rinjve të moshës madhore akoma jetojnë në shtëpinë e prindërve të tyre (Topuzovska Latkovic, Borota Popovska, Serafimovska & Cekic, 2013).

Krahas rëndësisë së kësaj çështjeje për shtetin, prapëseprapë mungojnë të dhëna konkrete në lidhje me atë se në ç'masë është masive kjo tendencë. Në ueb-faqen e Entit Shtetëror të Statistika-ve të RM-së, në pjesën e bazës MAKSTAT, në mënyrë identike, si edhe në publikimin Migracione të ESHS ekziston e dhëna se zyrtarisht, në vitin 2016, nga vendi në shtete tjera përgjithmonë janë shpërngulur 140 njerëz të rinj (në moshë prej 15 deri në 29 vjeç), me ç'rast nuk ka devijime më të mëdha sa i përket numrit në krahasim me vitet e kaluara të dekadës së fundit. Nuk ka të dhëna zyrtare për mobilitetin studentor/numrin e studentëve të cilët kanë studiuar, studiojnë jashtë vendit (Bozhinoska, Jakasanovski dhe Mirçevska 2015).

Sipas rank-listës së Forumit Ekonomik Botëror (2017) për kompetitivitetin e vendeve, Republika e Maqedonisë, në lidhje me aftësinë për t'i mbajtur njerëzit e talentuar është në vendin e 129 në botë (me vlerë mesatare prej 2,24 në shkallën prej 1 deri në 7, me ç'rast 1 – më të mirët dhe më të mençurit largohen nga vendi dhe i shfrytëzojnë mundësitë jashtë vendit të tyre, 7 – më të mirët dhe më të mençurit mbesin në vend ...).

## **PËRVOJA E QËNDRIMIT JASHTË VENDIT PËR SHKAK TË ZHVILLIMIT PROFESIONAL EDHE PËR NJË KOHË MË TË GJATË**

Një përqindje e përgjithshme e lartë e të rinjve nuk kanë qëndruar jashtë vendit për studime ose trajnime (82,10%), megjithatë 41,80% prej tyre kanë për qëllim që një gjë të këtillë ta realizojnë në të ardhmen, ndërsa 40,30% nuk e kanë fare një qëllim të këtillë. Përgjigje pohuese në total kanë dhënë 15,80% e të rinjve, me ç'rast 5,70% kanë qëndruar jashtë vendit si pjesë të arsimit profesional dhe trajnimit, 5,40% në kuadër të arsimit të mesëm dhe 4,70% në kuadër të arsimit të lartë.

Madje 91% e të rinjve nuk kanë qëndruar jashtë vendit më gjatë se 6 muaj.

Nëse merret parasysh vlera e ulët mesatare nga kapitulli i parë i këtij Studimi (Stili i jetës dhe koha e lirë), në lidhje me pyetjen sa shpesh të rinjtë qëndrojnë jashtë vendit  $m=1,94$  (në shkallën prej 1 – asnjëherë deri në 5 – shpeshherë), mund të konstatohet se njerëzit e rinj në Republikën e Maqedonisë, përgjithësisht jashtë vendit udhëtojnë rrallë, ndërkaq akoma më rrallë qëndrojnë në periudha më të gjata jashtë vendit, me qëllim që të mësojnë ose të trajnohen, që nënkupton se pritishtëritë e tyre për jetën jashtë vendit nuk bazohen mbi përvojën personale.

FOTO NR. 23: **A keni qëndruar ndonjëherë jashtë vendit për shkak të studimit dhe trajnimit?**






FOTO NR. 24: **A keni qëndruar jashtë vendit tuaj më gjatë se 6 muaj?**



## DËSHIRA PËR MIGRIM

Sa i përket dëshirës për migrim jashtë vendit, të rinjtë mund të ndahen në tre grupe: një e treta e të rinjve kanë dëshirë të madhe të largohen nga atdheu i tyre, një e treta kanë shprehur dëshirë mesatare për migrim, dhe një e treta nuk kanë fare dëshirë të këtillë. Në shkallën prej 1 – nuk kam qëllim të emigroj deri në shkallën 5 – dëshirë shumë të madhe për të migruar, mesatarja aritmetike është  $M=2,91$  (std.dev.=1,422), që locohet në intervalin negativ të boshtit, afër mesatares, kështu që mund të konstatohet se, marrë në përgjithësi, popullata e re maqedonase nuk ka tendencë të madhe për migrim.

FOTO NR. 25: **Dëshirë për t'u larguar nga atdheu**



**Çka ju mban/çka do t'ju mbante të vazhdoni të jetoni në vendlindjen tuaj në të ardhmen? (Ndërkaq, nëse jeni të sigurt se megjithatë një ditë do të largoheni nga vendi juaj, ju lutemi na i sqaroni pritshmëritë që i keni nga vendi i dëshiruar – nga vendi pritës)**

“Ajo që më mban këtu janë prindërit e mi, dhe si vajza e vetme e tyre asnjëherë nuk do t'i lija të vetëm.” (Ana, 23 vjeç.)

“Akoma më mban familja, lidhjet e ndërtuara familjare, dëshira për prosperitet në vendlindjen time.” (Tara, 23 vjeç)

“Jetoj në Maqedoni për shkak të familjes, dhe lirisë që e kanë qytetarët.” (Elena, 24 vjeç)

“Për momentin më mban familja ime, ndërsa sa i përket të ardhmes do të më ndalonte nëse rriten pagat, me ç'rast do të kemi jetë më të mirë.” (Mina, 25 vjeç)

“Që të mos largohem nga vendi ndikon komfori që e kam, mbështetja e familjes, dashuria ndaj vendit, fakti që e njoh qytetin dhe njerëzit në të. Nëse vendos të largohem nga vendi kjo do të jetë për shkak të përsosjes sime profesionale jashtë vendit.” (Kate, 24 vjeç)

“Do të qëndroja në Maqedoni nëse rriten pagat për të gjitha profesionet dhe të gjitha profesionet të vlerësohen njëllëj, dhe jo të rriten ato me fakultet dhe të përçmohen ata pa fakultet.” (Simona, 19 vjeç)

“Ajo që më mban në Maqedoni është fakti se këtu jam lindur dhe rritur, më përshtatet mentaliteti maqedonas dhe kisha dashur edhe fëmijët e mi të rriten këtu.” (Bojan, 25 vjeç)

“Deri më tani në këtë vend më mban familja dhe do të më ndalte standardi më i lartë, megjithatë, kisha shkuar në ndonjërin nga vendet e BE, ndërsa pritshmëritë i kam të punësohem, standard më i lartë dhe cilësi më e mirë e jetës.” (Filip, 27 vjeç)

“Akoma jam këtu për shkak të të afërme të mi (familja dhe miqtë). Por, do të shkoja jashtë vendit për shkak të mundësisë që përmes punës së dëshiruar të ndërtoj karrierë ndërkombëtare.” (Teon, 18 vjeç)

Me analizën komparative të të dhënave nga të gjitha studimet për të rinjtë në rajonin e EJL nga projekti i FES, fitohen të dhëna se Republika e Maqedonisë në lidhje me dëshirën për migrimin e të rinjve nuk dallon shumë nga vendet siç është Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia, por mund të vërehet një dallim me vendet anëtare të BE tek të cilat kjo tendencë është më e ulët.

FOTO NR. 26: **Analiza Kros – nacionale: Dëshira për migrim në vendet e EJT – krahasim i vlerave mesatare**





FOTO NR. 27: **Seri kohore për planet e migrimit**



Në vazhdim janë prezantuar disa korrelacione në lidhje me variablin dëshirë për migrim, të analizuar në nivelin bivariant.

Nga analiza mund të vërehet se midis variablës dëshirë për migrim dhe disa variablave që kanë të bëjnë me statusin socio-ekonomik<sup>5</sup>, ekziston korrelacion i rëndësishëm statistikor.

Ekziston korrelacion negativ midis dëshirës për migrim me variablat të cilat e pasqyrojnë gjendjen financiare të të rinjve – para për nevoja personale ( $r=-.103$ ,  $p<0.01$ ) dhe gjendja financiare në familje ( $r=-.095$ ,  $p<0.01$ ), sa më ulët janë të vlerësuar aq më shumtë rritet dëshira për migrim; korrelacion negativ midis dëshirës për migrim dhe variablit punësim sipas profesionit – ashtu siç rriten vlerat (nga 1 – punoj sipas profesionit deri në 4 – nuk jam i trajnuar/i kualifikuar për asnjë profesion) ashtu rritet edhe dëshira për migrim ( $r=.111$ ,  $p<0.05$ ).

Pastaj, ekziston korrelacion negativ midis dëshirës për migrim dhe kënaqësisë nga jeta familjare ( $r=-.071$ ,  $p<0,05$ ), rrethi i miqve të ngushtë ( $r=-.092$ ,  $p<0,01$ ), arsimi ( $r=-.130$ ,  $p<0,01$ ), puna ( $r=-.143$ ,  $p<0,01$ ) dhe jeta në përgjithësi ( $r=-.093$ ,  $p<0,01$ ). Aq sa shënon rënie kënaqësia ose rritet pakënaqësia, po aq rritet edhe dëshira për migrim.

Ekziston korrelacion pozitiv midis projekcionit për ardhmërinë personale dhe dëshirës për migrim ( $r=.086$ ,  $p<0,01$ ), ndërsa korrelacion negativ për projekcionin për ardhmërinë e shtetit dhe dëshirës për migrim ( $r=-.073$ ,  $p<0,05$ ). Kjo nënkupton se sa më të mëdha të jenë pritshmëritë e të rinjve për ardhmërinë personale ato kanë dëshirë më të madhe për migrim dhe sa më të këqija që i kanë pritshmëritë për ardhmërinë e shtetit, në masë më të madhe, dëshirojnë të migrojnë.

Është interesante e dhëna se midis dëshirës për migrim të të rinjve dhe vet-perceptimit personal ose vet-identifikimit si qytetarë të Evropës dhe botës, nuk ka kurrfarë lidhshmërie, por ka korrelacion negativ midis dëshirës për migrimin e të rinjve dhe vet-perceptimit personal ose vet-identifikimit si qytetarë të Republikës së Maqedonisë ( $r=-.251$ ,  $p<0,01$ ), rajoni ( $r=-.216$ ,  $p<0,01$ ) dhe vendbanimi ( $r=-.205$ ,  $p<0,01$ ). Sa më pak të rinjtë e përjetojnë vetveten si qytetarë të RM-së, rajonit dhe vendbanimit, aq më e madhe është dëshira për migrim.


Në Studimin paraprak për të rinj nga viti 2013 pyetja nuk është formuluar në formë shkallore, por të rinjve iu shtrua pyetja se a planifikojnë të largohen nga vendi – me përgjigje të mundshme: “Po”, “Jo”, “Ndoshta” dhe “Sigurisht jo” – kështu që për këtë shkak të dhënat nuk janë komparabile në kuptimin metodologjik.

Si mënyrë e mundshme që nga aspekti kohor të krahasohen këto të dhëna, duhet të krahasohet numri i atyre të cilët kanë deklaruar se nuk kanë dëshirë dhe as që planifikojnë të largohen nga vendi, 25% në Studimin paraprak të vitit 2013 dhe 26% në këtë Studim (me përqindje të njëjtë 6% të përgjigjeve “nuk e di” në të dyja studimet), e që tregon se nuk kemi ndryshime sa i përket këtij qëndrim të të rinjve.

Sa i përket planit kohor për qëndrim në vendin pritës, është interesante që përqindja e njëjtë prej 33,80% si edhe në Studimin e vitit 2013 (33%), janë përgjigjur se planifikojnë përgjithmonë të jetojnë në vendin e dëshiruar.



FOTO NR. 28: **Analiza klaster në lidhje me dëshirën për migrim "Sa është e madhe dëshira juaj që të migroni nga vendi për më gjatë se 6 muaj?"**



Analizat nuk treguan asociacione të rëndësishme statistikore për shkallën e arsimit dhe suksesit akademik, në raport me dëshirën për migrim<sup>6</sup>.


Është bërë analiza klaster, me dëshirë që të përshkruhet profili i të rinjve të cilët kanë tendencë të madhe të migrojnë, me ç'rast janë përfshirë më shumë variabla për karakteristikat demografike të të rinjve, siç është mosha, etniteti, shkalla e arsimit dhe vendbanimi, në raport me variablën – dëshirë për shpërngulje nga vendi<sup>7</sup>. Tendencë më të madhe për migrim ka klasteri numër 1, përkatësisht grupi i njerëzve të rinj: kryesisht maqedonas, por në një pjesë shumë më të vogël edhe shqiptarë dhe të tjerë, në moshë prej 14 deri 19 vjeç, me arsim fillor dhe të mesëm, kryesisht nga vendbanime urbane, por edhe nga vendbanime rurale.

## SHKAQET PËR MIGRIM

Me qëllim që të analizohen qëndrimet e të rinjve lidhur me shkaqet e dëshirës për migrim, përkatësisht për largimin nga vendi, iu ofruan disa shkaqe të mundshme, si dhe opsioni i hapur – tjetër, dhe u kërkua t'i përcaktojnë shkaqet kryesore të shpërnguljes.

Për shumicën e njerëzve të rinj ose për 48,30 % shkaku kryesor për shpërngulje është përmirësimi i standardit jetësor, pastaj theksohet paga më e lartë për 17,50%, mundësi më të mira për punësim për 11,30% dhe arsim më të mirë për 7,80% e të anketuarve. Shkaqe tjera janë zgjedhur në më pak se 5% të rasteve, siç është: stabiliteti social dhe politik në vend, të njoftohem me kulturë të ndryshme, të largohem nga situata e papërshtatshme, që të jem afër njerëzve për të cilët kujdesem, mundësi më të mira për fillimin e biznesit personal, diversitet më i madh kulturor.

FOTO NR. 29: **Shkaqet e migrimit**



**Cilët janë problemet më të mëdha me të cilat përballen të rinjtë në shoqërinë bashkëkohore maqedonase?**

“Problemi më i madh në vend janë mundësitë e kufizuara për punë dhe përparim.” (Teon, 18 vjeç)

“Problem për të rinjtë në vend është punësimi dhe të ardhurat e ulëta të cilat nuk mjaftojnë për tu pavarësuar.” (Irina, 19 vjeç)

“Problemi më i madh është papunësia dhe pagat e ulëta – madje nëse i riu gjen ndonjë punë.” (Filip, 27 vjeç)

“Përveç problemeve me të cilat ballafaqohet çdo njeri i ri, pavarësisht shtetit (siç është presioni për sukses), në Maqedoni mendoj se shumica e të rinjve ballafaqohen me paragjykime dhe diskriminim, në bazë gjinore, nacionale, diskriminim për shkak të përcaktimit seksual ose për shkak mundësive financiare.” (Dritan, 17 vjeç)

“Lufta që ta gjejnë vendin e tyre në shoqëri, sipas mendimit tim, është problemi më i madh i të rinjve. Meqë civilizimi perëndimor ndikon me të madhe përmes filmave holivudian dhe rrjeteve sociale mbi idenë se si do të dukej jeta ideale, të rinjtë në Maqedoni tentojnë që në çdo mënyrë të vijnë deri tek të mirat materiale pa u përpjekur për të njëjtat, me një qëllim të vetëm që ta prezantojnë këtë në rrjetet sociale dhe jo për shkak të faktit se personi ka motive të mirëfillta që të investohet në ndonjë aktivitet, me qëllim të fundit që të vijë deri në përmirësimin e tij personal ose të shoqërisë të cilës i përket.” (Bojan, 25 vjeç)

“Problemet me të cilat ballafaqohen të rinjtë janë financiare, arsimore të cilët nuk u ofrojnë bazë praktike të ndihen të sigurt gjatë përzgjedhjes së punës, kultura lokale nuk iu lejon të mendojnë jashtë kutisë (outside of the box) etj.” (Kate, 24 vjeç)

“Problemi më i madh është se pas kryerjes së fakultetit, të rinjtë nuk mund të gjejnë punë në profesionin që e kanë kryer. Kështu që punojnë kudo qoftë për shumë pak para. E gjithë kjo kontribuon që të rinjtë të mos jenë të lumtur dhe të jenë të demotivuar dhe depresiv, ndërsa shpëtimin ta kërkojnë jashtë shtetit.” (Mina, 25 vjeç)

**DESTINACIONI I DËSHIRUAR**


Si destinacion më i dëshiruar për shpërngulje në mesin e të rinjve, në vend të parë është Gjermania – me 23,1% të të rinjve, në vend të dytë është përsëri Gjermania me 13,1%, ndërsa në vendin e tretë është Zvicra me 10,5%.

TABELA NR. 5: **Destinacioni i dëshiruar për migrim**



Destinacioni i dëshiruar për migrim	
Vendi i parë	Gjermania
Vendi i dytë	Gjermania
Vendi i tretë	Zvicra

**PLANI PËR MIGRIM**

Ata njerëz të rinj tek të cilët ka një dëshirë të caktuar për migrim, me një përqindje të lartë (35%) u përgjigjën se do të migronin në dy vitet e ardhshëm, dhe me një përqindje të përafërt prej 31% në pesë vitet e ardhshëm, me një përqindje më të ulët 15% u përgjigjën se do të largoheshin nga vendi në dhjetë vitet e ardhshëm, 13% në gjashtë muajt e ardhshëm, dhe 6% pas më shumë se dhjetë vitesh.



Pjesa më e madhe të rinjve do të jetonin për çdoherë jashtë vendit 33%, ndërsa një përqindje kumulative prej 24% do të jetonin jashtë vendit më së shumti deri në 5 vjet.

FOTO NR. 31: **Plani për të mbetur në vendin – pritës**

## AKTIVITETE TË NDËRMARRA PËR MIGRIM

Në nën-modelin e të rinjve të cilët kanë një tendencë të caktuar të largohen nga atdheu i tyre, kemi një përqindje të lartë të të anketuarve (43,50%) të cilët nuk kanë ndërmarrë asgjë për këtë qëllim, 16,60% kanë kontaktuar miq dhe/ose familjarë prej të cilëve presin ndihmë për tu shpërngulur në vendin e dëshiruar,

vetëm 3,20% e kanë kontaktuar ambasadën e vendit të dëshiruar, 4,70% kanë kontaktuar punëdhënës potencial, 4,50% kanë kontaktuar shkolla/universitete potenciale dhe vetëm 1,70% kanë siguruar bursën. Me seleksionimin vetëm të rasteve të cilët e kanë rrethuar 4-dëshirë e madhe dhe 5-dëshirë shumë e madhe, këto përqindje janë për një nuancë më të larta. Përqindja e përgjithshme e atyre të cilët kanë ndërmarrë ndonjë aksion nuk është e mundur të prezantohet, meqë pyetja është formuluar me më shumë përgjigje të mundshme.

Rezultatet e këtyra tregojnë proaktivitet të ulët tek të rinjtë, përkatësisht pak aktivitete të ndërmarrura konkrete për shpërngulje nga vendi, që e vë në pikëpyetje seriozitetin/vendosmërinë e tyre për një hap të këtyllë.

## INFORMIMI I MUNDËSIVE PËR MIGRIM

Të rinjtë, përveç asaj se nuk ndërmarrin veprime konkrete për shpërngulje, manifestojnë edhe nivel të ulët të informimit/njohurive për mundësitë e migrantëve në vendin e dëshiruar. Sipas analizës, me përlogaritjen e mesatares aritmetike (në shkallën prej 1 – aspak, deri në 5- shumë), të gjitha vlerat e fituara mesatare janë nën tre, përkatësisht në intervalin negativ të boshtit. Nga ana tjetër, tek të anketuarit të cilët kanë dëshirë të madhe për migrim vlerat mesatare janë pak mbi 3 për të gjitha ajteimat.




FOTO NR. 32: **Masa të ndërmarrura konkrete për shpërngulje**

FOTO NR. 33: **Niveli i njohimit për mundësitë e imigrantëve**FOTO NR. 34: **Niveli i njohjes së gjuhës zyrtare në vendin e preferuar – pritës**

## NJOHJA E GJUHËS


Pjesa më e madhe e të rinjve (44%) u deklaruan se posedojnë shkathësi bazike të komunikimit për gjuhën zyrtare të vendit të dëshiruar, e zotërojnë mirë 15,70%, e zotërojnë shkëlqyeshëm 11,60%, ndërsa fare nuk e njohin gjuhën 28,70%. Nuk ka ndonjë dallim të konsiderueshëm në përgjigjet e atyre të cilët kanë dëshirë të madhe të migrojnë.

Në shkallën prej 1 deri në 5, me vlerë mesatare prej  $M=3,66$  (std.dev=1,151) të rinjtë dëshirojnë ta mësojnë gjuhën e cila prak-

tikohet në vendin e dëshiruar, që nënkupton një gatishmëri të caktuar.

Gjysma e të rinjve të cilët kanë dëshirë të caktuar të migrojnë, kanë ftesë nga dikush që jeton në vendin e dëshiruar, tek ata të anketuar të cilët kanë shprehur dëshirë të madhe për migrim, kjo përqindje është më e lartë edhe atë 62,90%, që do të thotë se edhe për këtë pyetje (ngjashëm edhe si për punësimin), ata mbështeten tek miqtë/familjarët/të njohur.


FOTO NR. 35: Ftesë nga dikush që jeton në vendin e preferuar



## PËRFITIME POTENCIALE PËR VENDIN – PRITËS

Përqindjet janë të larta (mbi 90 %) për shpërndarjen e përgjigjeve sa i përket kontributit potencial drejt zhvillimit dhe prosperitetit të vendit të dëshiruar – vend pritës i të rinjve. Më konkretisht, thuhet se të gjithë të rinjtë të cilët kanë dëshirë të migrojnë u përgjigjën se do të kontribuonin përmes: zhvillimit kulturor dhe/ose shkencor, shkëmbimit të njohurive dhe aftësive, demonstrimit të nivelit të lartë të kryerjes së punës, qytetarisë së përgjegjshme dhe lojale. Kemi përqindje më të ulët (por, jo edhe më e ulëta) vetëm të përgjigjeve pohuese (56,20%) për opsionin pranim të punës e cila nuk është e dëshiruar nga popullata lokale. Kjo nënkupton se secili person i dytë i ri nga Republika e Maqedonisë nuk do të pranonte “çfarëdo lloj” pune jashtë vendit, e që ndërlidhet me të dhënat e deritanishme për të rinjtë në vend, se shpeshojnë për punë me pagë të lartë, në profesion, në kompani të suksesshme, e cila ofron karrierë dhe zhvillim të shpejtë, privilegje e beneficione dhe ngjashëm, ndërsa vendi i dëshiruar-vendi pritës do duhej që ta mundësoj një gjë të këtillë.

FOTO NR. 36: Kontribut potencial drejt zhvillimit dhe prosperitetit të vendit të dëshiruar – pritës



## KONKLUZIONE

- Madje 91 % e të rinjve nuk kanë qëndruar jashtë vendit më shumë se 6 muaj. Nëse merret parasysh edhe vlera e ulët mesatare nga Kapitulli i parë i këtij Studimi (Stili i jetës dhe koha e lirë), sa i përket pyetjes sa shpesh të rinjtë qëndrojnë jashtë vendit M=1,94 (në shkallën prej 1 – asnjëherë, deri në 5- shpeshherë), mund të konstatohet se njerëzit e rinj në Republikën e Maqedonisë, në përgjithësi, rrallëherë udhëtojnë jashtë vendit e që do të thotë se pritshmëritë e tyre për jetën jashtë vendit nuk bazohen mbi përvojën personale;
- Sa i përket dëshirës për migrim jashtë vendit, të rinjtë mund të ndahen në tre grupe: një e treta e të rinjve kanë dëshirë të madhe të largohen nga atdheu i tyre, një e treta kanë shprehur dëshirë mesatare për migrim dhe një e treta nuk e kanë fare një dëshirë të këtillë;
- Me analizën komparative të të dhënave nga të gjitha studimet për të rinjtë në rajonin e EJL nga projekti FES fitohen të dhëna se Republika e Maqedonisë, sa i përket dëshirës për migrimin e të rinjve, nuk dallon shumë nga vendet siç është: Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia, megjithatë, mund të vërehet dallimi me vendet anëtare të BE-së tek të cilat kjo tendencë është më e ulët;
- 25 % në Studimin paraprak dhe 26 % në këtë Studim (me përqindje të njëjtë 6 % të përgjigjeve “nuk e di” në të dy studimet), u përgjigjën se nuk kanë dëshirë dhe as plan që të largohen nga vendi, e që tregon se nuk ka ndryshime sa i përket këtij qëndrimi tek të rinjtë;
- Sa i përket planit kohor për të qëndruar në vendin pritës, është interesante se kemi përqindje të njëjtë prej 33,80 % si edhe në Studimin nga viti 2013 (33 %), u përgjigjën se planifikojnë përgjithmonë të jetojnë në vendin e dëshiruar;
- Ekziston korrelacion negativ midis dëshirës për migrim me variablat që e pasqyrojnë gjendjen financiare të të rinjve – para për nevoja personale dhe gjendja financiare në familje, sa më ulët të jenë vlerësuar aq më e madhe është dëshira për migrim; korrelacion negativ midis dëshirës për migrim dhe variablës punësim sipas profesionit – sa më shumë që rriten vlerat (1 – punoj sipas profesionit, 4 – nuk jam i trajnuar/i kualifikuar për asnjë profesion), aq më shumë rritet dëshira për migrim;
- Tendencë më të madhe për migrim ka profili në vijim i njerëzve të rinj: kryesisht maqedonas, në moshë prej 14 deri 19 vjeç,

me arsim fillor dhe të mesëm, kryesisht nga vendbanime urbane;

- Për shumicën e njerëzve të rinj, ose për 48,30% shkaku kryesor për shpërngulje është përmirësimi i standardit jetësor, pastaj theksohet paga më e lartë për 17,50%, mundësi më të mira për punësim për 11,30% dhe arsim më të mirë për 7,80% e të anketuarve;
- Si destinacion më i dëshiruar – numër një për shpërngulje në mesin e të rinjve është Gjermania;
- Rezultatet tregojnë proaktivitet të dobët tek të rinjtë, përkatësisht pak aktivitete të ndërmarra konkrete për shpërngulje nga vendi e që e vë në pikëpyetje seriozitetin/vendosmërinë e tyre për një hap të këtillë;
- Të rinjtë, përveç faktit që nuk ndërmarrin veprime konkrete për shpërngulje, manifestojnë edhe nivel të ulët të njohurive/informimit për mundësitë e imigrantëve në vendin e dëshiruar;
- Gjysma e të rinjve të cilët kanë dëshirë të caktuar për migrim, kanë ftesë nga dikush që jeton në vendin e dëshiruar, tek ata të anketuar që kanë shprehur dëshirë të madhe për migrim kjo përqindje është më e lartë edhe atë 62,90%, që do të thotë se edhe për këtë pyetje (ngjashëm si edhe për punësimin), ata mbështeten mbi miqtë/familjarët/të njohurit;
- Secili njeri i ri i dytë në Republikën e Maqedonisë nuk do të pranonte “çfarëdo lloj” pune jashtë vendit;
- Ajo që në masë më të madhe i mban të rinjtë të mos migrojnë padyshim se është familja.

## REKOMANDIME

- Nevojitet që pushteti qendror, duke e përfshirë edhe Agjencinë për Programe Arsimore Evropiane dhe Mobilitet, si dhe Agjencinë për të Rinj dhe Sport, të krijojnë fushatë nacionale për diseminimin e mundësive në kuadër të programeve, siç është ERAZMUS+, dhe të mundësojnë qasje më të mirë deri te udhëzimet dhe procedurat administrative për aplikim në programe të këtij lloji.
- Sugjerohet nevoja që të organizohen udhëtime më të shpeshta jashtë vendit nga ana e institucioneve arsimore, si dhe të krijojnë dhe zhvillojnë programe për shkëmbimin e nxënësve dhe studentëve në nivel ndërkombëtar.
- Nevojitet të evidentohet dhe hartëzohet mobiliteti arsimor dhe i punës të të rinjve, me qëllim që të fitohen të dhëna të dobishme për tendencën e këtillë (profili demografik, socio-ekonomik dhe arsimor i të rinjve të cilët migrojnë; destinacioni i tyre gjeografik; organizata arsimore/e punës e cila i pranon; kohëzgjatja e qëndrimit, etj.) qëllimi është të stimulohet mobiliteti, përkatësisht migrimi i përkohshëm, por njëkohësisht të reduktohet rreziku që ai të shndërrohet në të përhershëm. Për këtë qëllim, nevojitet qasje holistike dhe bashkëpunim formal të të gjitha institucioneve të involvuara/palëve të interesuara.
- Nevojitet të analizohen masat dhe efektet e Strategjisë nacionale për reduktimin e largimit të kuadrit me arsim të lartë dhe për rrjetëzim dhe bashkëpunim 2013–2020 dhe e njëjta të rishikohet sipas nevojës ose të krijohet e re.
- Të krijohet platformë onlajn e cila do t'i përmbaj të gjitha informacionet e nevojshme dhe të dobishme për vendet më të preferuara, përmes së cilës të rinjtë do të mund të informohen para se ta marrin vendimin për migrim.
- Të krijojnë programe në partneritet me organizata qytetare nga vendet e Bashkimit Evropian, të cilët janë lartë të rankuara sa i përket indeksit për angazhim rinor, për shkëmbimin e “praktikave më të mira”, “rekomandimeve për krijimin e politikave” dhe të kurrikulave për “implementim”.







## 6

# INDIVIDIDI, RELACIONET ME TË TJERË, MARTESA DHE

Kjo pjesë përmban tri tërësi, e para i përkushtohet individit të ri, vlerave të tij, qëndrimeve dhe besimeve, duke e përfshirë këtu edhe frikën dhe shqetësimet e tij për ardhmërinë; tërësia e dytë i përkushtohet individit të ri në fushën sociale me fokus mbi relacionet e tij sociale, besimin tek njerëzit e tjerë, si dhe mbi perceptimin e tij për pabarazinë në shoqëri dhe tërësia e tretë i përkushtohet martesës dhe familjes<sup>8</sup>.

## INDIVIDIDI: VLERAT, QËNDRIMET DHE BESIMI I TË RINJVE


### Vlerat e të rinjve në Republikën e Maqedonisë

Vlerat i pasqyrojnë parimet kryesore të njeriut: motivet gjithëpërfshirëse të njeriut të cilat ndikojnë mbi qëndrimet e tij dhe i formësojnë, madje ndikojnë edhe mbi atë se si ai vepron/si sillet në mjedisin. Hulumtimet e deritanishme tregojnë se vlerat ndikojnë mbi bindjet politike të njeriut, gatishmërinë e njeriut për të marrë pjesë në aksion politik, mbi zgjedhjen e karrierës, mbi ndjenjat e njeriut për mirëqenien personale (Schwartz, 2011). “Vlerat përdoren për t’i karakterizuar grupet kulturore, shoqëritë dhe individët, ta trasojnë ndryshimin shoqëror me kalimin e kohës dhe t’i shpjegojnë bazat e motivimit të qëndrimeve dhe sjelljes” (Schwartz, 2012).


Në këtë Studim për të rinjtë në Republikën e Maqedonisë 2018, një pjesë iu përkushtua pyetjes që ka të bëjë me atë se çka është e rëndësishme për të rinjtë, me ç’rast përgjigjet e pranuar ishin në shkallën prej 1 (“fare nuk e kam me rëndësi”) deri në shkallën

5 (“shumë e kam me rëndësi”). Analiza tregoi se për 5 nga 16 vlerat (ose për 31% të vlerave) mesatarja aritmetike është mbi 4,50; për 8 nga 16 vlerat (për 50%) mesatarja aritmetike është midis vlerës 4 dhe 4,50, ndërsa vetëm për 2 nga 16 vlerat (ose, vetëm për 19%) vlerat aritmetike lëvizin nga vlera 2,4 deri në 3,2. Vlerat më të rëndësishme për të rinjtë janë: “të jesh besnik/lojal ndaj partnerit/partneres”, “të jesh i pavarur”, “të jesh besnik/lojal ndaj miqve”, si dhe “të kesh karrierë të suksesshme” dhe “të merret përgjegjësi”. Çështje më pak të rëndësishme në jetën e të rinjve janë: “të jesh aktiv politikisht” dhe “të marrësh pjesë në aktivitete/iniciativa qytetare”.

Si edhe në studimet paraprake (shih: Jakimovski etj. 2014) tanimë u dëshmuar disa vlera të cilave të rinjtë vazhdimisht u përkushtojnë vëmendje më të madhe dhe këto janë: “të ndërtoj karrierë të suksesshme”, “të jem prind i mirë”, “të kem martesë të suksesshme” dhe “të kem partner (jetësor/të dashur) përkatës”. Kjo tendencë që t’i përkushtohet rëndësi vlerave individuale që kanë të bëjnë me jetën familjare, miqësinë, ndërkaq të shënoj ulje rëndësia e disa vlerave të përgjithshme, siç është “interesimi për politikë” dhe “iniciativa qytetare” vërehet edhe në disa vende të Evropës (YOUTH 2010: the social profile of young people in Slovenia), por gjithsesi janë edhe shkaqet lokale në kontekstin e ngjarjeve në fushën shoqërore-politike në Maqedoni.

FOTO NR. 37: **Vlerat e të rinjve në Maqedoni (sipas mesatareve aritmetike)**FOTO NR. 38: **Dendogram për klasterët e vlerave** Dendogram për lidhjen mesatare (mes...)

Rishkallëzim i klasterit të kombinuar



Ky dendogram nga analiza – klaster në mënyrë vizuale i pasqyroj klasterët e vlerave të cilat gjithnjë e më shumë ose gjithnjë e më pak janë të rëndësishëm për të rinjtë në RM. Në klasterin e parë janë vlerat më të rëndësishme, tanimë të përmendura, të cilat janë më shumë personale dhe kanë të bëjnë me individin dhe familjen e tij dhe me rrethin e miqve: “të jesh lojal ndaj partnerëve”, “miqve dhe punëdhënësve” dhe “të jesh i pavarur”. Një

klaster tjetër i rëndësishëm janë vlerat familjare (“të martohesh” dhe të “kesh fëmijë”). Klasteri i cili është më pak i rëndësishëm për të rinjtë është “të jesh aktiv në politikë” dhe “të marrësh pjesë në aktivitete dhe iniciativa qytetare” (në tekstin në vijim: klaster për veprim shoqëror).

Si prediktorë të rëndësishëm të vlerave të caktuara<sup>9</sup> paraqitet variabla Gjinia: të anketuarit të gjinisë femërore (në krahasim me

gjininë mashkullore) më të rëndësishme i kanë shumicën e vlerave, siç është: "lojaliteti ndaj partnerëve/miqve/punëdhënësve", "marrja e përgjegjësisë", "diploma universitare dhe karriera", si dhe "dukja e mirë", ndërsa të anketuarit e gjinisë mashkullore, më të rëndësishme e kanë vlerën, "të jesh aktiv në politikë", "të kesh rroba brend" dhe "të merresh me sport". Vlerat e tjera për të dy gjinitë janë njësoj të rëndësishme; Moshë: kategoria e grupmoshës prej 25 deri 29 vjeç, në krahasim me dy grupmoshat e tjera, më të rëndësishme i kanë vlerat "të jesh lojal ndaj të tjerëve", "pavarësia personale" dhe "marrja e përgjegjësisë", si dhe "vlerat familjare", ndërsa "të kesh rroba brend" është vlera më e rëndësishme e të anketuarve të grupmoshës më të re (prej 14 deri në 19 vjeç). Vlerat e tjera janë njësoj të rëndësishme për të gjitha grupmoshat. Nacionaliteti: maqedonasit në krahasim me shqiptarët i kanë të rëndësishme thuaja se të gjitha vlerat përveç klasterin për veprim shoqëror i cili është (më i rëndësishëm për shqiptarët) dhe vlerat që kanë të bëjnë me "posedimin e diplomës universitare" dhe "konsumimin e ushqimit të shëndetshëm", të cilat janë njësoj të rëndësishme për të dy etnitetet.

Është interesante të shihet në çfarë korrelacioni janë përcaktuar vlerat<sup>10</sup> me Shkallën për llojin e prindit (Robinson, Mandieco, Olsen & Hart, 1995)<sup>11</sup>. Nën-shkalla e autoritetit është në korrelacion me të gjitha vlerat (edhe atë pozitivisht), përveç me klasterin për veprim shoqëror dhe klasterin për pasuri materiale dhe pamja e jashtme ("të jesh i pasur" dhe "të kesh rroba brend"). Kjo nënkupton se të rinjtë të edukuar në frymën e respektimit të autoritetit do t'u përkushtojnë më shumë rëndësi të gjitha vlerave përveç vlerave të lartpërmendura, veçanërisht klasterit të parë: "të jesh lojal dhe besnik ndaj partnerëve/miqve/punëdhënësve" dhe "të jesh i pavarur". Nga ana tjetër, nën-shkalla autoritare ka korrelacion pozitiv me vlerat që kanë të bëjnë me vlerat materiale dhe ekstrinziqe (që do të thotë se ata të rinj që janë edukuar në mënyrë autoritare më me rëndësi do ta kenë "të pasurohen", "të duken mirë" dhe "të kenë rroba brend"), ndërsa korrelacion negativ me vlerën "të merret përgjegjësia". Stili permisiv i prindërimit është në korrelacion negativ me vlerat siç janë: "lojaliteti ndaj partnerit dhe miqve", ndërsa në korrelacion pozitiv me klasterin për veprim shoqëror, e që nënkupton se të rinjtë e rritur me prindër të cilët kanë aplikuar stil permisiv të prindërisë më me rëndësi do ta kenë "të jenë aktiv në politikë" dhe "të marrin pjesë në iniciativa qytetare", ndërsa më pak rëndësi do t'i përkushtojnë "lojalitetit ndaj partnerëve dhe miqve".

## PRITSHMËRITË/PROJEKSIONET E TË RINJVE PËR ARDHMËRINË

Në këtë studim u parashtruan dy pyetje, të cilat i trajtojnë pritshmëritë/projektionet e të rinjve në lidhje me ardhmërinë e tyre personale për 10 vjet dhe ardhmërinë e shoqërisë maqedonase. Në vijim është prezantuar pasqyra grafike e përqindjeve të të anketuarve sa i përket përgjigjeve në dy pyetjet.

FOTO NR. 39: **Projeksione për ardhmërinë personale**





FOTO NR. 40: **Projeksione për ardhmërinë e RM**



Analiza, në mënyrë të qartë, tregon se të anketuarit janë shumë më optimistë kur bëhet fjalë për ardhmërinë e tyre personale sesa kur bëhet fjalë për ardhmërinë e shoqërisë maqedonase. Një diskrapancë e caktuar është normale dhe e pritshme për punë të cilat varen prej nesh dhe mund të ndikojmë, si dhe për punë të cilat nuk varen prej nesh dhe nuk mund të ndikojmë, megjithatë, kjo është një diskrapancë e madhe e cila madje e vë në dukje faktin se pjesa më e madhe e të rinjve përgatiten të largohen nga vendi, kështu që besojnë se atje do ta kenë më mirë sesa këtu në vendin e tyre. Kjo është e dhënë relevante për diskutim, veçanëri-

sht sa i përket të dhënës nga Foto nr. 40, mund të themi se deri diku është ireale në kushtet maqedonase dhe është mjaft e ndryshme nga të dhënat prej para 5 ose më shumë vitesh, kur të dhëna të caktuara nga hulumtimet të cilët i realizoi Instituti për Hulumtime Sociologjike dhe Politike-Juridike (Universiteti “Shën Cirili e Metodi”) tregoi se të rinjtë kanë pikëpamje optimiste por edhe reale (në kontekstin maqedonas) në lidhje me atë se a do të kenë sukses t’i përmbushin objektivat dhe planet e tyre jetësore, a besojnë se do të fitojnë mjaftueshëm që ta jetojnë në stilin e jetës që e dëshirojnë (Jakimovski etj. 2014; Latkoviq etj. 2016)<sup>12</sup>, kështu që, mezi vetëm 10% ëndërronin “një ditë të ikin prej këtu”<sup>13</sup>.

Me qëllim që të sqarohet kjo e dhënë u kontrolluan disa korrelacione<sup>14</sup> të cilat e dëshmuar atë që supozohej. Kur në fokus është projektioni i të rinjve për ardhmërinë e Maqedonisë, ata të cilët kanë dëshirë më të madhe të shpërngulen në një vend tjetër janë po ata të cilët dëshirojnë që të jetojnë atje përgjithmonë, ndërsa Maqedoninë në 10 vitet e ardhshëm e shohin në gjendje më të keqe nga gjendja aktuale. Prandaj, me siguri se do të largoheshin. Nga ana tjetër, kur në fokus është projektioni i të rinjve për ardhmërinë e tyre personale, të rinjtë të cilët kanë dëshirë më të madhe të shpërngulen në një vend tjetër janë po ata të cilët besojnë se ardhmëria e tyre pas 10 vitesh do të jetë më e mirë sesa tani.

Në vijim është dhënë një pasqyrë edhe për disa korrelacione të rëndësishme të projeksioneve për ardhmërinë.

- Ata të cilët janë më të kënaqur nga cilësia e arsimit në RM dhe nuk pajtohen vetëm me konstatimin se notat “blihen” kanë projeksione më optimiste për shtetin për 10 vitet e ardhshëm.
- Ata të cilët vetveten e perceptojnë me orientim djathtistë kanë projektion më pozitiv për ardhmërinë personale, por projektion më negativ për ardhmërinë e Maqedonisë.
- Ata të cilët u besojnë institucioneve të sistemit dhe janë të kënaqur me gjendjen e demokracisë në RM janë po ata të cilët konsiderojnë se ardhmëria e tyre, por edhe ardhmëria e Maqedonisë, pas 10 vitesh do të jetë më e mirë në krahasim me situatën aktuale.
- Ata të cilët më shumë u besojnë anëtarëve të familjes më të ngushtë dhe më të gjerë, miqve, si dhe njerëzve me religjion dhe përkatësi etnike tjetër janë ata të rinj të cilët besojnë se personalisht do të jenë më të lumtur pas 10 vitesh. Ata të cilët u besojnë anëtarëve të familjes më të ngushtë dhe më të gjerë, miqve, fqinjëve, bashkëmoshatarëve të tyre në shkollë/kolegëve dhe liderëve politikë janë po ata të cilët besojnë për një ardhmëri më të mirë të Maqedonisë pas 10 vitesh.
- Përvojë të ngjashme me diskriminimin ka edhe projektioni “më i zyrtë” për ardhmërinë personale pas 10 vitesh.

### **Ku dhe si e shihni vetveten dhe Republikën e Maqedonisë pas 10 vitesh?**

“Vetveten e shoh si psikolog dhe psikoterapeut i suksesshëm i cili punon në industrinë MRNJ, pavarësisht se a do të jem në RM ose jo, ndërsa Maqedoninë dua ta shoh në Bashkimin Evropian me standarde më të larta dhe progres, megjithatë, nuk kam pritshmëri/shpresë se një gjë e këtillë do të ndodhë.” (Ana, 23 vjeç)

“Vetveten e shoh si grua të suksesshme duke e ndërtuar karrierën jashtë Maqedonisë, ndërsa RM e shoh në gjendje më të keqe sesa tani.” (Tara, 23 vjeç)

“Republikën e Maqedonisë e shoh në pozitën e njëjtë si edhe sot, ndërsa vetveten e shoh në organizatën e njëjtë punuese, por në pozitë më të lartë, të martuar, me një ose dy fëmijë, në shtëpi të ndarë nga prindërit e mi.” (Mina, 25 vjeç)

“Vetveten e shoh si një grua të suksesshme afariste e cila ka për qëllim t’i përmirësoj gjërat në shtetin tonë jofunksional, ndërsa Republikën e Maqedonisë e shoh si një shtet më të mirë dhe vend më të mirë për të jetuar për popullin tonë, anëtare të BE dhe me standarde evropiane.” (Simona, 19 vjeç)


“Unë vetveten pas 10 vitesh e shoh si punoj dhe jetoj në Republikën e Maqedonisë bashkë me familjen time, por për Republikën e Maqedonisë nuk mund të them se ku e shoh pas 10 vitesh, meqë një gjë të këtillë nuk mund ta parashikoj, veçanërisht në rritjen drastike të njerëzve të rinj të cilët shpërngulen, duke kërkuar kushte më të mira për punë dhe për jetë, e që do të thotë se ekziston rreziku nga reduktimi i madh i numrit të banorëve. Ekziston edhe tendenca e njerëzve të rinj me arsim të lartë të cilët largohen nga shteti në kërkim të avancimit profesional të vetvetes dhe studimeve të tij, meqë Maqedonia nuk i ofron të njëjtat.” (Bojan, 25 vjeç)

“Shtetin e shoh në BE, ndërsa veten e shoh si të punësuar në administratën publike në ndonjë funksion udhëheqës.” (Filip, 27 vjeç)

“Akoma nuk e di se ku e shoh vetveten, por e shoh si njeri i suksesshëm, ndërsa Republikën e Maqedonisë nuk e di ... gjithësi jo në dritë të suksesshme!” (Petar, 21 vjeç)

## **DRUAJTJET, SHQETËSIMET DHE PROBLEMET PRIORITARE TË TË RINJVE NË RM**

Në shkallën prej tri nivelesh, prej 1 deri në 3 me përgjigje të ofruara: “aspak jo”, “deri në një shkallë” dhe “shumë”, të rinjtë e anketuar me këtë hulumtim iu përgjigjën pyetjes në lidhje me atë se sa druajnë ose sa janë të shqetësuar në lidhje me 11 problemet potenciale të sigurisë dhe politikës-ekonomikë. Grafiku i radhës në mënyrë të qartë tregon se në asnjë përgjigje të ofruar nuk ka mesatare më të ulët aritmetike se 2, e që është një e dhënë më se shqetësuese. Megjithatë, të rinjtë më shumë janë të shqetësuar (që ishte edhe e pritshme në lidhje me gjendjet me ndotjen dhe me ndikimin e ndotjes mbi shëndetin /<https://www.iph.mk/aerozagaduvanjeto-vo-republika-makedonija/>) lidhur me “ndotjen dhe ndryshimet klimatike”, “të sëmuresh seriozisht” dhe problemi i paeftueshëm në 15 vitet e kaluara – “varfëria”. Menjëherë pas

FOTO NR. 41: **Druajtjet e të rinjve për dukuritë shoqërore (sipas mesatareve aritmetike)**

tyre vjen droja nga “korrupsioni”, “padrejtësia sociale”, “luftërat dhe sulmet terroriste”, si dhe druajtja “të mbetesh pa punë”.

Të gjitha analizat në vijim<sup>15</sup> treguan se të anketuarit e gjinisë femërore, në krahasim me të anketuarit e gjinisë mashkullore, janë më të shqetësuar në lidhje me të gjitha problemet në shoqërinë dhe më gjerë, përveç për problemin e parë në grafikun – korrupsioni – për këtë problem njëllor janë të shqetësuar të anketuarit e të dyja gjinive. Maqedonasit janë më të shqetësuar sesa shqiptarët për të gjitha dukuritë e ofruara në shoqëri, përveç për padrejtësinë sociale – për këtë janë njëllor të shqetësuar si maqedonasit ashtu edhe shqiptarët. Sa i përket moshës, të dhënat flasin se të gjitha moshat njëllor drujnë për të gjitha dukuritë në shoqëri.

Shqetësimi më i madh për korrupsionin, varfërinë në rritje dhe mospasja e punës ka tendencë sa më pak të arsyetohen (apo të arsyetohen rrallëherë) sjelljet siç janë: abuzimi i tatimeve, mitmarrje dhe mitdhënie dhe shfrytëzimi i lidhjeve për gjetje të punës, që gjithsesi se është qëndrim i dëshiruar. Përveç kësaj, nëse bëjmë një vështrim të përgjithshëm, popullata e re rrallëherë e arsyeton abuzimin e tatimeve (mesatarja aritmetike është 2,47 në shkallë prej 1/asnjëherë, deri në shkallën 10/ çdoherë), mitdhënie dhe mitmarrje (M=2,26), ndërsa pak më shumë (më shpesh) e arsyeton shfrytëzimin e lidhjeve që të gjendet punë (M=3,85) dhe shfrytëzimin e lidhjeve që të kryen punë të caktuara, (për shembull në spital – M=4,38).

## TË RINJTË DHE RELIGJIONI



Përveç asaj që religjioni paraqet sistem të besimit dhe vlerave, ai ka edhe funksion integruar i cili mund t’i referohet individit ose shoqërisë, më saktë shoqërisë në përgjithësi ose niveleve të saj të veçanta – nivelit individual, kulturor dhe social. Hargrove (1989) e ka perceptuar funksionin integruar të religjionit edhe në përkufizimin e tij, duke iu ndërlidhur pikëpamjes funksionale, për këtë fenomen shoqëror thotë se religjioni është fenomen njerëzor i cili funksionon që t’i bashkoj kulturat, sistemet sociale dhe personale në një tërësi të sajuar. Së këtejmi, edhe rëndësia e anketës në lidhje me qëndrimin e të rinjve për religjionin.

Në pjesën që i përkushtohet hulumtimit të aspektit religjioz të të rinjve, çdo gjë filloi me parashtrimin e pyetjes për përkatësinë religjioze, përkatësisht për identifikimin e të rinjve. Duke e pasur parasysh strukturën nacionale të popullsisë, përkatësia religjioze është e pritshme në drejtim të shumicës mbi 66% e të anketuarve të cilët i përkasin religjionit ortodoks dhe rreth 25% e të anketuarve të cilët i përkasin religjionit mysliman.

Ishte interesante të shihet se sa shpesh (përveç celebrimeve dhe funeraleve të cilët kanë më shumë dimension kulturor dhe social) të rinjtë praktikojnë rite fetare, siç është pjesëmarrja në shërbesat fetare, si dhe të krahasohen rezultatet e studimit për të rinjtë nga viti 2013<sup>16</sup>.

Dallimi më i madh konsiston në përqindjen e të rinjve (40%) nga viti 2018 të cilët praktikojnë shërbesa fetare vetëm për festa të veçanta (festat e mëdha) fetare. Shkaku për një gjë të këtillë ndoshta qëndron tek përcaktimi i ndryshëm i pyetjes së katërt në të dyja studimet. Megjithatë, e dhëna e cila nuk është diskutabile është përqindja gjithnjë e më e madhe e të rinjve në 5 vitet e fundit të cilët gjithnjë e më shpesh e praktikojnë religjionin.

Kemi edhe një të dhënë interesante në lidhje me atë se sa Zoti është i rëndësishëm në jetën e të rinjve (analiza ka të bëjë vetëm me ata të rinj të cilët kanë deklaruar se janë pjesëtar të ndonjë religjioni).

FOTO NR. 42: **Përqindja e të rinjve të cilët praktikojnë rite fetare**FOTO NR. 43: **Përqindja e përgjigjeve në pyetjen që ka të bëjë me rëndësinë e Zotit në jetën e të rinjve**

Edhe pse 40% praktikojnë rite fetare vetëm gjatë festave të mëdha fetare, megjithatë 78,6% e të rinjve Zoti është i rëndësishëm, ndërsa për 51,2% është shumë i rëndësishëm.

Si predikues të religjionit në këtë studim, si edhe në disa studime të lartpërmendura (shih: Latkoviç etj. 2016; Cvetanova etj. 2016) janë: Nacionaliteti (për shqiptarët Zoti është më i rëndësishëm në jetën e tyre dhe mesatarisht më shpesh e praktikojnë religjionin/ritet fetare); Gjinia në kuadër të nacionalitetit (tek maqedonasit: për të anketuarit e gjinisë femërore Zoti është më i rëndësishëm,

megjithatë nuk ka dallim midis të anketuarve të gjinisë femërore dhe të anketuarve të gjinisë mashkullore sa i përket shpeshësisë së praktikimit të riteve fetare, ndërsa tek shqiptarët situata është e kundërt – nuk ka dallim midis grave dhe burrave sa i përket faktit se sa e kanë të rëndësishëm Zotin, por prandaj të anketuarit e gjinisë mashkullore më shpesh i praktikojnë ritet fetare); Aspekti urban i mjedisit në të cilin jetojnë (për të anketuarit e mjedisve rurale Zotin e kanë më të rëndësishëm dhe më shpesh i praktikojnë ritet fetare); Perceptimi i aspektit religjioz të prindërve (të anketuarit të cilët prindërit e tyre i perceptojnë si religjioz Zotin e kanë më të rëndësishëm, ndërsa edhe më shpesh i praktikojnë ritet fetare); Edukimi i të anketuarve është i rëndësishëm për parashikimin e shpeshësisë së praktikimit të riteve fetare (edukim më i lartë – praktikim më i rrallë i riteve fetare), por jo edhe në aspektin e asaj se sa e kanë Zotin të rëndësishëm në jetën e tyre, si edhe edukimi i prindërve të tyre (edukimi i të dy prindërve është tregues për rëndësinë e Zotit, edukimi i nënës për shpeshësinë e praktikimit të riteve fetare, me ç'rast drejtimi është i pritsëm – edukim më i lartë – rëndësi më e vogël për Zotin dhe praktikim më të rrallë të riteve fetare).<sup>17</sup>

Rëndësia e Zotit në jetën e individit është në korrelacion me shumë aspekte të stilit jetësor të individit, si dhe me vlerat e tij, druajtjet dhe besimet<sup>18</sup>, kështu që mund të thuhet se të anketuarit të cilët i përkushtojnë rëndësi më të madhe Zotit, në jetën e tyre:

- më shumë kohë kalojnë duke iu lutur Zotit dhe më shumë kohë kalojnë me familjen e tyre, ndërsa më pak kohë për lexim të gazetave/revistave, për punë kreative, video-lojëra, relaksim, kalimin e kohës në bare, kafeteri, kalimin e kohës në qendra rinore, punë vullnetare në projekte/ iniciativa sociale, qëndrim jashtë vendit, si dhe në aktivitete sportive;
- shprehin besim më të madh tek anëtarët e familjes më të ngushtë dhe më të gjerë, ndërsa besim më të vogël shprehin ndaj njerëzve me bindje të ndryshme politike;
- shprehin kënaqësi më të madhe ndaj jetës familjare, me rrethin e miqve që i kanë, si dhe me jetën në tërësi;
- shprehin besim më të madh në ardhmërinë më të mirë të tyre;
- më shumë druajnë në lidhje me të gjitha shkaqet e cekura për drujtje (shih Foto nr. 43).
- dëshirojnë të kenë fqinj, familje lokale me shumë fëmijë, grup të studentëve ose familje nga Ballkani Perëndimor, ndërsa janë shumë më të mbyllur ndaj personave ose çifteve homoseksuale, ndaj vartësve të drogave dhe ish-të burgosurve.


Është interesante të shihet se çka do të shkaktoj religjioni<sup>19</sup> sa u përket disa sjelljeve të rëndësishme të të rinjve. Analiza regresive tregoi se të rinjtë më religjioz më mirë do të pajtohen me prindërit e tyre, do t'i rrisin fëmijët e tyre në atë mënyrë siç i kanë rritur ata prindërit e tyre, do të lejojnë prindërit të kenë ndikim mbi vendimet e rëndësishme në jetën e tyre dhe do të dëshirojnë dhe planifikojnë familje me shumë fëmijë; gjatë përzgjedhjes së shokut martesor do ta kenë me rëndësi bindjen religjioze të partnerit, miratimin e familjes, virgjërinë dhe përkatësinë nacionale të partnerit; po këta, në një numër më të madh më shumë e dëshirojnë sektorin publik se sa atë privat. Aspekti religjioz nuk ndërlidhet me fuqinë e dëshirës të të rinjve që të shpërngulen jashtë vendit, por nga ana tjetër ndërlidhet me interesimin e madh për çështjet politike dhe me mundësinë më të madhe që të marrin funksion politik.

## RELACIONET ME TË TJERËT: TË RINJTË NË FUSHËN SOCIALE

### Të rinjtë dhe relacionet sociale/besimi tek të tjerët/pranimi i tjetrit

Në kontekstin e interesit se si gjenden të rinjtë në fushën sociale u parashtrua pyetja sa u besojnë personave të ndryshëm nga mjedisi i tyre më të ngushtë dhe më të gjerë. Në vijim ua prezantojmë përgjigjet të cilat u dhanë në shkallën prej 1 ("aspak nuk u besoj") deri në shkallën 5 ("shumë u besoj") të krahasuara me përgjigjet e dhëna nga të rinjtë në "Studimin për të rinjtë në Maqedoni", nga viti 2013<sup>20</sup>.


FOTO NR. 44: Të dhëna komparative për besimin tek të tjerët (sipas mesatareve aritmetike)



Siç mund të shihet, edhe tani por edhe para 5 vitesh të rinjtë besim më të madh kanë (Latkoviç etj. 2013; shih: edhe Jakimovski etj., 2014) tek anëtarët e familjes së tyre më të ngushtë dhe më të gjerë dhe tek miqtë, ndërsa më pak u besojnë liderëve politikë. Vlerat mesatare për disa grupe njerëzish thuaja se janë të njëjta, disa janë shumë afër, ndërsa vetëm për dy grupe të njerëzve kanë dallime statistikore, ndërkaq kjo ka të bëjë për njerëzit e nacionalitetit tjetër dhe religjionit tjetër. Së këtejmi, me siguri mund të themi se qytetarët maqedonas dhe shqiptarë në vitin 2018 i besojnë njëri tjetrit më pak në krahasim me vitin 2013.

Të rinjtë u pyetën se a kanë miq me status të ndryshëm social dhe edhe në këtë pyetje thuaja se 88% u përgjigjën në mënyrë pohuese – se kanë, e që e konfirmoi faktin se në Maqedoni nuk ekziston orientim drejt dominimit social (Serafimovska, 2006), më saktë preferenca individuale për hierarkinë e klasave më të larta sociale mbi grupet me status më të ulët social (Sidanius et al, 1994).

Në këtë studim u prezantua variant i caktuar i shkallës së Bogardit si disiplinë sociale, me qëllim që ta analizoj fuqinë e ndjenjave të rinjve nëse një lloj i caktuar i familjes ose i grupit të njerëzve vendosen të banojnë në fqinjësinë e tyre. Një shkallë e këtillë u përcaktua edhe në “Studimin për fëmijë në Maqedoni, 2013” (shih: Latković etj., 2013) kështu që rezultatet nga të dyja studimet janë prezantuar në vijim.



Duke e pasur parasysh se grupet e propozuara për vlerësimin e distancës nga viti 2013 dhe 2018 nuk korrespondojnë plotësisht, në këtë grafik janë prezantuar vetëm ato grupe sociale të cilat ishin të përbashkëta për të dy vitet, por edhe ato që ishin përfshirë vetëm në këtë studim të vitit 2018. Krahasimi dha rezultate thuaja se të njëjta. Megjithatë, e vuri në dukje edhe distancën shqetësuese për refugjatët, homoseksualët dhe veçanërisht për ish-të burgosurit dhe vartësit nga droga. Sa u përket të dhënave mund të diskutohet në drejtim të pasojave nga jeta në një shoqëri e cila është në krizë sociale, siç është mosbesimi gjithnjë e më i madh tek tjetri e që llogaritet se është jashtë grupit tonë “outgroup”, ndërkaq rritja e besimit tek tjetri i cili llogaritet si pjesëtar i

“grupit tonë” – “ingroup” (Serafimovska, 2006). Shkaku për një distancë të këtillë gjithsesi se mund të jetë ekzistimi i vet-perceptimit si i ndryshëm nga tjetri, me ç’rast ky perceptim ka dy anë: perceptimi se “ne jemi të ndryshëm prej tyre” dhe perceptimi “ata janë më të këqij se ne” (Cvetanova etj., 2016).

## Perceptimi i diskriminimit/pabarazisë në shoqëri

Nëse në të kaluarën përkatësia sociale ose klasore ishte bazë dominuese, mbi të cilën mbështetej pabarazia dhe bëhej mobilizim politik, sot, para së gjithash, është përkatësia kulturore, nëse me këtë nocion i nënkuptojmë grupet racore, etnike, religjioze, gjuhësore dhe sociale (Blondel, 1995; Kimlicka, 2004; Smith, 1991; Hristova etj., 2014).

Në këtë Studim të rinjve iu parashtua pyetja, a kanë përjetuar diskriminim për shkaqe të ndryshme. Në vijim pasojnë përgjigjet.

Siç mund të shihet nga rezultatet (të cilat janë thuaja se identike me ato të vitit 2013 (shih: Latković etj., 2013), orientimi seksual<sup>21</sup> dhe gjuha të cilën e përdorin të rinjtë më së paku janë shkak për diskriminim, ndërsa bindjet politike dhe origjina etnike janë shkaqe më të shpeshta për shkak të të cilave të rinjtë kanë përjetuar diskriminim. Këto të dhëna (për bindjet politike si burim i diskriminimit), sigurisht se mund të kuptohen edhe në kontekst të faktit se të rinjtë konsiderojnë se pikërisht përkatësia politike e qytetarëve paraqitet si faktori më i rëndësishëm për trajtim të privilegjuar në shoqëri (Hristova etj., 2014).

### A ka diskriminim në Maqedoni dhe ku e hasim?

“Diskriminimi ekziston, atë e hasim në konkurset për punë të cilët diskriminojnë në bazë të gjinisë dhe moshës. E hasim nëpër shkolla dhe organizata, ku njerëzit i diskriminojnë njerëzit me aftësi të kufizuar, njerëzit e nacionalitetit tjetër etj. Në Maqedoni diskriminohet çdo lloj i mendimit, qëndrimit dhe dukjes ndryshe...” (Ana, 23 vjeç)

“Gjithsesi se ka diskriminim, edhe atë në shumë fusha, shoqëria akoma pamjaftueshëm e informuar në më shumë fusha e bën këtë diskriminim të jetë akoma në nivel të lartë.” (Elena, 24 vjeç)


“Ndoshta, por nuk di shumë për këtë temë, unë nuk e kam vërejtur. Nëse ka edhe në vende tjera të Evropës, si dhe në Amerikë, Afrikë dhe Azi atëherë të mos flasim për tek ne, kështu që sa i përket kësaj çështje bota duhet të ndryshoj në mënyrë që edhe tek ne të shohim ndonjë ndryshim. Sipas mendimit tim, vështirë se do të ndodhë në një të ardhme të shpejtë, në krahasim me Afrikën dhe Azinë, ne nuk qëndrojmë aq keq.” (Kate, 24 vjeç.)

“Diskriminimi e shoh në rrjetet sociale, i cili krijohet nga intoleranca midis popullatës shumicë dhe minoritetit më të madh për nga numri i popullsisë.” (Bojan, 25 vjeç)

“Diskriminim ka vazhdimisht, duke filluar nga arsimit (fëmijë me nevoja të veçanta, homoseksual, nacionalitete të ndryshme), e deri te përditshmëria dhe punët më të thjeshta si blerja në supermarket (fjalë të pahijshme, pëshpëritje pas shpine për ndonjë diversitet). Tekstualisht çdo diversitet i cili devijon nga norma e pranuar është diskriminuar.” (Dritan, 17 vjeç)



FOTO NR. 46: Përqindja e përgjigjeve për llojin e diskriminimit të përjetuar



“Po, ka diskriminim në Maqedoni. Shihet në jetën publike dhe private. Në jetën publike është në domenin e punësimit dhe paraqitjes së dokumenteve, ndërsa në atë privat po ashtu ka të bëjë me punësimin, veçanërisht të romëve.” (Filip, 27 vjeç)

“Mendoj se nuk ka.” (Petar, 21 vjeç)

## FAMILJA DHE MARTESA

Ndryshimet në sistemin e përgjithshëm shoqëror detyrimisht rezultuan me ndryshime përkatëse edhe në pjesën demografike të familjes. Mjaft mbresëlënëse janë ndryshimet në përbërjen farefisnore të familjes, në reduktimin evident të vëllimit të familjes, përkatësisht madhësisë së saj, duke e marrë parasysh numrin mesatar të anëtarëve të familjes. Proceset e nuklearizimit të familjes në RM, të cilat janë rezultat i ndryshimeve globale, nga ana e tyre, e intensifikojnë procesin e shpërbërjes të ashtuquajturave familje të mëdha, të cilat përbëhen nga 7,8 e më shumë anëtarë, si dhe nga më shumë familje. Në këtë aspekt numri i strukturave të mëdha familjare shënon rënie permanente, ndërsa nga ana tjetër, numri i familjeve nukleare, të cilat përbëhen nga prindërit

dhe fëmijët të cilët më së shpeshti kanë nga katër anëtarë, vazhdimisht shënon rritje (Matilov në Lazarevski etj., 2005).

Të dhënat e reja për strukturën e familjeve dhe ekonomive familjare në vendet anëtare të BE-së ([http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Being\\_young\\_in\\_Europe\\_today\\_-\\_family\\_and\\_society](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Being_young_in_Europe_today_-_family_and_society)) theksojnë disa informacione të rëndësishme:

- Në shumicën e vendeve veriore dhe perëndimore anëtare të BE-së, mesatarisht, njerëzit e rinj largohen nga shtëpia që në moshën e tyre njëzetë vjeçare, ndërsa në vendet jugore dhe lindore anëtare të BE-së moshë mesatare e largimit nga shtëpia është në të njëzetat e vonshme ose në tridhjetat e hershme;
- Meshkujt nën moshën 30 vjeçare nuk largohen nga çerdhja familjare në shumicën e vendeve jugore anëtare të BE-së;
- Vërehen modele të reja të familjeve: celebrimi tanimë nuk është mënyra e vetme që partnerët të jetojnë bashkë; Moshë mesatare e martesës së parë ka shënuar rritje në masë të konsiderueshme gjatë dy dekadave të fundit në gjitha vendet anëtare të BE-së. Hulumtimet e realizuara në ato vende anëtare të BE-së, për të cilat të dhënat kombëtare janë të ak-

sesshme në vitin 2015, tregojnë se mosha mesatare e femrave për martesën e parë ka qenë 29,9 vjet, ndërsa për meshkuj 32,4 vjet. Në vitin 1995, mosha mesatare (përsëri mesatare e thjeshtë në bazë të të dhënave të aksesshme) e martesës së parë ka qenë 25,7 vjet për femrat dhe 28,3 vjet për meshkujt;

- Kalimi në moshën madhore: mesatarisht, meshkujt e rinj largohen nga shtëpia familjare më vonë sesa femrat e reja.
- Kalimi nga fëmijëria në moshën madhore karakterizohet me një numër të madh të hapave të rëndësishëm, siç është largimi nga shtëpia e prindërve për të studiuar ose për punë, për pavarësi materiale, bashkëjetesë me partnerin ose martesë dhe për shkak të lindjes së fëmijës ose jo. Megjithatë, rruga drejt pavarësisë nuk është e qartë, kështu që të rinjtë ballafaqohen me një sërë sfidash e që mund të rezultojnë me atë që disa prej tyre do të qëndrojnë një kohë më të gjatë në shtëpinë e prindërve ose do të kthehen në shtëpinë e prindërve;
- Personat të cilët jetojnë vet dhe në çifte, pa fëmijë, janë më shumë se 50 % nga të gjitha familjet në botën e zhvilluar.
- Numri i familjeve me fëmijë shënon rënie në BE.

## Profili i familjes së të rinjve në Republikën e Maqedonisë

Në këtë pjesë të analizës u bënë përpjekje që të profillohet familja mesatare e të rinjve në Republikën e Maqedonisë, me ç'rast për analizë u morën në konsideratë kriteret si vijojnë: numri dhe struktura e familjes (sa dhe cilët njerëz jetojnë në një familje); lloji i vendbanimit (shtëpi e prindërve/apartament i trashëguar (shtëpi)/ apartament (shtëpi) i/e trashëguar/ e apartament shtëpi i/e blerë) dhe shkaqet për të njëjtën; dakordësim me prindërit, mënyra të vendimmarrjes në familje dhe kush ka ndikim mbi vendimet; projeksione/ide për ardhmërinë e të rinjve në lidhje me: statusin e tyre martesor (mosha më e mirë për lidhje të martesës dhe si do ta përzgjedhin partnerin martesor), me dëshirë për të pasur fëmijë (numri i fëmijëve të dëshiruar) dhe mënyra e edukimit të fëmijëve<sup>22</sup>. Analiza – klaster tregoi se 84% e të rinjve jetojnë në familje e cila numëron 4 anëtarë: dy prindër dhe dy fëmijë, dhe ky lloj i familjes jeton në shtëpinë e prindërve. Në vijim ua prezantojmë të dhënat nga analiza.

### Numri dhe struktura e familjes

Sa i përket numrit dhe strukturës së familjes rezultatet treguan se familja mesatare në Maqedoni është e përbërë deri në 4 anëtarë (dy prindër të gjallë dhe dy fëmijë). Në të vërtetë, numri mesatar i anëtarëve të familjes është 4,4. Kur analizohen këto të dhëna themelore, në lidhje me aspektin urban të mjedisit, mund të themi se numri mesatar i anëtarëve të familjes është 4,26 në mjediset urbane dhe 4,67 në mjediset rurale. Nëse i analizojmë në lidhje me përkatësinë nacionale, mund të themi se numri mesatar i anëtarëve të një familje shqiptare është 5,14, ndërsa i familjes maqedonase 4,12.

Pak më shumë se një e gjashta e të anketuarve (ose 15,4% e të rinjve) u përgjigjën se familja e tyre është në gjendje të shkëlqyeshme financiare (mund ti lejojnë vetvetes çdo gjë që u nevojitet), ndërsa 10,7% u përgjigjën se jetojnë në prag të varfërisë. Të tjerët kanë mjete për t'i përmbushur nevojat elementare të jetës pa luks.

### Lloji i vendbanimit

Sa i përket rolit të vendbanimit rezultatet treguan se numri më i madh i të rinjve jetojnë në shtëpinë e prindërve të tyre: 77,3% jetojnë në shtëpinë e prindërve të tyre, ndërsa për 62,5% prej të anketuarve kjo është kështu meqë është zgjidhja më e thjeshtë dhe më komode. Këto të dhëna ndoshta janë pak kontradiktore kur analizohen në kontekstin e përgjigjeve të të rinjve se sa e kanë të rëndësishme të jenë të pavarur dhe të marrin përgjegjësi (në shkallën prej 1/aspak nuk e kam të rëndësishme/ deri në shkallën 5/ shumë e kam të rëndësishme/, vlera mesatare për "të ndërmarrin përgjegjësi" është 4,50, ndërsa që "të jenë të pavarur" është 4,63);

Ata, të cilët jetojnë në shtëpinë e prindërve të tyre, në krahasim me ata që nuk jetojnë me prindërit, përveç që kalojnë më shumë kohë me familjen e tyre, ata më shpesh: dëgjojnë muzikë, dalin me miqtë, e kalojnë kohën në bare/kafeteri. Ata të cilët nuk jetojnë në shtëpinë e prindërve të tyre më shpesh lexojnë libra, gazeta/ revista, lexojnë për zhvillimin e tyre personal dhe shpirtëror, bëjnë punë kreative, meditojnë (joga dhe ngjashëm) dhe më shpesh udhëtojnë jashtë vendit.

### Mënyra e edukimit, dakordësimi me prindërit dhe ndikimi i prindërve

Sipas mënyrës me të cilën edukohen nga prindërit dhe sa dakordësohen me prindërit, analiza e të dhënave tregoi se të rinjtë dakordësohen mirë me prindërit edhe pse ndonjëherë kanë mendime divergjente: 54,4% e të rinjve u përgjigjën se "dakordësohen mirë me prindërit" ndërsa 37,7% e të rinjve u përgjigjën se "dakordësohen mirë me prindërit edhe pse ndonjëherë kanë mendime divergjente".

Të rinjtë në Republikën e Maqedonisë më shpesh deklarohen se janë edukuar në frymën e sinqeritetit dhe respektimit të autoriteteve, ndërsa më pak në frymën e të dëgjuarit të pakushtëzuar të autoriteteve (ndëshkim i rreptë) dhe në frymën e permisivitetit (kërkesa dhe pritshmëri të ulëta nga ana e prindërve). Sipas Shkallës së prindërisë, stili i prindërisë dominante të edukimit është stili Autoritativ. (Nën shkallë e Autoritetit me mesataren aritmetike M=12,1; Nën-shkallë Autoritare është me M=9,38; ndërsa Nën-shkallë Permissive me M=8,08). Të rinjtë e edukuar në stilin autoritar, por edhe me atë permisiv të prindërimit më shumë pajtohen me qëndrimin se "Ajo që më së shumti u nevojitet të rinjve është disiplinë e rreptë nga prindërit e tyre".

Përderisa fokusi akoma është mbi jetën familjare, është interesante e dhëna se në shkallën prej 1 (shumë i pakënaqur) deri në shkallën 5 (shumë i kënaqur) – 64,4% e të rinjve në pyetjen "Sa janë të kënaqur me jetën familjare" e zgjedhin numrin 5, ndërsa numrin 4 e zgjedhin vetëm 21,2%.

Sa i përket ndikimit të prindërve mbi vendimet e të rinjve, të dhënat treguan se të rinjtë vendimet i marrin bashkë me prindërit e tyre, me ç'rast nëna ka ndikim pak më të madh sesa babai (në mjediset urbane vendimi i nënës është më me ndikim sesa në mjediset rurale): 46,4% e të rinjve u deklaruan se babai ka ndikim më të madh mbi vendimet e rëndësishme, ndërsa 54,6% – nëna. Më shumë se gjysma e të rinjve të anketuar (58,9% e të anketuarve) u deklaruan se vendimet në jetë i marrin bashkë me prindërit e tyre. Me besimin më të madh në anëtarët e familjes më të ngushtë "shkon" edhe përfshirja më e madhe e prindërve në miratimin e vendimeve të rëndësishme për të rinjtë.

### Qëndrimet e të rinjve për martesën

Nëse idetë/projektet dhe qëndrimet e të rinjve në lidhje me martesën janë në fokusin e interesimit, atëherë mund të nënvizojmë disa të dhëna: qëndrimet e të rinjve konsistojnë me atë se mashkulli duhet të martohet në moshën 27–28, madje edhe në moshën 30 vjeçare, ndërsa femra më së miri është të martohet në moshën 25–26 vjeçare, ose thënë më saktë, vitet mesatare për martesën të femrës janë  $M=25,59$ , ndërsa vitet mesatare për martesën e mashkullit janë  $M=27,64$ ; të rinjtë (kjo e dhënë është konstante edhe në hulumtimin paraprak të vitit 2013) konsiderojnë se në të ardhmen duhet ta formojnë familjen e tyre: 91,3% e të rinjve u përgjigjën se në të ardhmen shihen si të martuar me familje të veta. Përkatësisht, në shkallën prej 1 (aspak nuk është e rëndësishme) deri në shkallën 5 (shumë e rëndësishme), 74,4% e të rinjve e kanë zgjedhur numrin 5 si përgjigje në pyetjen "sa është e rëndësishme të kesh bashkëshort/bashkëshorte në jetë."

Përveç që të jenë në martesë, për të rinjtë e RM-së është me rëndësi edhe lojaliteti ndaj partnerit, kështu që mesatarja aritmetike është  $= 4,66$  (në shkallën prej 1 deri në 5) në shkallën e rëndësisë të pohimit "të jesh besnik ndaj partnerit/partneres", ndërsa tri çështjet më të rëndësishme të të rinjve – kur do ta përzgjedhin shokun martesor janë: "karakterit i partnerit", "interesat e përbashkëta", por edhe "bindjet religjioze" të partnerit; abstenimi nga marrëdhëniet seksuale para martesës për 35,6% nga të rinjtë është "koncept anakronik", për 29,4% është "barrë e panevojshme psikologjike", për 19,4% është "vlerë për të dyja gjinitë", ndërsa për 15,6% e të rinjve është "virtut"; në shkallën prej 1 (asnjëherë) deri në shkallën 10 (çdoherë) të rinjtë kanë mesatare aritmetike  $M=2,89$  në pyetjen se sa është i arsyeshëm homoseksualiteti;

### Projeksione për fëmijë dhe prindërim

Për të rinjtë në Maqedoni është shumë e rëndësishme të kenë 2, eventualisht 3 fëmijë, fëmija i parë kur gruaja do të ketë 26 vjet ndërsa burri 28 vjet, ose më konkretisht: 56% e të rinjve dëshirojnë të kenë 2, ndërsa 30,8% – 3 fëmijë. Mesatarja e fëmijëve të dëshiruar e të rinjve është  $M=2,61$ . Në shkallën prej 1 (aspak nuk është e rëndësishme) deri në shkallën 5 (shumë e rëndësishme), 78% e të rinjve e zgjedhin numrin 5 si përgjigje në pyetjen "Sa është e rëndësishme të kesh fëmijë në jetë" ( $M=4,45$  në shkallën e njëjtë).

Të rinjtë dëshirojnë që fëmijët e tyre t'i rrisin ashtu siç edhe ata i kanë rritur prindërit e tyre: 52,3% e të rinjve u përgjigjën "thuaja se njëlloj" në pyetjen "A do t'i rrisnit fëmijët e Juaj në mënyrë të njëjtë siç Ju kanë rritur Juve prindërit e Juaj?". Shqiptarët (në krahasim me maqedonasit) më shpesh e zgjedhin alternativën "njëlloj" në pyetjen "A do t'i rrisnit fëmijët e Juaj në mënyrë të njëjtë siç Ju kanë rritur Juve prindërit e Juaj?". Nga ana tjetër, maqedonasit më shpesh e zgjedhin kategorinë "thuaja se njëlloj" sa i përket pyetjes së njëjtë.

Në shkallën prej 1 (asnjëherë) deri në shkallën 10 (çdoherë), të rinjtë kanë mesatare aritmetike  $M=3,69$  në pyetjen: Sa është i arsyeshëm aborti?

### Cilat janë shkaqet për të cilat numri më i madh i të rinjve edhe pas moshën 18 vjeçare akoma jetojnë me prindërit e tyre?

"Kultura në shtet dhe edukimi (gjatë viteve të kaluara) e imponon jetën me prindër derisa nuk lidhet martesë." (Ana, 23 vjeç)

"Mospasja e mjeteve të mjaftueshme paga të ulëta, fatura të larta, qira të larta." (Tara, 23 vjeç)

"Gjendja e pamjaftueshme stabile financiare, potenciali gjithnjë e më i vogël, dëshira, por edhe frika të pavarësohen të fillojnë jetë të re me obligime më të mëdha." (Elena, 24 vjeç)

"Shkaku kryesor, sipas mendimit tim, për shkak të të cilit të rinjtë ditëve të sotme akoma jetojnë me prindërit e tyre, është për shkak të edukatës së fëmijëve që në moshë të vogël. Prindërit të cilët më shumë i "përkëdhelin" fëmijët e tyre me atë që ua kryejnë obligimet e tyre, iu mundësojnë vazhdimisht të kenë kohë të lirë, i shpërblejnë me para pa ua shpjeguar vlerën e parave, si fitohet pasuria materiale dhe si e njëjta korrespondon me lumturinë e tyre në jetë. Vendosen në pozitë mbrojtëse ndaj fëmijëve të tyre dhe nuk u lejojnë të marrin vendime, pavarësisht a janë vendime të drejta ose jo, nga gabimet mësohet. Në shtetin tonë, të rinjtë jetojnë me prindërit e tyre deri në moshën 23–24 vjeçare dhe atëherë fillojnë të punojnë dhe të fitojnë përvojë praktike, ndërsa në shtetet tjera të rinjtë fillojnë shumë më herët me punë/praktikë/studime, ndërsa kanë edhe mundësi të shkojnë në kolegji dhe të fitojnë disiplinë të pavarur dhe të kenë përgjegjësi për ekzistencën e vetvetes së tyre, si në aspektin e parave ashtu edhe në atë të detyrave të shtëpisë." (Bojan, 25 vjeç)

"Për shkaqe financiare, për shkak të traditës dhe varësisë së madhe të prindërve nga fëmijët e tyre (shqetësim i madh se si do të jetojnë vetë)." (Petar, 21 vjeç)

**KONKLUZIONE:**

- Vlerat më të rëndësishme për të rinjtë janë: *të jesh besnik, lojal ndaj partnerit/partneres/miqve/punëdhënësve të jesh i pavarur, të kesh karrierë të suksesshme dhe të merret përgjegjësi*. Punë me rëndësi më të vogël në jetën e të rinjve janë: *të jesh aktiv në politikë dhe të marrësh pjesë në aktivitete/ iniciativa qytetare*. Gjinia, moshja dhe etnia janë predikatorë të rëndësishëm të vlerave. Stili i prindërimit ndërlihet me vlera të caktuara, me ç'rast si më i dëshiruari në kuptimin e apostrofimit të vlerave të caktuara është stili autoritativ i prindërimit dhe, deri në njëfarë shkalle stili permisiv.
- Të anketuarit janë shumë më optimistë kur bëhet fjalë për ardhmërinë e tyre personale sesa kur bëhet fjalë për ardhmërinë e shoqërisë maqedonase. Me ardhmërinë personale optimiste shkon edhe orientimi i vet-perceptuar djathtist, besimi tek anëtarët e familjes më të ngushtë dhe më të gjerë, miqtë, si dhe tek njerëzit me religjion dhe përkatësi nacionale tjetër. Me projektionin “më të zyrtë” për ardhmërinë e vet pas 10 vitesh shkon edhe përvoja personale me diskriminimin. Me qëndrim për ardhmëri optimiste të Maqedonisë shkon edhe besimi në institucionet e sistemit, besimi në demokracinë në Maqedoni dhe besimi në liderët politikë në shtet.
- Të rinjtë në Maqedoni druajnë thua se për çdo gjë, dhe veçanërisht për ndotjen dhe ndryshimet klimatike, si dhe për varfërinë, ndërsa të anketuarit e gjinisë femërore dhe maqedonasit janë më të shqetësuar për pjesën më të madhe të dukurive.
- Shfrytëzimi i lidhjeve dhe njohjeve për gjetje të punës dhe nevoja të tjera, akoma haset në jetën e përditshme të të rinjve.
- Të rinjtë sot janë më religjioz sesa para 5 vitesh. Një përqindje e madhe edhe para 5 vitesh edhe sot praktikojnë rite fetare vetëm në festat e rëndësishme fetare.
- Aspekti religjioz shkon krahas për krahas me qëndrimet tradicionale dhe interesimin/involvimin/në politikë.
- Të rinjtë besim më të madh edhe tani edhe para 5 vitesh kanë tek anëtarët e familjes së tyre të ngushtë dhe më të gjerë dhe tek miqtë, ndërsa më pak u besojnë liderëve politikë.
- Maqedonasit dhe shqiptarët në vitin 2018 më pak i besojnë njëri-tjetrit sesa në vitin 2013.
- Nuk ekziston dominim social si preferencë personale.
- Të rinjtë manifestuan distancë shqetësuese për refugjatët, homoseksualët dhe veçanërisht për ish-të burgosurit dhe vartësit nga droga.
- Qëndrimi i të rinjve është se orientimi seksual dhe gjuha të cilën e praktikojnë të rinjtë rrallëherë është shkak për diskriminim, ndërsa bindjet politike dhe origjina etnike janë shkaqet më të shpeshta për diskriminim.
- Familja mesatare në Maqedoni është familja e cila mesatarisht përbëhet nga 4 anëtarë tek maqedonasit dhe 5 anëtarë tek shqiptarët: dy prindër dhe fëmijët.

- Të rinjtë, edhe pse dëshirojnë të jenë të pavarur dhe të marrin përgjegjësi, megjithatë, numri më i madh i tyre jetojnë në shtëpinë e prindërve të tyre. Si shkak për këtë i theksojnë financat e pamjaftueshme, frika nga pavarësia dhe nga normat kulturore.
- Anëtarët e familjes dakordësohen mirë midis tyre.
- Në vendimet e të rinjve marrin pjesë edhe dy prindërit.
- Të rinjtë në të ardhmen e shohin vetveten si të martuar me dy fëmijë.
- Të rinjtë janë të edukuar që ti respektojnë prindërit dhe në këtë mënyrë dëshirojnë ti edukojnë edhe fëmijët e tyre.

**REKOMANDIME**

- Të promovohet *një stil i balancuar i prindërimit* në kuptimin e permisivitetit të caktuar, demokracisë, por edhe respektim të autoriteteve (me përjashtim të stilit autoritar), konsistencë dhe principialitet gjatë edukimit. Kjo, madje edhe ndoshta duhet të bëhet përmes: mediave (përmes krijimit të serialeve arsimore, apostrofimit të praktikave të mira, emisioneve debative për llojin e prindërimit në Maqedoni); arsimit (në të gjitha nivelet, edhe atë përmes rishikimit të planeve dhe përmbajtjeve mësimore), pjesëmarrje në OJQ (në aksione promovuese të këtij lloji, projekte të qëndrueshme në nivel lokal dhe ngjashëm).
- Krijimi i politikave qeveritare, para së gjithash, në fushën e arsimit: arsimit praktik (që ka të bëjë me praktikë), arsimit i cili zhvillon aftësi jetësore dhe sociale, përveç kompetencave përkatëse dhe arsimit i cili zhvillon mendim kritik dhe kreativ dhe gjykim moral.
- Zhvillimi i besimit në institucionet e sistemit, veçanërisht tek gjyqësori dhe policia, meqë ndjenja se jetojmë në një botë të drejtë është baza e optimizmit dhe konstruktivitetit gjatë sjelljes.
- Investimi në programet personale dhe profesionale për self-trajnim për zhvillimin e ndjenjës së kompetencës personale dhe qëndrimin pozitiv ndaj ardhmërisë.
- Zhvillimi i vetëdijes ekologjike në arsim, por edhe përmes fushës mediale dhe përfshirjes së sektorit joqeveritar.
- Parandalimi i “mafias urbane” në ndërtime.
- Masa ekonomike për rritjen e punësimit dhe zhvillimin e sipërmarrësisë.
- Masa parandaluese dhe apele të përpiluara nga punonjësit shëndetësorë.
- Gjetje të masave për reduktimin e distancës afektive sociale e cila i bartë me vete paragjykimet, urrejtjen dhe dhunën. Kjo është e mundur përmes luftës së hapur kundër:
  - privilegjeve gjatë punësimit në gjyqësor dhe polici;
  - ligjeve të cilët nuk vlejné njëlloj për të gjithë;
  - nënshtrimit ndaj korrupsionit dhe krimit.

- Ndryshim i vetëdijshëm dhe i fokusuar i stereotipizimit gjatë të menduarit dhe nxënies së modeleve të vet-rregullimit – aktivitet i vetëdijshëm dhe i fokusuar i cili rezulton me sjellje e cila e thekson promovimin e diversiteteve dhe jo diskriminim; zhvillimi i mendimit kritik dhe kreativ; zhvillimi i parimeve dhe vlerave morale.
- Duhet të punohet në drejtim të implementimit efikas të arsimit inkluziv në të gjitha shkallët e sistemit arsimor, duke filluar nga kopshtet, me qëllim që të tejkalohen paragjykimet ndaj diversiteteve, veçanërisht të promovohen shkolla dhe paralele ndëretnike.
- Partitë politike duhet të ofrojnë platforma dhe programe joshëse për të rinjtë, dhe të rekomandohet që bartësit e vendimeve, në të gjitha nivelet, t'i përfshijnë të rinjtë në proceset e vendimmarrjes (veçanërisht në lidhje me temat të cilat i prekin të rinjtë), me qëllim që të kthehet besimi tek politika dhe njëkohësisht të stimulohet pjesëmarrja aktive e të rinjve në proceset politike. Në këtë drejtim është e pëlqyeshme edhe riformimi i këshillave aktivë dhe funksional rinor në kuadër të të gjitha komunave në nivel lokal.
- Nevojiten trajnime plotësuese për kuadrin mësimor dhe atë profesional në shkollat fillore dhe të mesme për t'u ballafaquar dhe për të vepruar në raste të diskriminimit midis nxënësve në cilëndo qoftë bazë.



## 7

# ARSIMI DHE PUNËSIMI

Arsimi në Republikën e Maqedonisë është në një proces të vazhdueshëm të reformave. Gjendja e këtillë e reformave të vazhdueshme nuk lë hapësirë për vlerësimin e efekteve të zbatimit të modeleve të caktuara arsimore dhe suksesin e tyre, gjithashtu e ngushton hapësirën për pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara për avancimin e procesit. Është veçanërisht vështirë të veçohen efektet pozitive dhe negative për shfrytëzuesit e drejtpërdrejtë të këtij procesi, përkatësisht për të rinjtë.

## KONTEKSTI NACIONAL

- Përqindja e përfshirjes së nxënësve në procesin arsimor është njëra nga përqindjet më të lartat midis shteteve të cilat marrin pjesë në hulumtimin PISA, e cili është 98,6%. (OECD (2016), PISA Results 2015). Gjendja e këtillë, mes tjerash, ka të bëjë edhe me ndryshimet ligjore të vitit 2008, dhe që atëherë, përveç arsimit fillor, edhe arsimi i mesëm u bë i detyrueshëm.
- Arsimi në Republikën e Maqedonisë është organizuar sipas Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit – KSNA (International Standard Classification of Education – ISCED), i hartuar nga ana e UNESCO dhe i klasifikuar në kornizën maqedonase të kualifikimeve.
- Sipas raporteve statistikore nga vitit 2017/18, numri i shkollave fillore është 989, ndërsa raporti nxënës/mësimdhënës është 10,5 (19.2448 nxënës kundrejt 18.291 mësimdhënës). Në periudhën e njëjtë në Maqedoni ka edhe “shkolla të specializuara fillore” – 43, si dhe “shkolla fillore për të rritur” – 12.
- Sipas raporteve statistikore nga viti 2017/18, numri i shkollave të mesme është 131, ndërsa raporti nxënës/mësimdhënës është 9,5 (71.458 nxënës përkundrejt 7.445 mësimdhënës).
- Vërehet tendencë e reduktimit të numrit të përgjithshëm të nxënësve edhe në arsimin fillor edhe në arsimin e mesëm, si rezultat i ndryshimeve demografike.
- Maqedonia ka 14 universitete dhe 5 shkolla të larta profesionale. Në vitin 2016/17 numri i studentëve të regjistruar në të gjitha institucionet e arsimit të lartë ishte 58.083 studentë. Nga ky numër, pjesa më e madhe e studentëve (86,6%) janë regjistruar në institucionet shtetërore të arsimit të lartë, ndërsa 13% janë regjistruar në institucionet private të arsimit të lartë. Raporti student-profesor është 20,3 (58.083 studentë përkundrejt 2.854 profesorë<sup>23</sup>)
- Sipas analizës të hulumtimit PISA, perceptimi i mësimdhënësve për kapacitetin fizik të shkollave fillore dhe të mesme është i kënaqshëm.
- Zhvillimi profesional i mësimdhënësve (në arsimin fillor dhe të mesëm) është i ulët – 16% e mësimdhënësve, të cilët tre muaj para testimit PISA kanë marrë pjesë në ndonjë program për përsosje profesionale.
- Rezultatet e testimit PISA (OECD (2016), PISA Results 2015) (test për aplikimin praktik të njohurive: lexim, matematikë, shkencat e natyrës), treguan në testimin e parë në vitin 2000 se nxënësit maqedonas të moshës 15 vjeçare ishin në fund të listës. Në testimin e realizuar në vitin 2015, rezultatet janë akoma më të këqija për nxënësit maqedonas në të gjitha kategoritë. Qëllimi i Strategjisë evropiane për zhvillim të zgjuar, të qëndrueshëm dhe inkluziv (ET 2020) është përqindja e nxënësve të moshës prej 15 vjeçare me arritje të dobëta (low-achieving) të jetë më i ulët se 15% (tek ne për shkencë është 62,9%, për matematikë 70,2%, lexim 70,7%).
- Në shumë studime të përpiluara për raportin e arsimit, të rinjve dhe punësimit, vlerësimi është i përbashkët se arsimi në Republikën e Maqedonisë është joadekuat në përgatitjen e nxënësve/studentëve për tregun e punës.

## KËNAQËSIA NGA CILËSIA E ARSIMIT

Sa i përket cilësisë së arsimit, ajo është vlerësuar me vlerë mesatare 2,61 (std.dev=1.179), në shkallën prej 1 (aspak nuk jam i kënaqur, deri në shkallën 5 jam shumë i kënaqur), ku 43,6% janë në pjesën e shkallës së pakënaqësisë, 35,6% janë mesatarisht të kënaqur dhe në pjesën e shkallës të cilët janë të kënaqur ka 20,8%. Ky rezultat korrespondon me rezultatet e fituara nga studimet e analizuar paraprake. Në përgjithësi, cilësia e arsimit në analizat tjetra vlerësohet me notë mesatare “mirë, por nevojiten reforma solide”.

### Si e vlerësoni cilësinë e arsimit? Çka është pozitive dhe çka negative?

“Mendoj se cilësia e arsimit në Maqedoni nuk është në nivel të lartë. Sa u përket hapësirave, inventarit nëpër institucione të cilat janë të vendosura në kryeqytet, mendoj se lartë-poshtë janë në rregull. Por, nëse flasim për kuadrin, duke filluar nga kopshtet deri në arsimin e lartë, mendoj se cilësia e kuadrin është në nivel shumë të ulët (përveç përjashtimeve të cilët nga 100% mund të jenë 15–20%). Kjo gjendje mund të përmirësohet nëse të punësuarit të cilët punojnë në institucionet arsimore – shkencore, vizitojnë seminare, trajnime se si ta praktikojnë procesin mësimor, çfarë qasje të kenë ndaj nxënësve/studentëve etj., të hartohen programe më të mira sipas të cilëve do të zhvillohet procesi mësimor, si dhe të ketë monitorim të vazhdueshëm dhe vlerësim të mësimdhënësve dhe profesorëve. Deri në një sistem arsimor nuk nevojiten shumë, por pikërisht mangësitë e vogla rezultojnë në atë që të mos kemi sistem të mirë dhe cilësor arsimor.” (Kate, 24 vjeç)

Analiza regresive lineare e variablove që kanë të bëjnë me arsimin tregoi korrelacion në lartësi prej  $R=,499$ ;  $Rsquare=,245$  të variablove në vijim të cilat kanë kontribut më të madh sa i përket kënaqësisë nga cilësia e arsimit në vend: variabla “përshtatja e programeve mësimore” ndaj punës, ku 70% janë të mendimit se nuk janë të përshtatura në mënyrë adekuate, ( $B=,990$ ;  $Beta=,411$ ;  $p<,001$ ) dhe variabla “sa lehtë do të gjejnë punë pas kryerjes së shkollës”, me ç’rast vetëm 16% janë të mendimit se shumë lehtë do të gjejnë punë ( $B=,299$ ;  $Beta=,317$ ;  $p<,001$ ).

Thënë me fjalë të tjera, do të ishte e pritshme, perceptimi subjektiv i të rinjve për kënaqësinë nga cilësia e arsimit në vend të shënoj rritje nëse përshtaten programet mësimore me botën e punës dhe nëse të rinjtë më shpejtë gjejnë punë pas kryerjes së arsimit.

“Mendoj se lëndët siç janë ato të shkencave të natyrës, kanë ngecje më të madhe në demonstrimin praktik – ndërsa nga ana tjetër nxënësit janë të stërngopur me teori të panevojshme. Kjo i pamundëson të rinjtë të njoftohen me anën e vërtetë të këtyre shkencave, kështu që menjëherë krijojnë refuzim. Si pozitiv do ta veçoja faktin se materiali nuk është “shumë i përtypur”, kështu që kjo i lë nxënësit të gjenden ashtu siç dinë ata. Ndoshta kjo në vështrim të parë nuk është edhe aq pozitive – megjithatë, mua personal-


sht më ka ndihmuar të ndërtoj një karakter më të fuqishëm dhe më të besueshëm dhe mënyrë të punës, me ç’rast nuk pres që gjërat të jenë të lehta ose se çdo gjë në jetë do të vijë përmes udhëzuesit.” (Dritan, 17 vjeç)

## CILËSIA E ARSIMIT DHE BLERJA E NOTAVE

Njëri nga indikatorët për cilësinë e arsimit është edhe “fenomeni i blerjes së notave”. Në shkallën prej 1 (jo aspak) deri në shkallën 5 (shumë) vlera mesatare është  $M=4.12$  ( $Sd$  1,161). Kategoria e të rriturve prej 20–24, kryesisht nga mjediset urbane, maqedonas në numër më të madh në krahasim me shqiptarët, si dhe nga grupmosha të tjera u përcaktuan se ekziston fenomeni i blerjes së notave.

Krahasimi i vlerave ekstreme (“jo aspekt” dhe “po shumë”), në dy vitet e analizuar tregoi se fenomeni i blerjes së notave gjatë viteve të kaluara shënon rritje. Në vitin 2018, përqindja e përgjigjeve me “po” është dyfish më e madhe nga viti 2013 (54,9% kundrejt 26%).

FOTO NR. 47: **Ka raste të blerjes së notave në shkolla / universitete**




## MESATARJA E NOTAVE

Vlera mesatare e suksesit mesatar është 3,01, përkatësisht midis 3 dhe 4 tek nxënësit dhe midis 7 dhe 8 tek studentët. Krahasimi i vlerës mesatare të mesatares së notave tregoi se nuk ka dallim midis dy viteve të krahasuar. Njëlloj si në vitin 2013 edhe në vitin 2018 mesatare pak më të lartë kanë vajzat për dallim nga djemtë.



FOTO NR. 48: Mesatarja e notave 2013/2018




## ORËT E PËRKUSHTUARA PËR MËSIM



Që t'i fitojnë këto nota, të rinjtë mesatarisht mësojnë në ditë pak më shumë se 2 orë (M=2,61). Më shumë mësohet në arsimin e mesëm dhe në atë universitar sesa në atë fillor, ndërsa vajzat (M=2,74) mësojnë më shumë se djemtë (M=2,47). U paraqit dallim në numrin e orëve të dedikuara për mësim krahasuar me dy vitet e analizuara. Numri mesatar i orëve të përkushtuara për mësim në vitin 2018 është reduktuar, për dallim nga viti 2013, veçanërisht është reduktuar përqindja e atyre të cilët mësojnë më shumë se 3 orë (nga 44% në 22,5%).

Arsimi i prindërve, nga aspekti statistikor, nuk u tregua si më i rëndësishmi, sa u përket orëve të mësimin, por u tregua si e dhënë e rëndësishme statistikore, se në familjet në të cilat ka më shumë se 30 libra fëmijët mësojnë më shumë. Sipas statusit socio-ekonomik, që rezultoi nga testimi Post Hoc, u vërejt grupim i familjeve në dy grupe. Në grupin e parë janë fëmijët të cilët vijnë nga "familje të cilat nuk kanë para t'i përmbushin nevojat elementare (rrymë, ngrohje... ushqim)" dhe më së paku orë i përkushtojnë mësimin (M=1,76). Në grupin e dytë të familjeve kemi katër kategori ("mjaftueshëm para për faturat elementare, ushqim, këpucë dhe rroba", "mjaftueshëm para për nevojat elementare, por të pamjaftueshme për gjëra më të shtrenjta", "mund t'i lejojnë vetvetes gjëra më të shtrenjta, por nuk mund t'ia lejojnë vetvetes të blejnë apartament ose automobil"), më së shumti mësojnë fëmijët në familjet të cilat "mund t'i lejojnë vetvetes çdo gjë që u nevojitet për jetë të mirë" (M=2,82).

FOTO NR. 49: Orët e përkushtuara për mësim 2013/2018



Ditën tipike në shkollë si të vështirë dhe me stres e perceptojnë dy të tretat e të anketuarve ose 72,1%, që është për 14% më shumë sesa në vitin 2013.

FOTO NR. 50: **Ditë e zakonshme në shkollë/fakultet 2013/2018**FOTO NR. 51: **Aspiratat për shkallën e arsimit**

Cila nga përshkrimet e lartëshënuara më mirë e përshkruajnë gjendjen tuaj financiare në familje?

## ASPIRATA DHE INVESTIME

Në studimin "Tendenca rinore në Republikën e Maqedonisë" (Jakimovski, J. viti 2014), sa i përket qëndrimit të përgjithshëm për arsimin, 45% e të rinjve u deklaruan se arsimi është puna më e rëndësishme në jetë, ai ka më shumë aspekte pozitive sesa negative ndaj njeriut, e bën qytetarë të mirë, e ndërton karakterin e tij dhe e ndihmon të kënaqet në jetë, koha e kaluar për mësim nuk është kohë e humbur për së koti, përvojat e fituara në shkollë ndihmojnë në jetë.

Në këtë drejtim janë edhe të dhënat në lidhje me aspiratat e të rinjve për shkallën e arsimit të cilën duan ta arrijnë. Nga shkalla e përcaktuar me shtatë nivele, vlera mesatare e përgjigjeve është  $M=4,55$  (4-universitetet baçelor, 5-universitet specialist, 6-master, 7-doktorat), përkatësisht aspirata e 80% nga të anketuarit është të arrihet arsimi universitar. Sa u përket aspiratave të të rinjve për shkallën e arsimit që dëshirojnë ta arrijnë u detektua korrelacion sinjifikativ në nivel të rëndësisë  $p<0,01$ , sipas: vendbanimit ( $r=,099$ ), grupmoshave ( $r=,170$ ), statusit socio-ekonomik ( $r=,165$ ), arsimit të prindërve (nëna  $r=,234$ , babai  $r=,273$ ), numri i librave në familje ( $r=,264$ ).

Ata që kanë vendbanime në mjedise urbane (M=4,64) kanë aspirata më të larta në krahasim me ata që jetojnë në mjedise rurale (M=4,36). Aspiratat e grupmoshës nga 25–29 vjet, me arsim të kryer universitar (M=5,38) janë më të larta dhe dallojnë nga grupmoshat e tjera me arsim të mesëm (M=4,17) dhe me arsim fillor (M=4,41). Sa u përket aspiratave për shkallën e arsimit ndikim të vet ka edhe arsimi i nënës dhe babait, sa më i lartë është arsimi i prindërve aq më e lartë është aspirata e fëmijëve për shkallën e arsimit. Statusi socio-ekonomik ka ndikim mbi aspiratat e të rinjve për nivelin e dëshiruar të arsimit. Kategoria e fëmijëve nga familjet të cilat “mund t’i lejojnë vetvetes gjëra të shtrenjta, por nuk mund t’ia lejojnë vetvetes blerjen e banesës ose të automobilin” (M=4,63), si dhe të atyre që “mund t’ia lejojnë vetvetes çdo gjë që u nevojitet për jetë të mirë” (M=4,93), kanë aspirata më të larta nga fëmijët e familjeve tjera. Përsëri numri i librave tregoi një korrelacion pozitiv me aspiratat për arsim, përkatësisht aspiratë më të lartë për arsim paraqitet te grupi i familjeve të cilat kanë mbi 50 libra (M=5,01) dhe mbi 100 libra (M=5,31).

Më shumë se dy të tretat janë të sigurt se do ta arrijnë shkallën e dëshiruar të arsimit (M=4,21). Siguri më të madhe manifestojnë ata të cilët kanë status më të mirë socio-ekonomik.


## ARSIMI DHE PUNËSIMI

Në mbështetje të notës negative, lidhur me cilësinë e procesit arsimor, janë edhe konstatimet e punëdhënësve se nga njëra anë mungojnë profesione të caktuara ndërsa nga ana tjetër nxënësit/studentët vështirë punësohen. Me nocionin “punësim” mendohet në *gatishmërinë për punë*, në kuptimin e posedimit të aftësi-ve, njohurive, raportit dhe të kuptuarit e industrisë, që do t’u mundësoj studentëve të diplomuar të kontribuojnë në mënyrë produktive në tërësitë organizative shumë shpejtë pas punësimit të tyre (Mason, 2009).

Si probleme kryesore që ndërlidhen me pozitën e të rinjve në tregun e punës, në të gjitha studimet e analizuara apostrofohen: cilësia e pamjaftueshme e rezultateve të arsimit, irelevanca e rezultateve të arsimit, sa u përket nevojave të tregut të punës, lidhjet akoma të kufizuara me industrinë dhe botën e punës, procesi mësimor për drejtimin në karrierë akoma nuk është integruar në programet mësimore të shkollave të mesme.

Dy të tretat e të anketuarve konsiderojnë se programet shkollore nuk u janë përshtatur kërkesave të punës (69%), ndërsa (31%) konsiderojnë se janë përshtatur. Sa i përket sektorit në të cilin punojnë, ata të sektorit publik janë përcaktuar me një përqindje pak më të lartë – 40%, se programet shkollore i janë përshtatur punës.

FOTO NR. 52: **A mendoni se trajnimet, arsimi shkollor dhe universitar janë përshtatur mirë me botën e punës?**




Sa i përket praktikës vetëm 36% e të anketuarve kanë bërë punë praktike gjatë arsimit të tyre. Është serioze e dhëna se më pak se një e treta e nxënësve dhe studentëve të rregullt gjatë arsimit të tyre kanë bërë punë praktike.

Në vitin 2013, përqindja e atyre që kanë bërë punë praktike në arsimin e mesëm është më e lartë për 2% prej atyre në vitin 2018 (28%). Brengos krahasimi me ata që janë në fakultet: në vitin 2013 u deklaruan 50% e të anketuarve se kanë bërë punë praktike, ndërsa në vitin 2018 vetëm 33,9%.

Sa i përket punës praktike studentore (studentë në fakultet), Ligji për arsimin e lartë (LAL, 2008) i përcakton dispozitat sipas të cilave krijohet programi për punë praktike studentore. Për shkak të zbrazësive ligjore, i cili përjetoi shumë ndryshime nga viti 2008 e deri më sot, puna praktike e studentëve në shumicën e rasteve është formale (studentët nuk bëjnë punë praktike por nga miqtë e tyre të biznesit u dërgojnë dokument të vërtetuar në fakultet për vërtetimin e semestrit).

FOTO NR. 53: **A keni participuar gjatë arsimit tuaj në ndonjë lloj të punës praktike, me statusin aktual të arsimit?**




### Si e vlerësoni cilësinë e arsimit në Republikën e Maqedonisë? Çka është pozitive dhe çka negative?

“Pozitive është se njerëzit e rinj gjithnjë e më shumë dëshirojnë të kryejnë arsim të lartë dhe të mësojnë më shumë, por aspekti negativ është ai që mësimit/profesorët ua asfiksojnë këtë dëshirë me atë që njohurinë e tyre më së shpeshti e bartin përmes ligjëratave pa inter-aksion me nxënësit/studentët. Të gjithë të rinjtë, me ose pa diplomë, dalin të paditur nga dyert e shkollave, pa kurrfarë njohurie praktike, me teori të pastër dhe me rezultate të fituara duke mësuar përmendësh.” (Bojan, 25 vjeç)

Për atë se lehtë do të gjejnë punë pas kryerjes së arsimit, mendojnë 16,1 % e të anketuarve.

FOTO NR. 54: **Sa lehtë do të gjeni punë pas kryerjes së arsimit?**




U tregua interesant grupimi në lidhje me statusin aktual të arsimit.

Më së lehti mendojnë se do të gjejnë punë ata “që janë involvuar në ndonjë lloj tjetër të arsimit ose trajnimit” (M= 3,36), mendimi i tyre veçanërisht dallon prej atyre që janë në “arsimin e mesëm” (M=2,46) dhe të atyre në “fakultet” (M=2,56).

Kjo e dhënë shkon në drejtim të tendencave bashkëkohore të politikës për mësim gjatë gjithë jetës, si aspekt i avancimit të ekonomisë moderne, e që është pjesë e rëndësishme e Strategjisë së BE, ku format joformale të mësimnxënies bëhen veçanërisht të rëndësishme. Involvimi në forma joformale të mësimnxënies ndikon mbi perceptimin për gjetjen e punës. Megjithatë, në Maqedoni niveli është akoma i ulët (nga aspekti kuantitativ dhe kualitativ) i sigurimit të arsimit për të rritur, nuk ekziston sistem në bazë të kompetencave i cili ndërlidhet me botën e punës; të pakta janë mundësitë për mësim gjatë gjithë jetës për personat që nuk e kanë shfrytëzuar mundësinë të arsimohen.

Nga analiza e dokumenteve, hulumtimeve dhe studimeve që kanë të bëjnë me këtë temë, si shkaqe për papunësinë rinore në Maqedoni mund të veçohet: kalimi i vështirë nga shkolla në punë; mungesë e punës praktike në kushte reale; disproporcion midis arsimit të fituar përmes përvijës së fituar arsimore dhe nevojave reale në tregun e punës; pranim të punës si i pa-lajmëruar (punë në të zezë), nivel i ulët i pagave.

FOTO NR. 55: Sa lehtë do të gjeni punë pas kryerjes së arsimit formal?



Modeli i të anketuarve të këtij Studimi e pasqyron gjendjen reale të punësimit të të rinjve në Republikën e Maqedonisë. Sipas Entit Shtetëror të Statistikave, gjendja në vend me punësimin e të rinjve (15–24) është në nivel jashtëzakonisht të ulët (rreth 16%). Sipas gjendjes në vitin 2015, punësimi sipas grupmoshës është: 5,8% (15–19), pastaj 27,1% (20–24), 47,3% (30–34). Vërehet

edhe ndryshimi i përgatitjes shkollore. Në periudhën kohore të viteve 2006–2015, numri i të rinjve (15–29) të punësuar me nivel të ulët të arsimit është reduktuar për 44,1%, me arsim të mesëm ka shënuar rritje për 10%, ndërsa me arsim të lartë ka shënuar rritje dyfish më të madhe.

TABELA NR. 6: Cili është statusi i Juaj momental i punës?

Cili është statusi i Juaj momental i punës?	Number of cases	%
Kam kontratë të përhershme me orar të plotë të punës	121	13
Kam kontratë të përhershme me orar të shkurtuar të punës	12	1,3
Kam kontratë të përkohshme me orar të plotë të punës	133	14,3
Kam kontratë të përkohshme me orar të shkurtuar të punës	71	7,6
Kam punë periodike	72	7,7
I vetëpunësuar	42	4,5
Në trajnim profesional	13	1,4
Nuk kam punë, por aktivisht kërkoj punë	160	17,2
Nuk kam punë dhe momentalisht nuk kërkoj punë	293	31,5
Gjithsej	931	100


Pjesëmarrja e personave të punësuar të rinj joformal është në masë konsiderueshëm më të madhe tek të rinjtë e grupmoshës prej 15–24 dhe është në lartësi prej 38,6%. Me orar të shkurtuar të punës më të pranishëm janë të rinjtë të grupmoshës prej 15–29 (25%). Sipas statusit ekonomik (i punësuar, i punësuar në llogari personale, punëdhënës dhe punëtor i papaguar familjar), në kategorinë punëtor i papaguar familjar më të pranishëm janë të rinjtë e grupmoshës prej 15–29 vjeç ose rreth 20.000 persona.

Në modelin tonë të vitit 2018 numri mesatar javor i orëve është 37 orë, për dallim nga viti 2015 kur ishte 31 orë.

Një e treta e atyre që punojnë, punojnë në profesionin e tyre, ndërsa çdo i pesti punon punë e cila është shumë e afërt me profesionin e tij/saj. Megjithatë, 42,6% nuk punojnë në profesionin e tyre. Vendi i punës në të cilin aktualisht punojnë për 62% e të anketuarve është në linjë të njëjtë me nivelin e tyre të arsimit formal. Një e katërta e të anketuarve punojnë në vendin e punës

për të cilin është parashikuar nivel më i ulët i arsimit prej nivelit të cilin ata e posedojnë.

“Problemi më i madh konsiston me atë se të rinjtë pas kryerjes së arsimit universitar nuk mund të gjejnë punë në profesionin e tyre. Prandaj pajtohen të punojnë punë të tjera për pagë të ulët. E gjithë kjo kontribuon që të rinjtë të mos ndihen të lumtur dhe të jenë të demotivuar dhe depresiv, ndërsa shpëtimin ta kërkojnë jashtë shtetit tonë.” (Mina, 25 vjeç)




Sektori në të cilin kryesisht punojnë të rinjtë është sektori privat (61%). Sipas të dhënave nga Enti Shtetëror i Statistikave, numri më i madh i vendeve të punës për persona të rinj (15–29) sigurohet nga sektori i bujqësisë (18,8 për qind nga numri i përgjithshëm i personave të punësuar të rinj), sektori i prodhimtarisë (18,4 për qind), sektori i tregtisë (18,1 për qind), sektori i ndërtimtarisë (7,0 për qind), objekte për akomodim dhe veprimtari shërbuese me ushqim (6,1 për qind). Vendet e punës në të cilat kryesisht punojnë të rinj janë në bujqësi, në prodhimtari dhe ndërtimtari, dhe nga ana tjerët janë vende pune të paguara me paga më të ulëta (70–75 për qind të pagës mesatare mujore, e cila në muajin mars të vitit 2018 ishte 22.000 den).

Një numër i vogël i atyre që janë në marrëdhënie pune, janë ballafaquar me atë se “nuk janë pranuar në punë për shkak të notave të ulëta” (10%), “nuk janë punësuar për shkak të shkallës së pamjaftueshme të arsimit” (19%), “janë shpërngulur meqë nuk ka pasur punë adekuate në rajonin në të cilin kanë jetuar” (12%).

## VENDI I DËSHIRUAR I PUNËS

Të rinjtë më së shumti dëshirojnë të punojnë në sektorin publik (45%). Në krahasim me vitin 2013, në vitin 2018 përqindja e të anketuarve të cilët dëshirojnë të punojnë në sektorin publik ka shënuar rritje për 6%, ndërsa për punë në sektorin privat përqindja ka shënuar rënie për 5%. Shpërndarja e përqindjeve në sektorët e tjerë është e ngjashme në të dy vitet.



Për dallim nga viti 2013, në vitin 2018 nuk u paraqit dallim i konsiderueshëm statistikor në lidhje me gjininë, vendbanimin dhe përkatësinë etnike.

## FAKTORË PËR GJETJEN DHE ZGJEDHJEN E PUNËS

Si faktorë të rëndësishëm për gjetje të punës, në mesin e tre të parëve theksohen “lidhjet dhe miqtë”, në vend të dytë “lidhjet me njerëz të pushtetshëm” dhe në vend të tretë “fati”, pastaj vijnë “ekspertiza” dhe në vend të pestë “niveli i arsimit”, pastaj “anëtarësia në parti”, në vendin e shtatë “arsimi ose përvoja punës e fituar jashtë vendit” dhe në vendin e fundit, në vendin e tetë “rajonin”. Është bërë një krahasim i pjesshëm me vitin 2013 i cili nuk është konsekuent, meqë në vitin e njëjtë ishin përcaktuar vetëm 5 faktorë, përkundërt 8 faktorëve të cilët u përcaktuan në vitin 2018. Megjithatë, mund të vërehet se faktori “fat” në vitin 2018 është në vendin e tretë, ndërsa në vitin 2013 ishte në vendin e pestë nga gjithsej 5 faktorë të përcaktuar. E dhëna se fati është në mesin e tre faktorëve të parë për gjetje të punës e konfirmon tezën se të rinjtë ekzistojnë në mjedis i cili nuk u mundëson realisht ti vlerësojnë

shanset për realizimin e të drejtave, interesave dhe nevojave të tyre, si dhe për përmirësimin e pozitës socio-ekonomike.

Mjedisi në të cilin ekzistojnë detektoi disa probleme të cilat ndikojnë mbi nivelin e punësimit tek të rinjtë dhe ndjenjën për atë se çka nevojitet për të gjetur punë: gjendja e përgjithshme ekonomike në vend, e cila rezultoi me mungesë të vendeve përkatëse të

punës, për nga vëllimi dhe cilësia; të rinjtë nuk posedojnë kompetenca të kërkuara në tregun e punës; intervenime të izoluar afatshkurtra për tejkalimin e papunësisë rinore; gjendje e përgjithshme e rezignimit dhe mos-motivimit të të rinjve në procesin e (vet) punësimit; mbështetje të pamjaftueshme të sipërmarrësisë rinore. (*“Strategjia nacionale për të rinj, 2016–2020”*).

TABELA NR. 7: **Rankimi i faktorëve për gjetje të punës**

Range of factors in finding a job	2018	2013
Njohje (miq, familjarë...)	1	1
Lidhje me njerëz që janë në pushtet	2	2
Fati	3	5
Profesionalizmi	4	4
Niveli i arsimit	5	3
Anëtarësimi në parti	6	
Arsimi ose përvoja e punës e fituar jashtë vendit	7	
Origjina (rajoni juaj)	8	

Që të zgjedhin punë, të rinjtë nga tetë faktorët e përcaktuar, si tre faktorë më të rëndësishëm i kanë zgjedhur: “vend i sigurt i punës pa frikë nga përjashtimi”, në vend të dytë “paga” dhe në vend të tretë “kohë mjaftueshëm e lirë, krahas punës”. Pastaj vijon: në vend të katërt “mundësi në karrierë”, në vend të pestë “ndjenja se diçka arrin”, në vend të gjashtë “të bëhet diçka e rëndësishme për shoqërinë”, në vend të shtatë “të punosh me kolegë që të pëlqejnë” dhe në vend të tetë “punë me njerëz”. U konstatua aspekti sinjifikativ me statusin socio-ekonomik, përkatësisht me të ardhurat që i ka familja. Mund të konkludojmë se ka dallim midis atyre me të ardhura më të larta dhe më të ulëta. Tek ata të cilët vijnë nga familje me të ardhura më të larta i kanë më me rëndësi faktorët: “mundësi në karrierë”, “ndjenjë se diçka arrin”, “të bëhet diçka e rëndësishme për shoqërinë”, “kohë mjaftueshëm e lirë, krahas punës”, në krahasim me ata që vijnë nga familje me të ardhura më të ulëta.

Studimi për të rinj në Republikën e Maqedonisë 2016 (Topuzovska Latkoviq, 2016), si dhe të dhënat nga ky hulumtim i konfirmuan të dhënat se “gjenerata maqedonase e mijëvjeçarit” sa i përket punës është me karakteristikat e njëjta si edhe “mijëvjeçarët” nga Evropa dhe SHBA; Nga vendi i punës presin pagë të mirë, fleksibilitet, mundësi për zhvillim në karrierë, mundësi për tu dëshmuar dhe për t’i vlerësuar angazhimet e tyre.

Duke e marrë parasysh përqindjen e lartë të papunësisë në vend, veçanërisht papunësinë e lartë rinore, punën e të rinjve kryesisht në sektorin joformal, punësimet tek-tuk, puna në sektorë me paga nën mesataren e vendit, është e pritshme se “vendi i sigurt i punës pa frikë nga përjashtimi” është në vend të parë sipas rëndësisë së zgjedhjes së punës, si dhe zgjedhja e vendit të punës në sektorin publik.

## VULLNETARIZMI

Vullnetarizmi është aktivitetet në bazë të bindjes personale, me ç’rast investohet koha personale, ndërsa qëllimi është të futen përmbajtje dhe vlera të reja në jetën e njerëzve të tjerë, duke mos pritur dobi materiale, përkatësisht investime të cilat nuk paguhen (Wilson, 2000.; Puljiz i sur., 2005.).

Vullnetarizmi rinor ka dobi të shumëfishtë. Përveç asaj që është burim i ndihmës për kategori të caktuara të njerëzve në shoqëri kjo është mënyrë e përvojës së edukimit të të rinjve për rolin aktiv qytetar në zhvillimin e shoqërisë demokratike. Nga ana tjetër, është përgatitje për tregun e punës, meqë mundëson nxenie dhe fitim të përvojës dhe aftësive të reja, veçanërisht punë ekipore, komunikim, ndërmarrje të iniciativave, vendimmarrje.


Niveli i përfshirjes së të rinjve në aktivitetet vullnetare ka shënuar rritje të vogël në vitin 2018 dhe është 20% e të rinjve të cilët kanë bërë punë vullnetare në 12 muajt e fundit, për dallim nga viti 2013 kur kjo përqindje ishte vetëm 12,8%.

Bëhet fjalë për nivel shumë të ulët të involvimit të aktivitetit pa pagesë/vullnetar. Sa i përket gjinisë, përkatësisë etnike, grupmoshave, vendbanimit, shëndetit, nuk u paraqit sinjifikancë. Sinjifikancë kemi me variablën përgatitje shkollore, me ç’rast ata me arsim të mesëm kanë vlerë më të lartë të aktivizmit vullnetar për dallim prej atyre me arsim fillor dhe arsim universitar. Statusi socio-ekonomik, përkatësisht të ardhurat e familjes e vënë në dukje dallimin midis më të pasurve (midis atyre që mund t’i lejojnë vetvetes çdo gjë) dhe janë grup i veçantë me më së paku aktivitete vullnetare, ndërsa në grupin tjetër më së shumti aktivitete vullnetare kanë ata me të ardhura më të ulëta (nuk kanë mjaftueshëm për nevojat bazike).






FOTO NR. 59: **A keni marrë pjesë në aktivitete vullnetare gjatë 12 muajve, përkatësisht a keni punuar vullnetarisht punë të papaguar?**



Edhe pse përqindja e aktivitetit vullnetar është e papërfillshme, megjithatë, është interesant të shihet në cilat organizata është zhvilluar aktiviteti. Më së shumti ose 4,6% kanë bërë punë vullnetare në shkolla ose universitete, 4,1% në OJQ, 3,3% në organizata rinore. Pastaj, vijojnë me një përqindje shumë më të ulët ose nën 2%: iniciativa qytetare, klube sportive dhe muzikore, partitë politike, angazhimi personal, projekte të pavarura, kryqi i kuq etj.

FOTO NR. 60: **Organizata në të cilat ku keni bërë punë vullnetare e shprehur në përqindje**



## KONKLUZIONE

- Aspiratat në lidhje me shkallën e dëshiruar të arsimit tek më shumë se 80 % e të rinjve janë që të kryejnë arsim universitar. Aspiratat më të larta janë tek të rinjtë nga mjediset urbane, me prindër të arsimuar me shkollim universitar, në familje me status më të mirë socio-ekonomik, në familje me më shumë se 50 libra. Më ambicioze është grupmosha prej 25–29 vjeç;
- Më shumë se dy të tretat janë të sigurt se do ta arrijnë shkallën e dëshiruar të arsimit (M=4,21);
- Numri i orëve të përkushtuara për mësim është reduktuar në krahasim me vitin 2013, veçanërisht tek ata që mësojnë më shumë se 3 orë, nga 44 % në 22,5 % në vitin 2018. Statusi socio-ekonomik i familjes ndikon mbi orët e përkushtuara për mësim;
- Dy të tretat e të anketuarve ditën e zakonshme në shkollë e perceptojnë si të vështirë dhe me stres;
- Dukuria e blerjes së notave gjatë viteve të kaluara shënon rritje;
- Përafërsisht gjysma e të anketuarve janë të pakënaqur nga cilësia e arsimit. Veçanërisht janë të pakënaqur nga përshtatja e programeve mësimore ndaj botës së punës dhe mundësisë të gjejnë punë pas kryerjes së shkollimit;
- Konsiderojnë se më së lehti do të gjejnë punë ata të cilët “janë involvuar në ndonjë lloj tjetër të arsimit ose trajnimit” (M= 3,36), mendimi i tyre veçanërisht dallon prej atyre që janë në “arsimin e mesëm” (M=2,46) dhe në “fakultet” (M=2,56);
- Më pak se një e treta e nxënësve dhe studentëve të rregullt gjatë arsimit të tyre kanë bërë punë praktike;
- Të rinjtë më së shumti dëshirojnë të punojnë në sektorin publik (45 %);
- Një e treta e atyre që punojnë, punojnë në profesionin e tyre, ndërsa çdo i pesti kryen punë e cila është shumë e afërt me profesionin e tij/saj. Sektori në të cilin kryesisht punojnë të rinjtë është sektori privat (61 %);
- Apostrofimi i “fatit” në mesin e tre faktorëve të parë për gjetje të punës (faktor i parë “lidhje dhe miqësi”, faktor i dytë “lidhje me njerëz të pushtetshëm”) e konfirmojnë tezën se të rinjtë ekzistojnë në mjedis në të cilin rregullat janë të paqarta dhe nuk vlejnë njëlloj për të gjithë. Kjo nuk ju mundëson realisht t’i vlerësojnë shanset për realizimin e të drejtave të tyre, interesave dhe nevojave për përmirësimin e pozitës socio-ekonomike;
- Që të zgjedhin punë, nga tetë faktorët e përcaktuar, si tre faktorë më të rëndësishëm të rinjtë i zgjedhin: në vend të parë “vend i sigurt i punës, pa frikë nga përjashtimi”, në vend të dytë “paga” dhe në vend të tretë “kohë mjaftueshëm e lirë, krahas punës”.
- Vetëm 20 % e të rinjve kanë bërë punë vullnetare në 12 muajt e fundit. Ata me arsim të mesëm kanë vlerë më të lartë të aktiviteteve vullnetare për dallim nga ata me arsim fillor dhe universitar. Më të pasurit (ata të cilët mund t’i lejojnë vetvetes çdo gjë) janë me më pak aktivitete vullnetare.

## PROBLEMET KRYESORE TË DETEKTUARA NË SISTEMIN ARSIMOR DHE GJATË PUNËSIMIT:

- Nivel i ulët i notave nga testimi PISA për lexim, matematikë, shkenca të natyrës;
- Nivel i ulët i punësimit dhe vetëpunësimit ose arsimit është joadekuat gjatë përgatitjes së studentëve/nxënësve për tregun e punës dhe për vetëpunësim;
- Korrupsioni në arsim dhe gjatë punësimit.

## REKOMANDIME

- Pranimi i përgjegjshëm i rezultateve nga testimi PISA nënkupton përcaktim të masave të cilat duhet të ndërmerren në mënyrë që të përmirësohet cilësia e arsimit dhe me këtë edhe i rezultateve të nxënësve. Është e pashmangshme nevoja e analizës së thellë me përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në lidhje me atë se çka ndodhë nëpër shkolla. Analiza duhet t’i përgjigjet pyetjes: *Pse nxënësit maqedonas kanë rezultate të ulëta në testimin PISA? Si të reduktohet përqindja e nxënësve të moshës 15 vjeçare me arritje të dobëta (low-achieving) dhe ajo të jetë më e ulët se 15% (objektivi evropian)?* E njëjta të jetë pjesë përbërëse e Strategjisë dhe Planit të veprimit.
- Fuqizimi i lidhjes midis arsimit dhe tregut të punës, përkatësisht të lidhjeve midis kompetencave të vendit të punës dhe rezultateve nga nxënia në programet mësimore. Prioritet duhet të jetë sigurimi i cilësisë në arsim duke i marrë parasysh tre nivelet kryesore të përcaktuara edhe në Kornizën referente evropiane për sigurimin e cilësisë (EQARF): Niveli i kualifikimeve për të cilat arsimohen nxënësit/studentët; Niveli i institucioneve/shkollave; Niveli nacional. Procesi tanimë ka filluar dhe mundësohet përmes dokumenteve si vijojnë: “Ligji për kornizën nacionale të kualifikimeve”, “Manual për zhvillimin e kualifikimeve të reja për Kornizën nacionale të kualifikimeve”, “Metodologjia për përpilimin e standardeve për profesione”. Megjithatë, nuk ka një sistem unik dhe të harmonizuar për monitorim dhe për pranimin e informacioneve për kompatibilitetin e arsimit me tregun e punës.<sup>24</sup> Nevojitet të detektohen dhe përcaktohen nevojat e mirëfillta të punëdhënësve për profesione dhe kualifikime adekuate të përcaktuara përmes aftësive, kompetencave, njohurive. Këto nevoja pastaj duhet të shndërrohen në rezultate të standardizuara (rezultate nga nxënia) në programet mësimore. Nevojitet azhurnim dhe përshejtim të këtij procesi me qasje sistematike, me ç’rast fillimisht do të sqarohen kompetencat institucionale, përcaktimi i qartë i revitalizimit të rolit të të gjitha palëve të interesuara, si dhe mënyra dhe niveli i komunikimit të tyre, liderizëm i fuqishëm nga një institucion dhe krijimi i strategjive me plan veprim. Përcaktimi i kritereve të

qarta dhe uniform për fitimin e kompetencave të cilat nxënësi gjatë procesit mësimor do t'i arrij pas kryerjes do të rezultojë edhe me fitimin e kualifikimeve përkatëse për profesione të caktuara. Që të arrihet kjo gjë, nevojitet të krijohen dhe avancohen mekanizma të cilët do të sigurojnë cilësi dhe relevancë të kualifikimeve.

### **Qasja e këtillë do të mundësoj:**

- Lidhje transparente të rezultateve nga nxënia të cilat arrihen në të gjitha institucionet arsimore të shtetit, si dhe krahasimi ndërkombëtar dhe njohja e tyre.
- Kjo qasje do të ketë nevojë për programe mësimore që të pasurohen me më shumë ushtrime praktike, si dhe me punë praktike dhe përdorim të teknikave know-how.
- Reduktimi i korrupsionit në arsim nga aspekti i objektivitetit gjatë notimit.

### **Që të arrihet një gjë e këtillë, nevojitet:**

- Të fuqizohet lidhja midis institucioneve arsimore dhe Këshillit për Arsim Profesional dhe Trajnim, bordeve për bashkëpunim dhe besim me komunitetin e biznesit (të cilët për momentin, edhe pse ekzistojnë për shkak të përcaktimit ligjor, nuk kanë ndonjë ndikim mbi programet mësimore dhe qëllimet strategjike të institucioneve arsimore dhe nuk ndikojnë mbi cilësinë në procesin e krijimit të profesioneve dhe kualifikimeve);
- Të rishikohen programet mësimore, veçanërisht në shkollat profesionale, me theks mbi rezultatet e nxënies dhe konform nevojave të tregut të punës;
- Të përfshihen fushata informative për luftimin e stereotipave negativë në shkollat e mesme profesionale për nxënësit, por veçanërisht për prindërit, përmes të cilëve do të informohen për mundësitë e punësimit;
- Të rishikohen tekstet shkollore;
- Të rritet niveli i trajnimit të mësimdhënësve dhe t'i përkushtohet më shumë kohë kapaciteteve të tyre pedagogjike, ndërsa të reduktohet vëllimi i obligimeve dhe detyrave administrative;
- Të përmirësohen kushtet në shkolla, veçanërisht ato të cilat bëjnë ushtrime dhe kanë zbatim praktik të njohurive të fituara, si dhe akses dhe siguri me mjete mësimore;
- Të rritet niveli i praktikës dhe mobilitetit. Nevojitet rirregullimi i praktikës, veçanërisht në arsimin e lartë. Krijimi i programeve me sistem dual të arsimit, veçanërisht në arsimin e mesëm profesional;
- Të rritet numri i nxënësve/studentëve për mobilitet ndërkombëtar për arsim dhe praktikë. Mobiliteti ndërkombëtar kryesisht i fokusuar mbi vendet evropiane do tu mundësoj të rinjve të fitojnë përvojë të çmueshme dhe të krijojnë pasqyrë më të qartë për kushtet në këto vende, e që në mënyrë plotësuese do të ndikoj edhe mbi vendimin e tyre për migrim;
- Të inkorporohen programe për monitorimin e nxënësve të talentuar;

- Uniformimi i mënyrave të notimit përmes matjes sistemore të kualitetit të rezultateve arsimore dhe krijim të kërkesave të qarta në nivel nacional për fitimin e kualifikimit adekuat arsimor;
- Përveç rregullimit të pagës më të ulët, nevojiten edhe subvencionime të pagave të të punësuarve të rinj në sektorin privat, duke i shtuar kushte të caktuara dhe/ose mundësi për firmat. Me fjalë të tjera, subvencionimi i rritjes së pagave të të rinjve të kushtëzohet paralelisht me hapjen e linjave për subvencionimin e firmave për ndihmë gjatë investimeve dhe investimit në teknologji të reja. Qasja e këtillë do të mundësoj përforsim të ekonomisë;
- Rritja e nivelit të punës vullnetare tek njerëzit e rinj, përmes fuqizimit të lidhje midis shkollave, OJQ-ve dhe pushtetit lokal. E njëjta duhet të vlerësohet dhe njihet në mënyrë që të shërbej si stimulim për punë më të madhe vullnetare tek të rinjtë;
- Avancimi i aksesit, cilësisë dhe kualitetit të arsimit joformal dhe informal, veçanërisht për të rinjtë. Pasurimi i ofertës me tema/fusha të cilat do tu ndihmojnë t'i avancojnë aftësitë për punësim dhe vetëpunësim dhe do ta reduktojnë përjashtimin social të të rinjve;
- Hapje të linjave financiare për të rinjtë për ngritjen e biznesit personal;
- Legjislacioni të jetë më i thjeshtë për zhvillimin e biznesit, më i qartë dhe i njëjtë për të gjithë (nulta tolerancë për korrupsion).



## 8

# POLITIKA DHE DEMOKRACIA

Hulumtimet në demokracitë perëndimore gjatë dekadave të fundit kanë regjistruar nivel të ulët të interesimit për politikë dhe angazhim politik të të rinjve, veçanërisht sa u përket mënyrave formale të participimit politik, siç është votimi në zgjedhje. Për shkak të zhgënjimit nga liderët politik/partitë politike, të rinjtë gjithnjë e më shumë fokusohen drejt formave tjera më pak konvencionale të participimit politik (Norris, 2003; Henn and Foard, 2012). Në demokracitë të pakonsoliduara të reja, angazhimi i qytetarëve në politikë, në përgjithësi është më i ulët, ndërsa vlerat autoritare janë më të përhapura, veçanërisht nëse vendet nuk kanë pasur përvojë paraprake me demokracinë (Howard, 2002; Sisenic, 2010; Novak and Hafner-Fink, 2015; Dolenjec, 2013). I këtillë është rasti edhe me popullatën rinore (Taleski et al., 2015). Besimi tek institucionet të cilat nuk e përmbushin atë që e presin qytetarët, por qëndrojnë keq sa u përket masave të ndryshme të cilësisë së demokracisë, siç është sundimi i së drejtës, liria e mediave, korrupsioni dhe ngjashëm, është i vogël. Qëllimi i kësaj pjese të studimit është t'i shqyrtoj këto aspekte përmes disa pyetjeve bateri. Rezultatet janë analizuar në nivel univariant, bivariant dhe pjesërisht në nivel multivariant, ndërsa janë prezantuar vetëm dallimet më të rëndësishme statistikore.


Gjatë analizës së rezultateve duhet të merret parasysh edhe konteksti politik, meqë Republika e Maqedonisë kaloi një periudhë të krizës intensive politike. Gjatë kohës së krizës (2015–2017), në të cilën u zbardhën skandalet për korrupsionin politik dhe ndikimin mbi mediat dhe pushtetin gjyqësor gjatë kohës së qeverisjes dhjetëvjeçare të Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE e qendrës së djathtë, studentët e rinj ishin faktori iniciues i protestave qytetare të cilët e stimuluan mobilizimin më të madh dhe qytetarinë më të gjerë. Periudha pas zhvillimit të zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare në dhjetor të vitit 2016 dhe zgjedhja e Qeverisë së re u shoqërua me nivel ekstrem të pasigurisë dhe me

krizë komplekse (kushtetuese). Në mënyrë plotësuese, mosbesimi ndaj partive/elitave politike është një sentiment i përhapur gjerësisht gjatë viteve të kaluara, kështu që të dhënat e studimit duhet të shqyrtohen edhe në këtë kontekst.

## INTERESIMI PËR POLITIKË

Në krahasim me “Studimin për të rinj” nga viti 2013, sipas të cilit interesimi për ngjarje politike në Republikën e Maqedonisë është rreth 50%, ndërsa interesimi për politikën ndërkombëtare dyfish më i ulët, interesimi për politikë tek të rinjtë në vitin 2018 ka shënuar rënie të konsiderueshme. Të rinjtë më së shumti interesohen për politikën vendase edhe atë pak më shumë për politikën në nivel lokal (22,8%), sesa politikën në nivel nacional (20,5%), pastaj është interesimi për politikën e BE-së (17,6%), dhe interesimi i përgjithshëm për politikë (16,8%). Më i ulët është interesimi për politikën në SHBA (12,9%) dhe për politikën në Rusi (8,4%).

FOTO NR. 61: **Interesimi për politikë** (% e përgjigjeve “i/e interesuar” dhe “shumë i/e interesuar”)



Rënia drastike e këtyllë e interesimit, para së gjithash për politikën vendore, është pasojë e mundshme e krizës së theksuar politike e cila edhe pse përfshiu një numër të konsiderueshëm të popullatës rinore (para së gjithash në kryeqytet), mbase ka shkaktuar zhgënjim dhe refuzim tek të rinjtë për shkak të kompleksitetit të problemeve të cilët nuk u zhdukën me marrëveshjen politike dhe me ndërrimin e pushtetit. Cinizmi politik ndaj të cilit veçanërisht janë të predispozuar të rinjtë (Bovan and Širinić, 2016), në Maqedoni potencialisht është në nivel të lartë.


Sipas analizës bivariate, të anketuarit e gjinisë mashkullore kanë interesim më të madh për politikë sesa të anketuarit e gjinisë femërore, ndërsa shkalla më e lartë e arsimit dhe mosha më e madhe, gjithashtu ndikojnë në drejtim pozitiv. Sipas përkatësisë etnike, interesim më të madh për politikën manifestojnë pjesëtarët e bashkësive më të vogla etnike, shqiptarët dhe në fund maqedonasit. Të ardhurat e familjes ndikojnë pozitivisht vetëm në interesimin për politikën lokale. Shkalla e arsimit e babait ndërlihet pozitivisht me interesimin për politikën në BE.

Të rinjtë, sa u përket ngjarjeve politike, më së shumti informohen nga Interneti (69,5%) dhe televizori (60%), pastaj vijojnë rrjetet sociale (37,8%), (Interneti e ka vendin udhëheqës para televizorit në krahasim me studimin e vitit 2013). Pastaj, vijojnë bisedat me familjen dhe miqtë. Të rinjtë janë më pak të informuar për ngjarjet politike nga mediat më tradicionale siç është shtypi ditor (14,7%) dhe radioja (10,10%), në të cilat temat politike trajtohen në mënyrë më të thuktë. Megjithatë, nuk kemi informacione të detajuara për cilësinë e informimit politik përmes secilës nga mediat e theksuara meqë, për shembull, shtypi i shkruar ka edicione të tyre në Internet.


Vërejtëm edhe rënie të diskutimeve në tema politike – vetëm 26,1% e të rinjve u përgjigjën se shpesh ose shumë shpesh bisedojnë për politikë në familje dhe me miqtë. Në Studimin "Tendencat rinore" madje 66% e të rinjve u përgjigjën se "ndonjëherë" ose "shpeshherë" bisedojnë për politikë me prindërit, ndërsa 74% me bashkëmoshatarët dhe miqtë (Cekiq 2014: 62). Kur bëhet fjalë për diskutime për tema politike, përveç variablave të lartpërmendura, të cilat ndikojnë në drejtim identik, është i rëndësishëm edhe arsimiti i prindërve. Kështu që, të rinjtë prindërit e të cilëve kanë nivel më të lartë të arsimit, bisedojnë më shpesh me ata për tema politike.

Të rinjtë – 47,2% i kanë zgjedhur vlerat më të larta të shkallës e cila e mat ngjashmërinë me bindjet politike të prindërve të tyre. Së këtejmi, 25,1% e kanë zgjedhur nivelin neutral të shkallës. Në vitin 2013, kjo përqindje ka qenë pak më e lartë. Dallime ka vetëm në rastin me të ardhurat familjare: të rinjtë të cilët vijnë nga familje me të ardhura më të larta manifestojnë ngjashmëri më të madhe me bindjet e prindërve të tyre.

Vetëm 20,9% e të rinjve mendojnë se interesat e tyre janë mirë ose shumë mirë të përfaqësuara në politikën nacionale, e që është e dhënë e ngjashme si edhe në studimin e vitit 2013. Të rinjtë nga bashkësitë më të vogla etnike dhe shqiptarët ndihen më mirë të përfaqësuar sesa maqedonasit. Kjo është pyetja e parë nga grupi i pyetjeve për të cilat, ashtu si edhe në studimin e vitit 2013 kemi regjistruar vlera më të mira tek grupet rinore të popullatës shumicë.


FOTO NR. 62: **Informimi për ngjarjet politike**

cë. Pastaj, të rinjtë e mjediseve urbane ndihen më mirë të përfaqësuar nga të rinjtë e mjediseve rurale, si dhe të rinjtë të cilët jetojnë në familje me të ardhura më të larta.

FOTO NR. 63: **Kënaqësia nga përfaqësimi i interesave të të rinjve në politikë**

## ANGAZHIMI POLITIK: VOTIMI NË ZGJEDHJE DHE USHTRIMI I FUNKSIONIT POLITIK

Përderisa interesimi për politikë dhe pjesëmarrja në mënyra formale të participimit politik midis të rinjve në vendet evropiane dhe në fqinjësi është relativisht i ulët ose shënon rënie (Hen and Foard, 2012, Kirbiš and Flere 2010), të rinjtë në Republikën e Maqedonisë me një përqindje jashtëzakonisht të lartë votojnë në zgjedhje. Në këtë hulumtim, 67% e të anketuarve kanë votuar në zgjedhjet e fundit, ndërsa vetëm 8,5% e tyre nuk kanë votuar, edhe pse e kanë pasur të drejtën e votës. Pjesa tjetër prej 24,5% nuk e kanë të drejtën e votës. Në të vërtetë, prej atyre që e kanë të drejtën e votës, 88,7% u përgjigjën se kanë votuar, ndërsa vetëm 11,3% u përgjigjën se nuk kanë votuar.



Të rinjtë – 83,6% u përgjigjën se nëse mbahen zgjedhje parlamentare dhe nëse e kanë të drejtën e votës, do të votonin, që është një përqindje më e lartë në krahasim me të gjitha vendet e përfshira me studimin. Kjo përqindje jashtëzakonisht e lartë, në masë të konsiderueshme e tejkalon interesimin për politikë dhe diskutimin në tema politike, ndërsa nga ana tjetër edhe pragun zyrtar të daljes në zgjedhje i cili zakonisht është rreth 60%. Duke e pasur parasysh se vetëm 20,9% e të rinjve janë të mendimit se interesat e tyre janë mirë ose shumë të mirë të përfaqësuara në politikë, befason fakti që ata, megjithatë, edhe në një numër kaq masiv, vendosin të dalin në zgjedhje. Një pjesë e shkaqeve për përqindjen kaq të lartë madje mund të gjenden në politizimin e skajshëm, ose thënë më saktë në “partizimin” e shoqërisë. Të rinjtë si dhe popullata në përgjithësi, tek partitë politike shohin garantues për punësim si dhe beneficione tjera, kështu që një pjesë e tyre, mesa duket, votojnë në zgjedhje në pritje për ndonjë përfitim të ardhshëm që ua kanë

premtuar aktivistët partiakë të cilët agjitojnë pikërisht në këtë mënyrë. Një numër i madh i skandaleve në publik tregojnë se kjo dukuri nuk ka të bëjë me rastet e izoluar, por është masive. Hulumtimet në lidhje me diskriminimin tregojnë se qytetarët e theksojnë përkatësinë partiake si baza e parë për diskriminim (Hristova dhe Cekiq, 2014; MCMS, 2011).

### A votoni në zgjedhje (parlamentare, presidenciale, lokale)? Cilat janë shkaqet që ju motivojnë të votoni në zgjedhje?

“Çdoherë votoj, çdoherë shpreson në ndryshime dhe çdoherë zhgënjehem.” (Ana, 23 vjeç)

“Po. Programi dhe projektet pozitive për zhvillimin e ardhshëm të shtetit, të ofruara nga ndonjë parti e caktuar.” (Ilina, 19 vjeç)

“Ndonjëherë votoj, ndonjëherë jo. Shkaku sado që të tingëllojë i dhimbshëm dhe mizerabël, më së shpeshti ka të bëjë me atë që ndonjëri nga prindërit e mi të mbetet në funksionin të cilin mbase edhe mund ta humbas nëse partia të cilës i takon – nuk fiton.” (Tara, 23 vjeç)

“Nuk votoj meqë realisht nuk ka ndonjë opion kështu që opioni më i mirë është të mos votoj. Opsionet që i kemi janë dy, ndërkaq të të dy kontrollohen nga “ekspertë” më të lartë nga Perëndimi kurse qëllimet e tyre mbështeten mbi manipulimin e masave popullore.” (Kate, 24 vjeç)

Po, votoj në zgjedhje. Më motivon ajo që shpresoj se vota ime ndoshta do të ndryshoj diçka.” (Simona, 19 vjeç)


“Po, shkoj të votoj dhe ajo që më motivon është se dëshiroj progres në vend, sa më shpejtë të kemi standarde të njëjta si ato të vendeve të BE.” (Filip, 27 vjeç)

“Po, çdoherë votoj. Mendimi i secilit është i rëndësishëm dhe duhet të merret parasysh.” (Petar, 21 vjeç)

Disa përgjigje në intervistat plotësuese me të rinjtë sugjerojnë atë se këto shkaqe janë valide, por edhe në atë se të rinjtë votojnë në mënyrë masive meqë dëshirojnë të ndryshojnë diçka.

Gatishmëria që të votohet në zgjedhje ndërlidhet me shkallën e arsimit – të rinjtë me arsim më të ulët rrallëherë votojnë në zgjedhje. Mosha më e lartë është prediktor i probabilitetit të votimit; me rritjen e të ardhurave familjare rritet edhe probabiliteti i votimit, megjithatë kulminacioni është tek shkalla e parafundit.

Në pyetjen a do të pranoni funksion politik, numri më i madh i të rinjve janë përgjigjur me ndoshta (36,4%), ndërsa 12% të tjerë janë përgjigjur se me kënaqësi do të pranoni një funksion të këtillë, e që janë përqindje relativisht të larta duke i pasur parasysh të dhënat paraprakisht të theksuara, mbase janë edhe shenjë se të rinjtë janë të përgatitur të ndryshojnë diçka. Megjithatë, 30% u përgjigjën se assesi nuk do të pranoni një funksion të këtillë, ndërsa 20% të tjerë u përgjigjën se sigurisht nuk do të pranoni një funksion të këtillë, kurse 1,3% e të rinjve u përgjigjën se tanimë ushtrojnë një funksion të këtillë.

FOTO NR. 65: **A do të pranoni funksion politik? (%)**

Të rinjtë e gjinisë mashkullore janë të përgatitur të ushtrorin funksione politike në krahasim me të rinjtë e gjinisë femërore, si dhe të rinjtë e bashkësive më të vogla etnike dhe sipas kësaj vijojnë: shqiptarët, pastaj maqedonasit. Është interesante se të anketuarit e rinj janë të gatshëm të pranojnë dhe të ushtrorin funksion politik.


Përqindja e të rinjve të cilët u përgjigjën se me kënaqësi do të ushtronin ose tanimë ushtrorin funksion politik është më e madhe tek kategoria "të rinj babai i të cilëve ka kryer arsim të lartë". Dallime ka edhe sipas të ardhurave të familjes, me ç'rast të rinjtë e familjeve me të ardhura më të larta janë më të gatshëm të pranojnë funksion politik sesa të rinjtë e familjeve me të ardhura më të ulëta. Këto të dhëna, si edhe në rastin e bisedave për politikë, e ilustron rëndësinë e origjinës sociale dhe mjedisit familjar për socializimin politik dhe pjesëmarrjen e të rinjve në politikë.

## BESIMI NË INSTITUCIONE DHE KËNAQËSIA NGA ZHVILLIMI DEMOKRATIK

Besimi në institucionet e vendit është në nivel të ulët, si në publikun e përgjithshëm ashtu edhe mesin e të rinjve. Sipas hulumtimeve në dy dekadat e fundit, qytetarët më shumë u besojnë institucioneve ndërkombëtare (ose institucioneve të tjera, siç janë bankat dhe institucionet religjioze), sesa institucioneve politike vendore (Taleski etj. 2006: 14–15, Markoviq etj. 2011: 15, Topuzovska Latkoviç etj., 2013).

Në këtë hulumtim, të rinjtë në përgjithësi pak u besojnë institucioneve të ofruara, meqë vlerat mesatare të përgjigjeve lëvizin

nën nivelin neutral të shkallës. Të dhënat tregojnë se të rinjtë më së shumti i besojnë armatës dhe institucioneve religjioze, por për herë të parë edhe lëvizjeve vullnetare, mesa duket për shkak të rëndësisë së protestave gjatë krizës politike të kohëmëparshme. Pastaj vijonë Bashkimi Evropian, bankat, dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, e që flet për një zhvendosje në krahasim me hulumtimet paraprake. Organizatat qytetare, kësaj radhe, kanë besim pak më të madh, ndërsa besimi më i ulët përsëri është tek institucionet vendore (President, Parlament, Qeveri, Gjyqësor) dhe tek partitë politike.

FOTO NR. 66: **Besimi në institucione**

Ekzistojnë dallime të rëndësishme statistikore varësisht nga gjinia e të anketuarave. Të anketuarit e gjinisë mashkullore kanë besim më të madh nga të anketuarit e gjinisë femërore në institucionet/faktorët politikë vendor (Presidenti, Qeveria, Partitë politike, Pushteti lokal, Sindikatat), si dhe NATO dhe FMN. Të anketuarit e gjinisë femërore besim më të madh kanë vetëm tek bankat. Sa i përket përkatësisë etnike në të gjitha institucionet përveç BE-së të cilit më së shumti i besojnë shqiptarët, besim më të madh kanë të rinjtë e bashkësive më të vogla etnike. Nga ana tjetër, maqedonasit besim më të madh kanë tek Presidenti në krahasim me bashkësitë më të vogla etnike dhe veçanërisht me shqiptarët.

Në shkallën prej 1 deri në 5, me ç'rast 1 është shumë i pakënaqur, ndërsa 5 shumë i kënaqur, kënaqësia e të rinjve nga gjendja e demokracisë në Maqedoni është 2,54, e që është rënie në krahasim me studimin paraprak kur nota ishte 2,74. Pasqyruar në përqin-



FOTO NR. 67: Pozicionimi ideologjik: majtasqendër-djathtast



FOTO NR. 68: Pozicionimi ideologjik majtasqendër-djathtas (2018)





FOTO NR. 69: Pozicionimi ideologjik majtasqendër-djathtas (2013)



dje vetëm 20,1 % e të rinjve janë të kënaqur ose shumë të kënaqur nga gjendja me demokracinë.

Dallimet, sipas përkatësisë etnike të të anketuarve, ngjashëm si edhe në studimin e vitit 2013 (kur shqiptarët ishin më të kënaqur sesa maqedonasit), tregojnë se atipike, popullata shumicë është më e pakënaqur nga gjendja e demokracisë në Maqedoni. Megjithatë, duke e pasur parasysh kontekstin politik në të cilin konfrontimi politik kryesisht zhvillohej në bllokun etnik maqedonas, në këtë rast kjo nuk është e dhënë edhe aq befasuese. Të rinjtë nga bashkësitë më të vogla etnike, në të vërtetë janë më të kënaqurit edhe në pjesën pozitive të shkallës (M=3,20), pas tyre vijnë shqiptarët vlera e të cilëve është në pjesën negative të shkallës (M=2,60), dhe është pak më e lartë prej asaj të maqedonase (M=2,42). Me moshë sa më të madhe dhe arsim sa më të lartë, kënaqësia nga gjendja e demokracisë në Maqedoni shënon rënie.

## ORIENTIME IDEOLOGJIKE

Duke kaluar nga interesimi për politikë dhe votimi në zgjedhje në forma tjera të njohurive politike dhe participimit, në këtë hulumtim i analizuam edhe orientimet ideologjike të të rinjve. Fillimisht, duhet të theksohet se niveli i njohjes së ideologjive politike në mesin e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë është i ulët (Hristova 2011). Sipas Studimit për të rinj 2013, kjo përqindje edhe tek

të rinjtë është e lartë, përkatësisht 38 % e të rinjve nuk kanë njohuri/nuk janë pozicionuar ideologjikisht në shkallën prej majtas në djathtas (Topuzovska Latkoviq etj. 2013: 105). Në Studimin aktual, thuaja se 50 % e të rinjve u përgjigjën “nuk e di” ose nuk kanë dashur të përgjigjen në këtë pyetje (22,9 % u përgjigjën me “nuk e di”, ndërsa 26,6 % nuk kanë përgjigje).

Nga përgjigjet e fituara, në shkallën prej 1 deri në 10, nga ekstremisht majtas deri në ekstremisht djathtas, vlera mesatare e të gjithë të anketuarve të cilët u prononcuan është rreth qendrës në lartësi prej M=5,16. Kur përgjigjet grupohen në tri kategori 1–4 majtas, 5 dhe 6 qendër, dhe 7–10 djathtas, për të majtën u prononcuan 37,4 %, për qendrën 34,5 %, ndërsa për të djathtën 28,1 %. Këto janë ndryshime të konsiderueshme në krahasim me vitin 2013 kur për të majtën u prononcuan 23,1 %, për qendrën – 37,6 %, ndërsa për të djathtën – 39,2 %.

Meqë nuk kemi të dhëna shtesë, atëherë është vështirë është të interpretohen këto rirreshtime, megjithatë, njëri nga shkaqet ndoshta është tendenca që votuesit t'i bashkëngjiten garniturës momentale në pushtet. Ndërsa partitë shqiptare dhe partitë e tjera minoritare është më vështirë të përcaktohen ideologjikisht, në bllokun maqedonas, edhe pse jo çdoherë në mënyrë konsistente, veçanërisht në lidhje me politikën ekonomike-sociale, e majta dhe e djathta kanë reprezentë të tyre stabil tek LSDM dhe VMRO-DPMNE, parti të cilat i udhëheqin koalicionet e gjera qeveritare. Ndërmjet dy studimeve ndodhi transferimi i pushtetit nga e djathta tek e majta.

Pozicionimi ideologjik ndërlidhet me disa elemente të statusit ekonomik-social të të anketuarve. Kështu që, me rritjen e të ardhurave familjare, konform literaturës, të rinjtë janë të orientuar më shumë kah e djathta, edhe pse dallimet nga aspekti statistikor janë të rëndësishme në nivelin 0,05, ndërsa korrelacioni nuk është edhe aq i fuqishëm ( $r=0.094$ ). Po ashtu, konform literaturës, të rinjtë, babai i të cilëve ka shkallë më të lartë të arsimit, më shumë i bashkëngjiten të majtës ( $r=-0.108$ ;  $p<0.05$ ) (arsimi i nënës nuk ka ndikim).

Duke e pasur parasysh faktin se, votimi në Maqedoni me përjashtime të vogla zhvillohet në linja etnike, në vazhdim ua prezantojmë të dhënat sipas përkatësisë etnike. Për të majtën në numër të madh u përcaktuan të rinjtë e bashkësive më të vogla etnike, ndërsa pas tyre vijne maqedonasit tek të cilët shpërndarja midis të majtës, të djathtës dhe qendrës është më e balancuar. Shqiptarët në numër më të madh pozicionohen në qendër dhe pastaj majtas ose djathtas. Ky është ndryshimi më drastik nga viti 2013, kur madje 50% e shqiptarëve u pozicionuan djathtas. E djathta akoma e ka mbështetjen më të madhe tek maqedonasit. Tek të tri kategoritë etnike ka lëvizje drejt qendrës/majtas në krahasim me vitin 2013, por kjo është më e shprehur tek bashkësitë më të vogla etnike dhe tek shqiptarët.

Me serinë e ardhshme të pyetjeve patëm mundësi ta përcaktojmë në detaje orientimin e deklaruar politik përmes analizës së përcaktimit ideologjik majtas-djathtas në dimensionin ekonomik – social, si dhe në dimensionin liberalizëm – konservativizëm përmes analizës së qëndrimeve për arsyetimin e abortit dhe homoseksualitetit.

Duhet të theksohet se kur bëhet fjalë për partitë më të mëdha politike në Republikën e Maqedonisë dhe për votuesit e tyre lojal, përveç përkatësisë etnike ata nuk kanë përcaktim të qartë social dhe veçanërisht klasor (Dragoviq, 2011). Të njëjtit ndajnë qëndrime të majta/socialiste në dimensionin ekonomik – social, ndërsa dallimet në dimensionin liberal – konservativ para së gjithash kanë të bëjnë me marrëdhënien ndaj të kaluarës komuniste (Hristova, 2011). Të dhënat e këtij studimi konfirmojnë qëndrime të ngjashme edhe tek të rinjtë, por me disa përjashtime të rëndësishme.

Të rinjtë manifestojnë qëndrime majtiste, përkatësisht në masë të madhe pajtohen se shteti duhet të ketë përgjegjësi më të madhe që të na sigurojë të gjithëve (madje  $M=4,41$  në shkallën prej 1 deri në 5), të ardhurat e të pasurve dhe të varfërve duhet të jenë më të balancuara ( $M=4,07$ ) dhe se duhet të rritet pronësia shtetërore e ndërmarrjeve ( $M=3,93$ ). Pastaj, të rinjtë, në masë të madhe

nuk pajtohen me pohimin se konkurrenca është e dëmshme ( $M=2,85$ ) dhe mendojnë se në një afat të gjatë puna e lodhshme zakonisht sjell jetë më të mirë ( $M=3,87$ ), e që tregon se janë të përgatitur të ndërmarrin iniciativa dhe përgjegjësi, pa u mbështetur plotësisht në intervenimin shtetëror. Kjo sugjeron se pritshtëri të nga shteti nuk kanë të bëjnë me pasivitetin personal, por bëhet fjalë për qëndrim autentik ideologjik.

Analiza bivariale tregoi se të anketuarit e gjinisë femërore kanë qëndrime më majtiste në krahasim me të anketuarit e gjinisë mashkullore, si dhe të rinjtë e mjedisëve urbane dhe të anketuarit më të rinj. Maqedonasit kanë orientim më majtist sesa shqiptarët dhe bashkësitë më të vogla etnike. Të rinjtë me arsim të mesëm ndajnë vlera më majtiste, ndërsa arsimi i babait është po ashtu i rëndësishëm, dhe sa më i ulët që të jetë ai, të rinjtë aq më shumë janë të orientuar kah e majta. Megjithatë, këto dallime janë relativisht të vogla, duke e marrë parasysh distribuimin e përgjithshëm. Nga ana tjetër, të ardhurat janë njëra nga variablat e rralla e cila nuk ka rëndësi. Kur u bë korrelacioni midis pozicionimit në shkallë majtas-qendër-djathtas dhe pajtimi me tre pohimet e para (për të cilat  $\alpha=0.65$ ), u fitua korrelacion i rëndësishëm statistikor por negativ – ata që janë deklaruar si djathtistë, në masë të madhe, manifestojnë qëndrime majtiste në shkallën ekonomike -sociale.

Në pyetësorin u parashtruan pyetje për atë se sa të rinjtë e arsyetojnë abortin dhe homoseksualitetin, në shkallë nga 1 deri në 10. Vlerat e fituara mesatare flasin për mjedis jashtëzakonisht konservativ meqë janë vendosur thellë në pjesën negative të shkallës dhe janë  $M=3,69$  për abortin dhe për  $M=2,89$  homoseksualitetin.

Është interesante se janë gjetur dallime të rëndësishme statistikore sipas gjinisë së të anketuarve vetëm në rastin e homoseksualitetit, të ngjashme me të dhënat e studimeve paraprake (në të cilin nuk ishte parashtruar pyetja për abortin), si më të arsyeshëm e konsiderojnë të anketuarit e gjinisë femërore ( $M=3,29$ ) përkundrejt të anketuarve të gjinisë mashkullore ( $M=2,47$ ). Pastaj, pjesëtarët e bashkësive më të vogla etnike janë më liberal edhe sa i përket abortit ( $M=4,72$ ) dhe homoseksualitetit ( $M=3,44$ ) nga maqedonasit ( $M=3,92$  për abortin dhe  $M=3,15$  për homoseksualitetin), dhe veçanërisht nga shqiptarët ( $M=2,53$  për abortin dhe  $M=1,75$  për homoseksualitetin), të cilët janë jashtëzakonisht konservativ për këto çështje.

Të ardhurat familjare janë në korrelacion pozitiv me qëndrimet pozitive për abortin, si dhe arsimi i të dy prindërve. Arsimi i të anketuarve ndërlidhet vetëm me qëndrimet për homoseksualitetin, të cilin më së paku e arsyetojnë ata me arsim të mesëm, ndërsa

FOTO NR. 70: **Pozicione ideologjike** Shkalla 1–5 (1 – plotësisht nuk dakordohem, 5 – plotësisht dakordohem)





FOTO NR. 71: **Vlerat demokratike dhe autoritare**

kategoritë e të anketuarve me arsim më të ulët dhe më të lartë janë më afër me qëndrimet e tyre. Pritshëm, aspekti religjioz i të anketuarve gjithashtu është negativ dhe lartë në korrelacion me qëndrimet e dimensionit liberalizëm – konservativizëm në drejtimin e pritshëm.

Korrelacioni i vlerave në boshtin prej majtas në djathtas me miratimin e abortit dhe homoseksualitetit, statistiki është i rëndësishëm dhe tregon se ata që janë të pozicionuar majtas në shkallë, më shumë e pranojnë abortin ( $r=0.144$ ;  $p<0,01$ ) dhe homoseksualitetin ( $r=0.158$ ;  $p<0,01$ ), e që flet se këtu ekziston konsistencë e qëndrimeve me vet-pozicionimin ideologjik dhe se ky dimension, për dallim nga e kaluara, ka potencial më të madh, ndërsa duke e pasur parasysh zhvillimin politik në 10 vitet e fundit pikërisht në lidhje me këto çështje, tanimë shërben si profilim ideologjik për partitë.

## VLERAT DEMOKRATIKE DHE AUTORITARE

Pranimi i vlerave demokratike, nga ana e publikut të gjerë, është njëra nga shtyllat më të rëndësishme të demokracisë. Në studimet komparative vlerat demokratike dhe autoritarizmi janë fenomenet më shpesh të hulumtuara, ndërkaq kanë qenë objekt hulumtimi edhe tek ne. Të dhënat nga vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar e deri më sot vënë në dukje përhapjen e konsiderueshme të vlerave autoritare, por edhe pranimin e përgjithshëm të demokracisë (Simoska etj., 2001; Hristova 2011, Simoska etj., 2010; Marković etj.; Maričić dhe Petkovski 2014).


Në këtë hulumtim, vlerat demokratike dhe autoritare i analizojmë përmes gjashtë pyetjeve. Edhe disa pyetje kanë të bëjnë me rolin e të rinjve në politikë, si dhe me votimin si obligim. Pyetja e fundit e mat njohurinë politike të të rinjve, por bazohet në vet-perceptimin e tyre.

Nga të dhënat e fituara mund të shihet se, ngjashëm me hulumtimet e popullatës së përgjithshme, të rinjtë, deri diku, manifestojnë qëndrime ambivalente. Nga njëra anë 63,5% pajtohen

se “në përgjithësi demokracia është formë e mirë e qeverisjes” dhe nga ana tjetër “opozita politike është e shëndetshme për demokracinë” (59,4%), ndërsa një përqindje e madhe e tyre pajtohen me pohimet se “duhet të kemi lider i cili do ta udhëheq Maqedoninë me dorë të fortë në interes të së mirës publike” (71,3%), si dhe “parti e fuqishme e cila do ta përfaqësoj popullin e thjeshtë, në përgjithësi është ajo që na nevojitet për momentin në Maqedoni” (68,5%), e që janë tregues tipik të autoritarizmit dhe kohëve të fundit të populizmit. Në rastin me liderin, Maqedonia ka përqindje të konsiderueshme më të lartë të dakordësitimit nga mesatarja e bazës kros-nacionale (59,5%). Intervistat plotësuese sugjerojnë se të rinjtë e pranojnë këtë pohim më së shpeshti për shkak të pakënaqësisë nga gjendja në të cilën është vendi.

Vetëm 12,5% e të rinjve janë të mendimit se disa konflikte mund të zgjidhen me dhunë. 70% e të rinjve janë të mendimit se votimi në të vërtetë është obligim qytetar. Sa u përket pyetjeve për të rinjtë dhe politikën, 61% e të rinjve janë të mendimit se politikanët nuk kujdesen për mendimet e tyre, ndërsa 73% janë të mendimit se duhet të kenë më shumë mundësi që ta ngrënë zërin e tyre në politikë. Vetëm 18% e të rinjve u përgjigjën se kanë njohuri të mëdha për politikë.


Edhe tek këto pyetje ekzistojnë dallime sipas gjinisë vetëm tek pohimi i parafundit i cili ka të bëjë me kujdesin e politikanëve për të rinjtë:  $M=1,63$  tek të anketuarit e gjinisë femërore,  $M=1,83$  tek të anketuarit e gjinisë mashkullore, në shkallën 1–5, ku 1 është “fare nuk dakordohem”, ndërsa 5 – “shumë dakordohem”. Të rinjtë nga mjediset rurale më pak dakordohen me pohimin që ka të bëjë me diktaturën ( $M=2,05$ ) sesa të rinjtë e mjedisve urbane ( $M=2,20$ ). Zgjidhja e konflikteve me dhunë është po ashtu më pak e pranueshme për të rinjtë e mjedisve rurale ( $M=1,62$ ) në krahasim me të rinjtë e mjedisve urbane ( $M=1,76$ ). Grupmosha mesatare dhe grupmosha më e re më shumë e arsyetojnë diktaturën në rrethana të caktuara; tek qëndrimet votim – dakordësimi rritet me moshën, ndërsa në lidhje me rëndësinë e opozitës dhe zgjidhjen e konflikteve me dhunë situata është e kundërt – më të moshuarit më pak pajtohen me këto pohime.

**FOTO NR. 72: Qëndrimet e vlerave demokratike dhe autoritare sipas përkatësisë etnike**

Sipas përkatësisë etnike, maqedonasit më së shumti pajtohen me pohimin se demokracia është formë e mirë e qeverisjes, më pak i arsyetojnë regjimet diktatoriale dhe përdorimin e dhunës, por në masë më të madhe janë të mendimit se me shtetin duhet të drejtoj një parti e fuqishme, si dhe një lider me dorë të fortë. Bashkësitë më të vogla etnike janë afër maqedonasve sa u përket indikatorëve pro-demokratikë dhe rëndësisë të një lideri dhe një partie, megjithatë janë listuar lartë si më jodemokratë të cilët e arsyetojnë diktaturën dhe dhunën. Shqiptarët janë gjithmonë diku në mesin e këtyre vlerave.

Dallimet, sipas shkallës së arsimit, janë kontradiktore meqë të rinjtë me arsim të lartë pak më pak e mbështesin demokracinë, ndërsa diktaturën e mbështesin më shumë ata me arsim të ulët,

por njëkohësisht janë të mendimit se nevojitet opozita, si dhe se kanë më shumë njohuri politike. Megjithatë, duhet të kihet parasysh se disa nga të anketuarit janë akoma në proces arsimimi.


**FOTO NR. 73: Vlera demokratike dhe autoritare sipas shkallës së arsimit**

Arsimi i lartë i nënës ka të bëjë me rëndësinë e opozitës në kuptimin pozitiv, por edhe me arsyetimin e diktaturës përsëri në kuptimin e njëjtë, dhe pranimi i demokracisë në drejtim të kundërt. Arsimi i babait është i rëndësishëm për ta kuptuar votimin si obligim dhe ka lidhje proporcionalisht të kundërt, si dhe arsyetimi i diktaturës në rrethana të caktuara, me çka më së shumti pajtohen fëmijët babai i të cilëve ka arsim të lartë.

Të ardhurat familjare të të anketuarve janë po ashtu të rëndësishme, me ç'rast ata me të ardhura më të larta më së shumti e pranojnë demokracinë si model i qeverisjes ( $p=0.237$ ;  $P<0.01$ ) dhe më së shumti e arsyetojnë diktaturën ( $r=-0.122$ ;  $p<0.01$ ), më së shumti e pranojnë opozitën politike ( $r=0.072$   $p<0.05$ ) dhe më pak e arsyetojnë zgjidhjen e konflikteve me dhunë  $r=-0.151$ ;  $p<0.01$ , por njëkohësisht më shumë angazhohen për lider të fortë ( $r=0.118$ ,  $p<0.01$ ).

Kur grupohen pohimet për autoritarizëm/demokraci shkalla nuk ka reliabilitet të lartë.

FOTO NR. 74: Të drejta grupore



### A pajtoheni me pohimin se na nevojitet lider i cili do ta drejtoj shtetin me dorë të fortë në interes të së mirës publike: Shpjegoni.

“Është më se e qartë se nëse lejohet secili të bëjë atë që do atëherë nuk do të kemi sukses. Prandaj, sipas mendimit tim, na nevojitet lider i cili nuk do ta drejtoj shtetin me diktaturë, por me arsye dhe me punë saktësisht të vendosura të cilat janë për të mirën e përgjithshme.” (Teon, 18 vjeç)

“Jo. Mendoj se na duhet transformim i plotë i shoqërisë, kulturës, vlerave...” (Ana, 23 vjeç)

“Po, duhet të kemi. Na duhet një lider i cili do të angazhohet më shumë për popullin, dhe jo për atë se si të pasurohet ai vet.” (Tara, 23 vjeç)

“Absolutisht pajtohem. E mira publike është e mirë për të gjithë. Është koha për ndryshime në të gjitha fushat, dhe njëkohësisht përmirësimi i jetës së njerëzve, meqë realisht si shtet mundemi shumë, ndërsa shumë pak kemi arritur. Prandaj na duhet lider i cili do të na çoj përpara.” (Aleksandra, 27 vjeç)

“Pajtohem me pohimin e theksuar, meqë për shkak të gjendjes momentale në vendin tonë ka nevojë për një lider të këtitillë. Lider i cili për dallim nga partia lider, opozita dhe partia politike e cila e përfaqëson minoritetin në numër më të madh, të cilët bashkërisht nuk mund të arrijnë kompromis dhe ta nxjerrin Maqedoninë nga stagnimi, me një dorë të fortë do të mund të zgjidh një pjesë të problemeve me të cilat është ballafaquar Maqedonia. Pastaj, kur do të stabilizohet situata në shtet, mendoj se duhet të gjendet kompromis për çështjet kryesore të cilat do ta promovonin të njëjtin në shtetun e njëjtë.” (Bojan, 25 vjeç)


“Po. Megjithatë besoj se është vështirë të përkufizohet e mira publike. E mirë publike është të përmirësohen kushtet e përgjithshme për jetë dhe të rritet standardi (...), megjithatë ekzistojnë “të mira publike” të ndryshme të cilat vështirë se mund të përgjithësohen në sytë e gjithë popullit.” (Dritan, 17 vjeç)

## TË DREJTA GRUPORE

Të dhënat që kanë të bëjnë me qëndrimet e të rinjve sa u përket të drejtave të grupeve të caktuara në shoqëri, i konfirmuan të dhënat e studimeve paraprake se të rinjtë nuk janë mjaftueshëm të tolerantë. Kjo, veçanërisht ka të bëjë me personat LGBT, me gratë, dhe me pakicat etnike. Për këto tri kategori, përqindja e përgjigjeve se kanë mjaftueshëm/shumë të drejta është më e lartë, ndërsa në të vërtetë të dhënat objektive tregojnë se pikërisht ato janë në mesin e kategorive më të rrezikuara të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë të cilët ballafaqohen me diskriminim (veçanërisht personat LGBT). Të rinjtë stimulojnë më shumë të drejta për personat me aftësi të kufizuara dhe për të varfëritë dhe pas kësaj vijon mbështetja për më shumë të drejta për të rinjtë dhe fëmijët.


Grupimi sipas karakteristikave socio-demografike tregoi se ka dallime në lidhje me qëndrimet për atë se kategoritë e theksuara të qytetarëve a kanë mjaftueshëm të drejta. Disa nga të dhënat më interesante kanë të bëjnë me perceptimin e përfaqësuesve të grupeve të cilat potencialisht janë më të rrezikuara. Në këtë situatë, të dhënat në dispozicion e mundësojnë konfirmimin e këtij pohimi për gratë dhe pakicat etnike. Kështu që, në pajtim me pritshmëritë, të anketuarit e gjinisë femërore, në një përqindje më të lartë, janë të mendimit se nuk kanë të drejta të mjaftueshme (48,1%) në krahasim me të anketuarit e gjinisë mashkullore, prej të cilëve 27,9% u përgjigjën se gratë nuk kanë të drejta të mjaftueshme. Sa i përket përkatësisë etnike, maqedonasit më shumë janë të mendimit se gratë nuk kanë të drejta të mjaftueshme (40,3%) në krahasim me shqiptarët (35,8%) dhe me bashkësitë më të vogla etnike (28,9%).

FOTO NR. 75: **Të drejtat e grave**  
nuk kanë mjaftueshëm të drejta (%)



Sa u përket të drejtave të personave LGBTI, përsëri të anketuarit e gjinisë femërore (39,6% janë të mendimit se këta persona nuk kanë të drejta të mjaftueshme) maqedonasit (36,2%), përkatësisht kanë qëndrime më liberale lidhur me këtë çështje në krahasim me të anketuarit e gjinisë mashkullore (28,4%), shqiptarët (27,7%) dhe bashkësitë e tjera etnike (28,1%).

FOTO NR. 76: **Të drejtat e personave LGBTI**  
nuk kanë mjaftueshëm të drejta (%)



Kur bëhet fjalë për të drejtat e pakicave, shqiptarët si përfaqësues të pakicës më të madhe në Maqedoni, me një përqindje të lartë

FOTO NR. 77: **Të drejtat e pakicave** nuk kanë mjaftueshëm të drejta (%)





FOTO NR. 78: **Ajtema të selektuara të shkallës – F**




(52,9%) janë të mendimit se pakicat nuk kanë të drejta të mjaftueshme, pastaj vijojnë bashkësitë më të vogla etnike (35,2%) dhe maqedonasit (29,5%).

## SHKALLA F DHE SHKALLA E NACIONALIZMIT

Në pyetësor ishte prezantuar shkalla – F e modifikuar ajtematike – 4 (Lane, 1955), si dhe ajtema nga shkalla për nacionalizëm (të ri) (Columbus, 2006). Ajtemat e shkallës për fashizëm (pyetjet e parashtruara dhe pyetja për lider të fortë në pjesën e vlerave autoritare) janë të natyrës së përgjithshme/psikologjike, ndërsa pyetjet e tjera ndërlidhen me kontekstin nacional dhe me kuptimin të jesh maqedonas.

Analiza e përgjithshme e këtyre të dhënave vë në dukje se të rinjtë kanë vlera të larta dhe shqetësuese për ajtemat në shkallën e fashizmit (Foto 81). Dy prej tyre anojnë në shkallën e katërt nga shkalla me 5 nivele, ku 1 është “fare nuk pajtohem”, ndërsa 5-“plotësisht pajtohem” me pohimet e theksuara. Vlera mesatare e të rinjve nga të gjitha vendet e përfshira në hulumtimin e këtyre ajtemave është më e ulët nga ai maqedonas në rastin me pohimin e vullnetit për progres (M=3.60) dhe pohimin që ka të bëjë me cenimin e nderit (M=3,46), por më e lartë kur bëhet fjalë për nevojën për disiplinë të rreptë për të rinjtë (M=3,39).

Kur bëhet fjalë për nacionalizmin, vlerat mesatare janë nën vlerat neutrale të shkallës, përveç pohimit se jo-maqedonasit duhet t’i pranojnë zakonet dhe vlerat e maqedonasve (M=3,08). Megjithatë, këto të dhëna deri diku janë shtrembëruar për shkak të rëndësisë së identiteteve etnike të cilët akoma nuk i kanë lënë vend të konsiderueshëm identitetit i cili ndërlidhet me shtetësinë. Këtë do ta shqyrtojmë në vijim, meqë në kushte të këtilla pohimi për nacionalizëm fillimisht ka të bëjë me maqedonasit si grup etnik.


FOTO NR. 79: **Ajtema të selektuara në shkallën e nacionalizmit**

Të shumta janë dallimet e vlerave në shkallën e nacionalizmit ( $M=8,06$ ;  $\min=3$ ,  $\max=15$ ) në krahasim me shkallën e fashizmit ( $M=15,03$ ;  $\min=4$ ,  $\max=20$ ) kur të anketuarit grupohen sipas karakteristikave të tyre. Përsëri nuk ka dallime midis gjinive në lidhje me vlerat në të dyja shkallët. Nuk ka dallime edhe sipas asaj nëse të rinjtë jetojnë në mjedise urbane apo rurale. Vlerë më të lartë të sublimuar në shkallën F kanë maqedonasit ( $M=15,31$ ), pastaj bashkësitë më të vogla etnike (14,94) dhe shqiptarët ( $M=14,23$ ), edhe pse dallimet nuk janë të mëdha. Në përputhje me pritshmëritë, maqedonasit manifestojnë nacionalizëm më të lartë ( $M=9,3$ ), ndërsa pas tyre vijojnë bashkësitë më të vogla etnike ( $M=6,83$ ) dhe shqiptarët ( $M=5,89$ ).

Mosha e të anketuarve është e rëndësishme për nacionalizmin, edhe atë vlerë më të lartë ka grupmosha 20–24 vjeç ( $M=8,8$ ), pastaj të rinjtë prej 14–19 vjeç ( $M=8,62$ ), ndërsa grupmosha e të anketuarve (25–29 vjeç) kanë vlerë më të ulët ( $M=7,67$ ).

Të rinjtë me arsim të lartë kanë vlerë më të ulët në shkallën e nacionalizmit. Nacionalizmi rritet konform nivelit arsimor të nënës. Të ardhurat e familjeve të të anketuarve kanë rëndësi për vlerat e arritura në të dyja shkallët, përkatësisht të rinjtë me të ardhura më të larta kanë vlera më të larta në të dyja shkallës (Shkalla – F  $r=0,094$ ;  $P<0,01$ ; shkalla-N:  $r=0,105$ ;  $p<0,01$ ).

Identifikimi me të majtën, të djathtë ose qendrën, dhe me aspektin religjioz të të anketuarve, po ashtu ka rëndësi për vlerat e dy shkallëve. Pjesëtarët e të djathtës kanë vlera më të larta në shkallën –F, si dhe ata që janë më religjioz, ndërsa pjesëtarët e të majtës manifestojnë nacionalizëm më të madh. Ata që janë më religjioz kanë vlerë më të ulët në shkallën e nacionalizmit (këto mesa duket janë shqiptarët etnikë të cilët janë kategoria më religjioze).

FOTO NR. 80: **Vlerat e shkallës F dhe N sipas përcaktimeve ideologjike**

Megjithatë, duhet të theksohet se shkalla – F ka reliabilitet të ulët ( $\alpha=0,49$ ) e që e vë në pikëpyetje përdorimin e saj gjatë përpunimeve më komplekse. Shkalla e nacionalizmit ka reliabilitet të lartë ( $\alpha=0,81$ ), por gjithashtu është problematike për përdorim për shkaqet e lartpërmendura.

## PARTICIPIMI POLITIK NË AKTIVITETE JOFORMALE



Siç theksuam paraprakisht, pjesëmarrja në aktivitete politike ose në aktivitete shoqërore të cilat nuk kanë të bëjnë (vetëm) me votimin është diçka që i jep cilësi të rëndësishme potencialit participativ të qytetarëve, veçanërisht të rinjve (Van Deth, 2014, Morales, 2009). Grupi i radhës i pyetjeve e analizon potencialin participativ të të rinjve në Republikën e Maqedonisë.

Ngjashëm si në të dhënat paraprake (Cekiq, 2014), rreth 40% e të rinjve kanë qëndrim pozitiv ndaj participimit politik kur bëhet fjalë për nënshkrimin e peticioneve, pjesëmarrjen në protesta dhe pjesëmarrjen në aktivitete të organizatave vullnetare ose qytetare. Një pjesë e madhe e të rinjve, të cilët kanë qëndrime pozitive, këtë tanimë e kanë bërë. Një numër shtesë i të rinjve prej 30% kanë marrë pjesë ose do të merrnin pjesë në aktivitete politike onlajn ose në rrjetet sociale. 24,7% nuk do të blinin më produkte të caktuara për shkaqe politike ose ekologjike. Edhe pse një përqindje më e vogël e tyre, 26% do të merrnin pjesë edhe në aktivitete të partisë ose grupit politik.

Meqë aktiviteti në parti politike është tjetër lloj i aktivitetit, sa i përket participimit më të gjerë politik, të gjitha pyetjet (përveç kësaj) u grupuan në një variabël të cilën e emërtuam "participim politik" ( $M=7,39$ ;  $\min=5$ ,  $\max=15$ ). Shkalla ka reliabilitet të lartë ( $\alpha=0,86$ ).

Të anketuarit e gjinisë mashkullore kanë vlera më të larta në këtë shkallë ( $M=7,84$ ) nga të anketuarit e gjinisë femërore ( $M=6,91$ ), përkatësisht më shumë marrin pjesë në të gjitha aktivitetet e theksuara, dhe nuk ka dallim në lidhje me llojet e aktiviteteve në të cilat involvohen, siç sugjeron një pjesë bukur e mirë e literaturës (Portney *et al.*, 2009). Participimi politik rritet me moshën e të anketuarve ( $r=0,12$ ;  $p<0,01$ ). Pastaj, maqedonasit kanë vlerë më të ulët ( $M=7,03$ ), pas tyre vijojnë shqiptarët ( $M=8,24$ ), pastaj bashkësitë më të vogla etnike ( $M=8,53$ ).

Shkalla e arsimit është po ashtu e rëndësishme, me ç'rast mund të themi se niveli më i lartë i arsimit e stimulon participimin politik të të rinjve. Nga ana tjetër, arsimiti i prindërve nuk është i lidhur, të

FOTO NR. 81: **Pjesëmarrje në aktivitete politike/angazhim politik**FOTO NR. 82: **Participimi politik Sipas të ardhurave të familjes**

ardhurat e familjes janë të rëndësishme. Në kundërshtim me pritshmëritë të cilat i sugjeron literatura, participimi politik është më i shprehur tek grupi i dytë sipas lartësisë së të ardhurave (nga gjithsej 5), pastaj vijon grupi i tretë dhe i katër i të anketuarve sipas lartësisë së të ardhurave të familjes.

Në këtë variabël bëme një analizë regresive multivariabël, në të cilën përveç variablave demografike inkuadruam edhe disa të tjera të identifikuara si të rëndësishme në literaturë: vlerat e dimensionit ekonomik – social dhe liberal – konservativ, interesimi për

politikë, si dhe aspekti religjioz. Për shkak të reliabilitetit të ulët, nuk i përdorim vlerat e shkallëve për autoritarizëm dhe për shkallën – F (si dhe shkalla N-për shkaqet e lartpërmendura), të cilat po ashtu janë të rëndësishme në këtë lloj të analizës. Kur përfshihen vetëm variablat demografike, fuqia narrative e modelit është e vogël (ato rezultate nuk i prezantojmë), që flet për arsyen e përfshirjes së variablave shtesë potencialisht të rëndësishme për participimin politik.



TABELA NR. 8: **Analiza regresive për participimin politik**

	<b>Participimi politik</b>
Gjinia	0.418* (0.206)
Mosha	0.041 (0.032)
Rural – urban	0.020 (0.223)
Të ardhurat	-0.405** (0.124)
Arsimi	0.112 (0.116)
Arsimi i nënës	0.50 (0.127)
Arsimi i babait	-0.097 (0.122)
Shqiptarë	1.182** (0.311)
Të tjerë	1.415** (0.417)
Interesimi për politikë	1.130** (0.080)
Vlera e dimensionit ekonomik-social	-0.136** (0.040)
Vlera e dimensionit liberal-konsevativ	0.140** (0.022)
Aspekti religjioz	-0.065 (0.074)


Observime	562
R <sup>2</sup>	0.412
R i korigjuar	0.398
F statik	29.557
Shënim: Tabela i pasqyron koeficientët regresiv dhe gabimin standard në kllapa. Maqedonasit janë kategori referente.	

Rezultatet e modelit të prezantuar në tabelën 12<sup>25</sup> vë në dukje se gjinia dhe të ardhurat janë të rëndësishme për participimin politik, në drejtim të njëjtë si edhe gjatë analizës bivariate, si dhe përkatësia etnike, rëndësia statistikore e të cilës është më e madhe. Arsimi dhe mosha e kanë humbur rëndësinë e tyre, e që sugjeron se në përgjithësi, edhe pse të rëndësishëm në nivel bivarial, fuqia e tyre prediktore është e dobët. Veçanërisht interesante është e dhëna për ndikimin e të ardhurave familjare, sipas të cilave të rinjtë nga familjet me të ardhura më të ulëta kanë vlera më të larta në shkallën e participimit politik. Kjo vë në dukje se të rinjtë prej mjediseve me status të ulët social dhe prej një ambienti i cili ndikon negativisht mbi mundësitë e tyre, që është rast i shpeshtë, duke i pasur parasysh gjendjet në vend, janë të përgatitur të mobilizohen që të veprojnë në drejtim të ndryshimeve. Ngjashëm, si edhe në studimet e tjera, interesimi për politikë është prediktorë

i fuqishëm për participimin politik të të rinjve, ndërsa vlera e dimensionit liberal – konservativë ka rëndësi statistikore në drejtim pozitiv. Vlera e dimensionit ekonomik – social ka rëndësi statistikore, por në drejtim të kundërt.


## NGA IDENTITETI LOKAL NË ATË GLOBAL

Pyetja e radhës e mat identifikimin e të rinjve nga identiteti lokal deri në atë global, me ç'rast 1 – fare nuk e shoh veten si (identitet përkatës), dhe 5 – plotësisht e shoh veten si (identitet përkatës). Ato manifestojnë lidhje të fuqishme me këto identitete, me ç'rast më e fuqishme është lidhja me identitetin nga mjedisi i drejtpërdrejt – lokal (M=4,43) dhe identiteti rajonal (M=4,35). Në kundërshtim me të dhënat paraprake (Janev, 2016), identifikimi me shtetin nacional (M=4,12) dhe botën është shumë e afërt (M=4,07). Befasueshëm, identifikimi është më i ulët me Evropën (M=3,49).

FOTO NR. 83: **Identifikimi nga identiteti lokal në atë global**

Maqedonasit manifestojnë shkallë më të lartë të mbështetjes për të gjitha identitetet e ofruara, ndërsa shqiptarët, para së gjithash, identifikohen me identitetin e tyre lokal/rajonal. Ata më së paku ndihen maqedonas në kuptimin nacional, shumë më pak sesa pjesëtarët e bashkësive më të vogla etnike. Gjithashtu, ndihen më pak edhe si evropian.

Me rritjen e moshës, rritet edhe identifikimi nacional, ndërkaq me Evropën më së paku identifikohet grupmosha e mesme, ndërsa më së shumti grupmosha më e rritur. Vendbanimi ka rëndësi për identifikimin me botën, me rajonin dhe me vendlindjen. Identifikimi është më i fuqishëm tek të rinjtë e mjediseve urbane për të tri kategoritë, por dallimet janë më të mëdha kur bëhet fjalë për identifikimin me botën. Dallimet midis gjinive dhe shkalla e arsimit nga aspekti statistikor nuk janë të rëndësishme. Të ardhurat janë të rëndësishme për të gjitha identitetet, me ç'rast lidhja në çdo vend është mjaft e fuqishme dhe pozitive.

FOTO NR. 84: **Sa e shihni vetveten?**

## QËNDRIME PËR POLITIKËN E JASHTME

Përafërsisht, dy të tretat e të anketuarve konsiderojnë se interesat e Republikës së Maqedonisë nuk janë theksuar mjaftueshëm në politikën globale. 40% e të anketuarve janë të mendimit se rëndësia ndërkombëtare e Maqedonisë në vitet e ardhshme do të shënoj rritje. 60% e të anketuarve kanë shprehur krenari nga identiteti i tyre nacional. Një numër i vogël i të rinjve janë të mendimit se shteti duhet të pranoj më shumë refugjatë (14,9%) ose muhaxhir/migrantë (12,2%).

Të anketuarit e gjinisë mashkullore manifestojnë krenari më të madhe nacionale nga të anketuarit e gjinisë femërore, megjithatë dallimet janë shumë të vogla. Të rinjtë nga mjediset urbane kanë manifestuar krenari më të madhe nacionale në krahasim me të rinjtë nga mjediset rurale. Ndërkaq, më shumë e arsyetojnë

pranimin edhe të refugjatëve edhe të migrantëve. Të anketuarit më të ri, gjithashtu, më shumë e arsyetojnë pranimin e refugjatëve dhe migrantëve. Të ardhurat familjare janë elementë pozitiv, dhe fuqimisht lidhen me krenarinë nacionale, ndërsa negativisht dhe pak më dobët me gatishmërinë që të pranohen refugjatë dhe migrantë.

Maqedonasit dhe të tjerët më shumë pajtohen me pohimin se interesat nacionale nuk janë theksuar sa duhet, ndërkaq maqedonasit janë më skeptikët për atë se rëndësia e vendit të tyre do të shënoj rritje. Ishte e pritshme që ata të shprehin krenari më të madhe nacionale, ndërsa shqiptarët më të vogël. Maqedonasit më pak e arsyetojnë pranimin e refugjatëve dhe migrantëve.

## PROBLEMET NË VEND DHE PRITSHMËRITË

Sa u përket problemeve që duhet të zgjidhen, të rinjtë nuk bëjnë ndonjë dallim të madh, përkatësisht konsiderojnë se të gjitha objektivat/problemet e theksuara duhet të zgjidhen. Vlerat e fituara në shkallën prej 1 deri në 5, me ç'rast 1 – aspak jo, ndërsa 5 – shumë, janë më të larta se 4, kështu që mund të konkludohet se të rinjtë mjedisin e tyre e perceptojnë të rënduar me probleme të ndryshme. Kjo i bën të panevojshme krahasimet midis kategorive të të anketuarve.

Në lidhje me pritshmëritë për zhvillimin e gjendjes ekonomike në 10 vitet e ardhshëm, në shkallën prej 1 deri në 5 të rinjtë kanë manifestuar optimizëm të matur, përkatësisht vlera mesatare është 2,99. Në përqindje, 34% e të rinjve u përcaktuan për vlera pozitive të shkallës, ndërsa 33,5% e kanë zgjedhur vlerën neutrale.

Maqedonasit janë më së paku optimistë (M=2,78), ndërsa shqiptarët (M=3,33) dhe bashkësitë më të vogla etnike (M=3,59) kanë optimizëm më të madh, i cili është në pjesën pozitive të shkallës.

Të anketuarit më të rinj janë optimistë më të mëdhenj sesa më të rriturit. Të ardhurat e familjes po ashtu kanë rëndësi, megjithatë, optimizëm më të madh kanë manifestuar pjesëtarët e kategorisë së tretë prej gjithsej pesë (M=3,21).

Në këtë hulumtim të rinjve iu ofrua ta vlerësojnë gjendjen me tetë vlera në Republikën e Maqedonisë dhe në Bashkimin Evropian, me nota prej 1 deri në 5. Analiza tregon se: 1) të gjitha vlerat janë më mirë të notuara në BE sesa në Maqedoni; 2) asnjëra nga vlerat në Maqedoni nuk është notuar pozitivisht (vlera mesatare është nën nivelin neutral të shkallës prej 1 deri në 5); 3) më drastike janë




FOTO NR. 85: **Qëndrime për politikën e jashtme**

FOTO NR. 86: **Qëllimet e qeverisë (probleme të cilat duhet të zgjidhen)**FOTO NR. 87: **Pritshmëritë për situatën ekonomike (1-5)**

dallimet e notave që kanë të bëjnë me mirëqenien ekonomike dhe punësimin, pastaj vijon barazia, sundimi i së drejtës dhe të drejtat e njeriut. Siguria dhe liria individuale kanë dallime më të vogla.

Pastaj, të rinjve iu ofrua t'i rankojnë këto vlera. Gjatë rankimit ata përcaktohen për vlerat e përgjithshme politike, siç është: demokracia dhe të drejtat e njeriut, por edhe vlerat që kanë të bëjnë me mirëqenien ekonomike. Siguria dhe liria, si ekstreme të llojit të vet janë pak të zgjedhura, ndërsa për të njëjtat mund të shihet se diskrepanca e gjendjes në BE dhe Maqedoni është perceptuar si më e vogël.


FOTO NR. 88: **Gjendja me vlerat e përzgjedhura në R. e Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian (nota nga 1 deri në 5)**

TABELA NR. 9: **Rankimi i vlerave**

	Ranku i parë	Ranku i dytë	Ranku i tretë
Demokracia	20,9 %		
Sundimi i së drejtës		15,8 %	
Të drejtat e njeriut	23,2 %	19,1 %	17,5 %
Mirëqenia ekonomike e qytetarëve	18,2 %	15 %	17,8 %
Punësimi		18 %	18,3 %
Barazia			
Siguria			
Liria individuale			

Në fund, 81 % e të rinjve e mbështesin anëtarësimin në Bashkimin Evropian, që është një përqindje e lartë, madje edhe mbi mesataren e popullatës së përgjithshme. Ishte e pritshme se mbështetja për anëtarësim është më e ulët tek maqedonasit etnikë (77%), ndërsa më e lartë tek shqiptarët (94,4%), por përqindja më e ulët befusueshëm është tek pjesëtarët e bashkësive më të vogla etnike (74,6%).

## KONKLUZIONE

- Interesimi për politikë në mesin e të rinjve dhe diskutimet në tema politike ka shënuar rënie, përkatësisht është dyfish më i ulët në krahasim me studimin paraprak.
